



LIGJI Nr. 79/2017
“PËR SPORTIN”
(ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

...dhe aktet nënligjore në zbatim të tij



Përmbledhje

❖ LIGJ Nr. 79/2017 “Për sportin” (i ndryshuar)

Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM)

2018

1. VKM nr. 255, datë 9.5.2018 “Për përcaktimin e përbërjes strukturore dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”;
2. VKM nr. 305, datë 23.5.2018 “Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit Kombëtar Kundër Dhunës në Sport”.
3. VKM nr. 441, datë 18.7.2018 “Për ndryshimin e varësisë së klubit sportiv shumësportësh “Partizani” dhe klubit sportiv “Studenti” nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Bashkisë Tiranë”.
4. VKM nr. 687, datë 14.11.2018 “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë”. (i shfuqizuar).
5. VKM nr. 817, datë 31.12.2018, “Për financimin e projektit “Rikonstruksioni i stadiumit të futbollit “Zeqir Ymeri”, Kukës””.

2021

1. VKM nr. 242, datë 14.4.2021, “Për financimin e projektit “Rikonstruksioni i stadiumit të futbollit “Zeqir Ymeri”, Kukës””.
2. VKM nr.450, datë 30.06.2021 “Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe procedurat e përjashtimit të tyre”.
3. VKM nr.789, datë 15.12.2021 “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre”.
4. VKM nr. 870, datë 30.12.2021 “Për financimin e projektit “Ekipet sportive-2022” në

kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar”.

2022

5. VKM nr. 56, datë 26.1.2022, “Për përcaktimin e masave të sigurisë, përgjegjësi dhe mënyrave të ruajtjes së sigurisë në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit”.
6. VKM nr. 330, datë 15.5.2022, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”.
7. VKM nr. 648, datë 5.10.2022 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për Universitetin e Sporteve të Tiranës, të pasurive të paluajshme, në zonën kadastrale 8210, bashkia Tiranë”.
8. VKM nr. 832, datë 19.12.2022, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për financimin e vlerës sëtatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) të biletave për ndeshjen finale të Uefa Conference League, të zhvilluar në Arenën Kombëtare të Futbollit Tiranë, në datën 25 maj 2022”.
9. VKM nr. 833, datë 19.12.2022, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për shpërblimin e sportistëve elitare dhe trajnerëve të tyre”.
10. VKM Nr. 893, datë 27.12.2022 “Për financimin e projektit “Ekipet Sportive në Shkolla”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)”.
11. VKM Nr. 894, datë 27.12.2022 “Për financimin e Federatës Shqiptare të Futbollit, për mbështetjen e ekipit kombëtar të futbollit ”.

Udhëzime

2020

1. Udhëzim i përbashkët nr.4, datë 25.2.2020 i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Mënyrën e përdorimit të fondit “grand/transfertë korrente e brendshme” për federatat shqiptare sportive dhe komitetin olimpik kombëtar shqiptar dhe sistemin e pikëzimit të kriterëve prioritarë të vlerësimit”.(Shfuqizuar)

2022

1. Udhëzim i përbashkët nr.4, datë 25.2.2022 i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për mënyrën e përdorimit të fondit “Grant/Transfertë Korrente e Brendshme” Për Federatat Sportive Olimpike, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatën Kombëtare Antidoping”.

Urdhra

2018

1. Urdhër nr. 337, datë 20.6.2018, i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”. (I shfuqizuar).

2022

2. Urdhër nr. 396, datë, 8.7.2022, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për përcaktimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”.
3. Urdhër nr. 397, datë 8.7.2022, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Lartë të Sportit”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 79/2017
PËR SPORTIN

(ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve, që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Europiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë;
- b) përcaktimi i kompetencave të autoriteteve qendrore e vendore në fushën e sporteve;
- c) përcaktimi i bazave të përgjithshme dhe ligjore të organizimit e të zhvillimit të sportit;
- ç) përcaktimi i marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet organizatave sportive dhe institucioneve të pushtetit qendror dhe institucioneve të pushtetit vendor;
- d) krijimi i kushteve të nevojshme për zhvillimin sistematik nga të gjitha moshat të edukimit fizik dhe sportit, të mbështetura nga institucionet e pushtetit qendror dhe njësitë e qeverisjes vendore;
- dh) të shërbejë si mbështetje ligjore, financiare dhe organizative për funksionimin e institucioneve dhe të organizatave sportive, publike e private.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të funksionimit dhe të organizimit të sportit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

(shtuar pika 7/1 me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjencia Botërore e Antidopingut” është organizatë ndërkombëtare e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton veprimtarinë kundër dopingut në sport, e themeluar dhe e financuar në mënyrë të barabartë nga lëvizja sportive botërore.

2. “Ambient sportiv” është çdo ambient ose pjesë e një ndërtese apo hapësire të mbyllur rreth saj, që shërben për veprimtari sportive.

3. “Dopingu në sport” është përdorimi apo administrimi prej sportistëve i substancave doping dhe i metodave doping, të klasifikuara si të tilla në listën vjetore të Agjencisë Botërore të Antidopingut.

4. “Edukimi fizik” është lëndë mësimore, pjesë e kurrikulës së arsimit parauniversitar dhe universitar, e cila fokusohet në zhvillimin e aftësive që ndihmojnë në kryerjen me lehtësi dhe kënaqësi të veprimtarisë fizike ditore. Nëpërmjet saj fitohen aftësitë e nevojshme për të marrë pjesë në një gamë të gjerë veprimtarish sportive.

5. “Fair play” është loja e ndershme, respektimi i rregullave dhe trajtimi i barabartë i të gjithë pjesëmarrësve.

6. “Federata sportive” është personi juridik, që krijohet në formën e shoqatës, anëtarë të së cilës janë shoqatat sportive, shoqëritë sportive dhe klubet sportive që ushtrojnë veprimtari në një sport të caktuar, dhe që ka për qëllim organizimin, zhvillimin, promovimin, kontrollin, rregullimin dhe përhapjen e një sporti të caktuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

7. “Gjykata e Arbitrazhit të Sportit (CAS) në Lozanë të Zvicrës” është një organ ndërkombëtar gjyqësor, i krijuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet në lidhje me sportin përmes arbitrazhit. Selia e saj është në Lozanë (Zvicër) dhe gjykatat e saj janë të vendosura në qytetin e Nju Jorkut, Sidneit dhe Lozanës.

7/1. “Karta e tifozit” është një marrëveshje ndërmjet tifozëve dhe organizatës sportive, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e organizatës sportive ndaj tifozëve të saj dhe anasjelltas, sanksionet bazë për rastet e shkeljes së kësaj marrëveshjeje, si dhe rregullat për mbarëvajtjen e veprimtarisë sportive brenda e jashtë vendit.

8. “Klub sportiv” është personi juridik, që ushtron veprimtari sportive në një sport ose shumë sporte.

9. “Këshilli i Arbitrazhit Sportiv” është organi kolegjal, që drejton, autorizon, mbikëqyr dhe kontrollon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin nëpërmjet paneleve të gjykimit të mosmarrëveshjeve.

10. “Komiteti Olimpik Ndërkombëtar” është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton Lëvizjen Olimpik Botërore.

11. “Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar” është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpik në Shqipëri.

12. “Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar Special” është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpik për personat me paaftësi intelektuale në Shqipëri.

13. “Lëvizja olimpikë” është veprimi i bashkërenduar, i organizuar, universal dhe i përhershëm i të gjithë individëve dhe subjekteve, që janë frymëzuar nga vlerat e olimpizmit në të pesta kontinentet dhe që kryhet nën autoritetin suprem të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

14. “Mjedis sportiv” është një hapësirë e mbuluar ose jo, e rrethuar ose jo, e destinuar për organizimin e veprimtarive sportive, si lojëra sportive, gara sportive, palestra sportive ose fitnesi apo e përdorur përkohësisht për organizimin e veprimtarive sportive promocionale, lojërave zbavitëse dhe veprimtarive sportive rekreative.

15. “Objekt sportiv” është sendi i paluajshëm, i ndërtuar në përputhje me kushtet e nevojshme për

zhvillimin e një apo disa sporteve, në bazë të rregullave teknike, të miratuara nga federata kombëtare e sportit përkatës.

16. “Organizatë sportive” është Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, federatat, klubet sportive dhe shoqatat, të cilat zhvillojnë veprimtari sportive.

17. “Organizata Kombëtare Antidoping” është organizata jofitimprurëse që ushtron veprimtarinë kundër dopingut në Republikën e Shqipërisë.

18. “Qendra sportive kombëtare” është institucioni publik, që përdoret vetëm në funksion të veprimtarive me karakter sportiv, i specializuar në sigurimin e shërbimit dhe të trajtimit për përgatitjen e ekipeve olimpike dhe atyre kombëtare në të gjitha disiplinat sportive.

19. “Sport” është tërësia e veprimeve psiko-fizike, që synojnë zhvillimin e ushtruesve, argëtimin, edukimin, ruajtjen dhe forcimin e shëndetit, përmirësimin e mirëqenies së gjithanshme të tyre dhe arritjen e suksesit në garat sportive.

20. “Sportist” është individ, ushtrues i një sporti në forma të ndryshme, i anëtarësuar në një organizatë sportive.

21. “Sportistë të nivelit të lartë” janë persona që praktikojnë sistematikisht dhe në mënyrë të organizuar sportin, duke marrë pjesë në veprimtari sportive dhe duke arritur rezultate të larta në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

22. “Sport amator” është veprimtaria sportive, ku pjesëmarrësit për përgatitjen dhe përfaqësimin në të mbështeten te vullnetarizmi.

23. “Sport profesionist” është veprimtaria e sportistëve, të cilët zhvillojnë veprimtari sportive në mënyrë profesioniste dhe që janë të pajisur me kontratë me klubin përkatës nga i cili paguhen.

24. “Sport shkollor” është veprimtaria e organizuar kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, nëpërmjet së cilës menaxhohen dhe trajnohen aftësitë kryesore të nxënësve për t’u përfshirë në ushtrimin e disiplinave të ndryshme sportive.

25. “Sport për të gjithë” përfaqëson një kompleks veprimtarish për praktikimin e lirë të ushtrimeve fizike në një mjedis tërësisht të sigurt, të organizuar ose të pavarur, në mënyrë individuale ose në grup.

26. “Specialist i sportit” është një punonjës i sportit, i cili ka fituar një diplomë edukimi të sportit apo një certifikatë të përputhshme ose diplomë të kualifikimit profesional të edukimit të sportit ose certifikatë të përputhshme kualifikimi profesional.

27. “Shoqatë sportive” është personi juridik, që krijohet nga anëtarët që ushtrojnë veprimtari sportive në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislationit në fuqi.

28. “Shoqëri sportive” është një person juridik, që krijohet dhe funksionon në formën e shoqërisë tregtare, që ushtron veprimtari sportive me qëllime fitimprurëse, në përputhje me legjislationin tregtar në fuqi.

29. “Terren sportiv” është çdo mjedis apo sipërfaqe e hapur, në të cilën ushtrohet veprimtari sportive.

30. “Trajner” është profesionisti i licencuar në fushën e trajnimit sportiv, i cili stërvit një individ apo ekip dhe e përgatit atë për garim apo ndeshje.

31. “Veprimtari sportive” janë të gjitha format e veprimtarive fizike e sportive, të cilat, nëpërmjet pjesëmarrjes së organizuar apo të rastësishme, synojnë shprehjen ose përmirësimin e aftësive fizike e psikike, zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore ose arritjen e rezultateve sportive në garat e të gjitha niveleve dhe të gjitha grup-moshave, duke respektuar frymën sportive dhe duke vlerësuar ndershmërinë sportive. Veprimtari sportive janë veprimtaritë konkrete, të zhvilluara në një formë,

kohë apo vend të caktuar.

Neni 4

Parimet bazë të funksionimit të sportit në Republikën e Shqipërisë

Parimet bazë të sportit janë:

- a) parimi i barazisë, si një e drejtë e çdo shtetasi për t'u marrë me sport;
- b) parimi i qasjes sistematike, shkencore dhe të diferencuar të edukimit fizik e të sportit gjatë gjithë jetës së njeriut;
- c) parimi i lidhjes së edukimit fizik dhe sportit me shëndetin, arsimin dhe kulturën në një sistem të vetëm funksional, për të rritur ndikimin e saj të balancuar në të gjithë popullsinë;
- ç) parimi i lojës së ndershme dhe korrekte, i udhëhequr nga idealet olimpike dhe parimet e etikës sportive;
- d) parimi i sigurisë, që ka të bëjë me ushtrimin e veprimtarive sportive në një mjedis të sigurt.

Neni 5

E drejta e të ushtruarit të sportit

1. Të ushtruarit e sportit është një e drejtë e të gjithë shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Askush nuk mund të privohet nga kjo e drejtë pa shkak të mbështetur në ligj.
2. Nuk përbëjnë shkelje të së drejtës për të ushtruar sportin rastet kur kufizimet për pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive përcaktohen në rregulloret e organizimit të tyre.
3. Ndalohet diskriminimi në veprimtaritë sportive për shkaqe, si bindjet politike a fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, gjendja ekonomike ose shoqërore.
4. Ndalohen organizimi dhe propaganda politike e fetare në veprimtaritë sportive.

Neni 6

Edukimi fizik dhe sporti në sistemin arsimor

1. Sporti është pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike dhe jopublike.
2. Edukimi fizik në arsimin parauniversitar është pjesë e kurrikulës bërthamë dhe kurrikulës me zgjedhje të planit mësimor. Edukimi fizik në kurrikulën bërthamë zhvillohet me minimumi tre orë mësimore në javë për klasat 1-12. Përjashtimet nga ky rregull përcaktohen nga ministri përgjegjës për arsimin, ndërsa për arsimin profesional nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin profesional. Në arsimin universitar edukimi fizik përcaktohet në aktet e brendshme të vetë institucioneve të arsimit të lartë.
3. Të gjitha institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore krijojnë kushtet e nevojshme që nxënësit, studentët, efektivat e policisë dhe të Forcave të Armatosura të zhvillojnë veprimtari fizike dhe sportive, individuale dhe/ose të organizuara.
4. Përveç disiplinës mësimore të përfshirë si pjesë e kurrikulës, aktivitetet sportive në institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare jashtë procesit mësimor organizohen edhe nga shoqatat sportive shkollore dhe shoqatat sportive universitare, të cilat mund të jenë të një sporti ose të shumë sporteve, veprimtaria e të cilave koordinohet sipas përkatësisë nga Federata e Sportit Shkollor dhe Federata e Sportit Universitar.

5. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor dhe Federata Shqiptare e Sportit Universitar janë persona juridikë, që organizohen dhe funksionojnë në zbatim të kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse. Ministria përgjegjëse për sportin njih vetëm një federatë të sportit shkollor dhe një federatë të sportit universitar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e këtyre federatave.

6. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor dhe Federata Shqiptare e Sportit Universitar, krahas detyrave statutore, kanë edhe këto detyra:

a) Federata Shqiptare e Sportit Shkollor:

i) të organizojë, të drejtojë, të kontrollojë dhe të vëzhgojë veprimtaritë sportive me nxënësit e të gjitha grup-moshave të arsimit parauniversitar në nivel rajonal dhe kombëtar, në të gjitha disiplinat sportive;

ii) të organizojë kampionatin e shkollave në të gjitha disiplinat sportive dhe të shpallë kampionin kombëtar të shkollave;

iii) të organizojë ekipet përfaqësuese në veprimtaritë ndërkombëtare të sportit shkollor. b) Federata Shqiptare e Sportit Universitar:

i) të organizojë, të drejtojë, të kontrollojë dhe të vëzhgojë veprimtaritë sportive me studentët e arsimit të lartë, në nivel rajonal e kombëtar, në të gjitha disiplinat sportive;

ii) të organizojë universiadat në të gjitha disiplinat sportive dhe të shpallë kampionin kombëtar të universiteteve;

iii) të organizojë ekipet përfaqësuese në aktivitetet ndërkombëtare të sportit universitar.

7. Shkollat sportive janë institucione arsimore të arsimit të mesëm të lartë me orientim sportiv të të nxënësve. Pranimi në shkollat e arsimit të orientuar bëhet sipas kritereve dhe procedurave që përcaktohen me akte nënligjore.

8. Të gjitha institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare, publike ose jopublike, zbatojnë standardet në fuqi për zhvillimin e orës mësimore të edukimit fizik dhe sporteve për nxënësit dhe studentët.

KREU II SHTETI DHE SPORTI

Neni 7

Sporti në Republikën e Shqipërisë

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik.

2. Shteti nxit zhvillimin e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitari, duke mbështetur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, nëpërmjet krijimit të kushteve ligjore, financiare dhe të infrastrukturës sportive.

3. Shteti nxit dhe mbështet përfshirjen në veprimtari sportive të personave me aftësi të kufizuara, si dhe ndihmon nëpërmjet sportit integrimin e tyre në jetën shoqërore.

4. Shteti mbështet organizatat sportive dhe subjektet sponsorizuese të veprimtarive sportive, nëpërmjet krijimit të lehtësive fiskale.

5. Ndihamat apo sponsorizimet me materiale dhe pajisje sportive për organizatat sportive shqiptare, të cilat vijnë nga institucione ndërkombëtare apo çdo formë tjetër sponsorizimi, në kuadër të bashkëpunimit, nxitjes së sportit dhe rritjes së nivelit të sportit në rang ndërkombëtar, përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.

6. Procedurat e përjashtimit dhe listat e materialeve e të pajisjeve sportive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Ministria përgjegjëse për sportin dhe njësitë e qeverisjes vendore

1. Ministria përgjegjëse për sportin harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive.

2. Ministria përgjegjëse për sportin bashkë-punon me to për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre, administron objektet sportive publike, që ka në juridiksion, dhe financon ndërtimin e mirëmbajtjen e mjediseve sportive.

3. Njësia administrative e pushtetit vendor harton dhe garanton politikat vendore në fushën e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitare, krijon institucione përgjegjëse për sportin, menaxhon objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës, mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre.

Neni 9

Këshilli i Lartë i Sportit

1. Këshilli i Lartë i Sportit është organ këshillimor, pranë ministrit përgjegjës për sportin, i cili merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin.

2. Përbërja strukturore dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ministri përgjegjës për sportin është kryetar i Këshillit të Lartë të Sportit dhe emëron anëtarët e tij. Ministri përgjegjës për sportin miraton rregulloren e organizimit e të funksionimit të Këshillit të Lartë të Sportit.

KREU III

ORGANIZIMI I SPORTIT

Neni 10

Organizimi kombëtar i sportit

Organizimi kombëtar i sportit përbën tërësinë e organizatave e të institucioneve që ushtrojnë veprimtari në fushën e sportit, të ndara në organizata sportive dhe struktura shtetërore për shërbime sportive.

Neni 11

Organizatave sportive në Republikën e Shqipërisë

Organizatave sportive në Republikën e Shqipërisë janë:

- a) Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar;
- b) federatat sportive;
- c) shoqatat sportive;

- c) shoqëritë sportive;
- d) klubet sportive.

Neni 12

Qendra Sportive Kombëtare

1. Qendra Sportive Kombëtare janë Tirana Olimpik Park dhe Qendra Olimpikë Korçë.
2. Këto qendra janë në pronësi të njësisve të qeverisjes vendore përkatëse dhe përdoren vetëm në funksion të veprimtarive me karakter sportiv.

Neni 13

Financimi i organizatave sportive

(ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Federatat sportive, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizata Kombëtare Antidoping financohen me fonde të dhëna nga buxheti i shtetit në formë transferte, të parashikuara në buxhetin e shtetit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.
2. Financimi I federatave sportive olimpikë, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatës Kombëtare Antidoping përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për sportin.
3. Ministria përgjegjëse për sportin financon federatat joolimpikë me projekte nga buxheti i saj në formë transferte për veprimtari të propozuara prej tyre, duke pasur në konsideratë impaktin social, ekonomik dhe mjedisor.
4. Ministria përgjegjëse për sportin mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë dhe administrimin e transfertës së buxhetit të shtetit në të gjitha organizatat sportive që kanë përfituar nga fondet publike.

Neni 14

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

1. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar është person juridik, që organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me Kartën Olimpikë dhe statutin e tij të miratuar nga ministri përgjegjës për sportin, përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente.
2. Lëvizja olimpikë drejtohet dhe bashkë-rendohet nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.
3. Ndryshimet statutoire miratohen nga ministri përgjegjës për sportin brenda 60 ditëve nga data e depozitimit. Pas kalimit të këtij afati, ndryshimet statutoire konsiderohen të miratuara në heshtje. Pas përfundimit të kësaj procedure, ndryshimet statutoire regjistrohen në gjykatë.
4. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar mund të financohet me fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit në formë transferte, si dhe burime të tjera të ligjshme.
5. Ministria përgjegjëse njihet vetëm një Komitet Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e këtij Komiteti.
6. Në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar aderojnë federatat shqiptare, organizata të tjera sportive dhe persona juridikë dhe fizikë, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në statutin e këtij Komiteti.
7. Vendimet e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar bëhen publike nëpërmjet dërgimit zyrtar tek të gjithë anëtarët e tij.

Neni 15

Programet kryesore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar bashkërendon fondet e veta me ato të pushtetit qendror e vendor në zbatim të programeve si më poshtë:

- a) programi i edukimit olimpik;
- b) programi rinor i lëvizjes olimpike;
- c) programi i zhvillimit rajonal të lëvizjes olimpike;
- ç) programi i përgatitjes dhe pjesëmarrjes së sportistëve më të mirë të vendit në Lojërat Olimpike dhe në garat e tjera olimpike, ndërkombëtare e rajonale.

Neni 16

Federatat sportive

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Federata shqiptare është person juridik që organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe ushtron veprimtarinë në një sport të caktuar në përputhje me statutin e saj, të miratuar nga ministri përgjegjës për sportin brenda 60 ditëve nga data e depozitimit, përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente. Pas kalimit të këtij afati, statuti konsiderohet i miratuar në heshtje.

2. Federatat sportive pas titullit të përkatësisë duhet të shënojnë emërtimin “Federatë shqiptare”.

3. Të drejtën për të përfituar emërtimin “Federatë shqiptare” e një sporti të caktuar e gëzon ajo organizatë sportive, e krijuar me nismën e personave juridikë dhe/ose personave fizikë të atij sporti, të organizuar sipas legjislacionit për organizatat jofitimprurëse ose tregtarët dhe shoqëritë tregtare, të cilat kanë pranuar emërtimin dhe statutin e federatës.

4. Ministria përgjegjëse për sportin njih vetëm një federatë në një sport të caktuar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e kësaj federate.

5. Kërkesat e personave juridikë, personave fizikë dhe klubeve sportive të atij sporti për anëtarësim në federatë merren në shqyrtim në mbledhjen e parë të organeve përkatëse të federatës. Vendimi i organeve përkatëse të federatës duhet të jetë i arsyetuar. Kundër vendimit për anëtarësim mund të paraqitet ankim pranë Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.

6. Asnjë person nuk mund të marrë pjesë në asnjë veprimtari sportive pa u anëtarësuar më parë pranë federatës përkatëse.

7. Ndryshimet statutoire miratohen nga ministri përgjegjës për sportin sipas së njëjtës procedurë që miratohet dhe statutit.

8. Federatat shqiptare gëzojnë të drejtën për t’u anëtarësuar në organizata të tjera sportive të nivelit më të lartë, brenda dhe jashtë vendit.

9. Vendimet dhe veprimtaritë sportive të federatave sportive shqiptare bëhen publike nëpërmjet dërgimit zyrtar tek të gjithë anëtarët e saj.

10. Personat me aftësi të kufizuara mund të organizohen në shoqata sportive dhe të anëtarësohen në federata, të cilat kanë ekskluzivitetin e trajtimit të të gjitha çështjeve të një sporti.

Neni 17

Emërtimi “Federatë shqiptare”

1. Shteti i delegon të drejtën e organizimit e të zhvillimit të veprimtarive sportive kombëtare e ndërkombëtare vetëm një federate sportive, në një sport të caktuar.

2. Akti i emërimit “Federatë shqiptare” të një sporti të caktuar jepet nga ministri përgjegjës për sportin, pas opinionit të marrë nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar. Ky Komitet paraqet opinionin jo më vonë se 15 ditë nga dita e marrjes së njoftimit.

3. Akti i emërimit “Federatë shqiptare” i një sporti i revokohet një organizate sportive nga ministri përgjegjës për sportin. Ky i fundit kërkon nga gjykata kompetente heqjen e emërimit nëse:

- a) veprimtaria e saj nuk zhvillohet në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuar në statut;
- b) nuk zhvillohet çdo vit Kampionati Kombëtar dhe Kupa e Shqipërisë;
- c) nuk zhvillohet asambleja vjetore;
- ç) nuk zhvillohet asambleja zgjedhore sipas ciklit olimpik.

Neni 18

Detyrat e federatave

1. Federata shqiptare e një sporti të caktuar, krahas detyrave statutore, ka edhe këto detyra:

a) të organizojë, të drejtojë, të kontrollojë dhe të vëzhgojë aktivitetet sportive zyrtare në nivel kombëtar, në bazë të rregulloreve të miratuara;

b) të organizojë kampionatin kombëtar dhe të shpallë “Kampionin kombëtar” dhe “Ekipin kampion kombëtar” në sportin përkatës;

c) të organizojë Kupën e Shqipërisë dhe të shpallë “fituesin e Kupës së Shqipërisë” në sportin përkatës;

ç) të marrë masa për parandalimin dhe të luftojë dhunën, si dhe të promovojë sportin e pastër dhe tolerancën;

d) të përdorë simbolet e federatës ose të autorizojë përdorimin e tyre nga anëtarë të tjerë, për çdo qëllim;

dh) të organizojë ekipin kombëtar dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari;

e) të organizojë veprimtari zyrtare me karakter ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë me miratimin e ministrisë përgjegjëse për sportin.

ë) të licencojë trajner për sportin përkatës;

f) të japë pëlqimin për kryerjen e veprimtarive sportive, për anëtarët e saj.

2. Asnjë person juridik, privat ose publik, nuk mund të ushtrojë asnjë nga kompetencat ekskluzive të federatës, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj.

Neni 19

Shoqatat sportive

1. Shoqatat sportive kanë për qëllim pjesëmarrjen në veprimtari sportive ose zhvillimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

2. Mënyra e krijimit, forma e organizimit dhe e funksionimit dhe objekti i veprimtarisë së shoqatave sportive mbështeten në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, kuadrin ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe në bazë të këtij

ligji.

3. Shoqatat sportive kombëtare nuk mund të zhvillojnë veprimtari sportive ose të marrin pjesë në to pa u regjistruar si anëtare në federatën shqiptare të sportit përkatës.

4. Shoqatat sportive mund të përfitojnë financime edhe nga organet e pushtetit qendror ose vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet transfertave dhe nga burime të tjera.

Neni 20

Shoqëritë sportive

1. Shoqëritë sportive kanë për qëllim pjesëmarrjen në veprimtari sportive ose zhvillimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

2. Mënyra e krijimit, forma e organizimit dhe e funksionimit, si dhe objekti i veprimtarisë së shoqërive sportive mbështeten në legjislacionin për shoqëritë tregtare.

3. Shoqëritë sportive nuk mund të zhvillojnë veprimtari sportive ose të marrin pjesë në to, pa u regjistruar si anëtare në federatën shqiptare të sportit që ushtrojnë.

4. Shoqëritë sportive mund të përfitojnë financime edhe nga organet e pushtetit qendror ose vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet transfertave dhe nga burime të tjera.

Neni 21

Klubet sportive

(ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Klubet sportive organizohen dhe funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse ose tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

2. Çdo organizatë, që ka personalitet juridik, ka të drejtë të krijojë një shoqatë sportive amatore sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse, e cila organizohet dhe funksionon në bazë të aktit themelues të organit krijues.

3. Transformimi i klubeve sportive sipas pikës 1 të këtij neni, realizohet me vendim të organit krijues brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Klubet sportive sipas pikës 1 të këtij neni, përfitojnë financime nga organet e pushtetit vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet transfertave dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Neni 21/1

Karta e tifozit

(shtuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Karta e tifozit lëshohet nga organizata sportive pas anëtarësimit të tifozit, sipas llojit të veprimtarisë sportive që kjo organizatë ushtron.

2. Karta e tifozit përmban rregulla për çështjet e anëtarësisë, konsultimin e informimin, aksesin dhe përdorimin e stadiumeve, sigurinë e mbrojtjen e spektatorit, tregtimin lidhur me shitjen e biletave, aktivitetet e adresuara komunitetit, si dhe rregulla të tjera kundër racizmit, dhunës, ksenofobisë apo diskriminimit në futboll.

3. Rregullat për procedurën dhe mënyrën për pajisjen me kartën e tifozit përcaktohen në rregulloren e brendshme të organizatës sportive.

Neni 22

Kapitali shtetëror

(ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.

3. Nëse në përfundim të periudhës njëvjeçare, aksionet e zotëruara nga institucionet publike në shoqëritë tregtare sportive nuk shiten, këto të fundit marrin formën sipas përcaktimeve të nenit 21 të këtij ligji.

KREU IV

DREJTËSIA SPORTIVE

Neni 23

Shqyrtimi administrativ

1. Federatat sportive krijojnë organet e gjykimit disiplinor, sipas procedurave të përcaktuara në statutin e tyre.

2. Organet e gjykimit disiplinor të federatave shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve në veprimtaritë, garat sportive, që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, në kundërshtim me rregulloren e veprimtarisë dhe/ose me rregulloren e disiplinës së federatave përkatëse.

3. Vendimet e organeve të gjykimit disiplinor të federatave mund të ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike nga shpallja e tyre.

Neni 24

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

(ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit organizohet dhe funksionon Këshilli i Arbitrazhit Sportiv.

2. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është organ kolegjal, i cili vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin.

3. Të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv përcaktohen në rregulloren e tij, e cila miratohet në Asamblenë e Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

4. Çdo organizatë sportive dhe çdo sportist apo trajner me titull individual ka të drejtën e ankimit për vendimet e organeve drejtuese dhe mosmarrëveshjeve përpara Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.

5. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, federatat shqiptare të sportit, klubet sportive, shoqatat sportive, shoqëritë sportive dhe çdo sportist apo trajner me titull individual pranojnë autoritetin e

Këshillit të Arbitrazhit Sportiv. Ky detyrim përfshihet në statutet përkatëse brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU V SPORTISTI, TRAJNERI DHE STATUSI I NIVELIT TË LARTË NË SPORT

Neni 25

Sportisti

1. Sportisti ka të drejtë ta zgjedhë vetë shoqatën sportive, shoqërinë sportive, klubin sportiv ku dëshiron të anëtarësohet, në varësi të sportit që ushtron, dhe ta ndryshojë atë në përputhje me statutet e tyre.

2. Pjesëmarrja në këto organizata bëhet sipas procedurave të përcaktuara në statut dhe në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës. Sportisti është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës.

3. Transferimi i sportistit nga një klub sportiv në një tjetër, brenda ose jashtë vendit, bëhet në përputhje me rregulloret e veprimtarive sportive, të miratuara nga federata shqiptare e atij sporti dhe nga ato ndërkombëtare.

Neni 26

Kategoritë e sportistëve

1. Sportistët ndahen në amatorë dhe profesionistë, sipas kushteve të përcaktuara në statutet dhe rregulloret e federatave sportive kombëtare.

2. Sportistë amatorë janë ata sportistë, që praktikojnë sportin e tyre dhe nuk kanë ndonjë kontratë pune të lidhur me klubin sportiv apo shoqatën ku janë regjistruar.

3. Sportistët profesionistë janë ata persona që praktikojnë sportin si një profesion dhe fitojnë të ardhura në bazë të nënshkrimit të kontratës së punës me shoqatat, shoqëritë apo klubet sportive në të cilat ata janë anëtarë.

Neni 27

Sportisti, trajneri dhe statusi i sportistit të nivelit të lartë

(ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Sportistët që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, sipas rezultateve sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare:

a) “rekord olimpik”, “rekord botëror”, “rekord europian”, “rekord mesdhetar”, “rekord ballkanik”, “vendi i parë deri në të tetin në Lojërat Olimpike”, “vendi i parë deri në të tetin në kampionate botërore” dhe “vendi i parë deri në të gjashtin në kampionate europiane”, përfitojnë trajtimin, shpërblimin dhe integrimin në sistemin arsimor me drejtim sportiv, sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes, punësimin në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme.

b) “vendi i parë deri në vendin e tretë në Lojërat Mesdhetare” dhe “vendi i parë në “Kampionatin Ballkanik””, përfitojnë trajtimin, shpërblimin, integrimin në sistemin arsimor me drejtim sportiv, sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes.

c) sportistët e sporteve individuale, sipas federatave përkatëse, përfitojnë këtë status për

klasifikime në veprimtaritë ndërkombëtare referuar parashikimeve të pikës 1, shkronjave “a” dhe “b” të këtij neni, sipas përcaktimeve në rregulloret ndërkombëtare të këtyre veprimtarive.

2. Institucionet e arsimit të lartë publik, që ofrojnë programe studimi me drejtim sportiv, siguri kombëtare dhe mbrojtje, sigurojnë kryerjen e studimeve pa konkurs dhe sipas një plani individual për sportistët, të cilët plotësojnë kriteret e përfitimt të statusit të sportistit të nivelit të lartë sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Institucionet e arsimit të lartë jopublik, që ofrojnë programe studimi me drejtim sportiv, sigurojnë ndjekjen e studimeve sipas një plani individual për sportistët që përfitojnë statusin e sportistit të nivelit të lartë sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Në veprimtari kombëtare zyrtare:

a) sportisti i cili thyen rekordin kombëtar dhe vendi i parë në kampionatin kombëtar për të rritur në sportet individuale, të përcaktuara në rregulloret e federatave përkatëse, përfitojnë trajtimin dhe shpërblimin nga fondet e njësisë të qeverisjes vendore;

b) sportistët që fitojnë vendin e parë në kampionatin kombëtar të kategorisë më të lartë në sportet kolektive, të përcaktuara në rregulloret e federatave përkatëse, përfitojnë trajtimin dhe shpërblimin nga fondet e njësisë të qeverisjes vendore.

5. Kriteret, mënyra e shpërblimit dhe trajtimit të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Trajneri

1. Klubet sportive, shoqatat dhe shoqëritë sportive duhet të punësojnë trajnerë të licencuar nga federata shqiptare e sportit përkatës dhe të nënshkruajnë kontratë punësimi, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

2. Klubet sportive, shoqatat, shoqëritë sportive dhe federatat shqiptare të sporteve përkatëse kanë përgjegjësi për kualifikimin dhe trajnimin e mëtijshëm të tyre në bashkëpunim me institucione të fushës.

Neni 29

Detyrimet e sportistit dhe trajnerit

1. Sportisti duhet të respektojë rregullat e federatës përkatëse kombëtare dhe asaj ndërkombëtare, parimet etike të sportit dhe të fair-play-t, kushtet e Konventës Ndërkombëtare të Antidopingut dhe rregulloret e veprimtarisë.

2. Trajnerët respektojnë rregullat e fair-play-t, parimet e Kodit të Etikës, Konventën Ndërkombëtare të Antidopingut, si dhe rregulloret e federatave kombëtare përkatëse.

KREU VI

INFRASTRUKTURA SPORTIVE

Neni 30

Objektet sportive

1. Objektet sportive janë publike ose private.

2. Objektet sportive publike janë në pronësi të pushtetit qendror ose atij vendor, sipas juridiksionit të tyre. Ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e tyre.

3. Objektet sportive ngrihen dhe mirëmbahen për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarive sportive.

Neni 31

Ndërtimi i objekteve sportive

1. Objektet sportive për zhvillimin e veprimtarive sportive zyrtare ndërtohen në përputhje me standardet dhe kushtet teknike të miratuara nga federatat ndërkombëtare të sportit përkatës.

2. Administratorët dhe shfrytëzuesit e mjediseve sportive garantojnë rregullat teknike të sigurisë dhe ato higjieno-shëndetësore për shfrytëzimin dhe frekuentimin e rregullt e normal të mjediseve sportive.

Neni 32

Përdorimi i objekteve sportive

1. Organet shtetërore ose organizatat sportive, që kanë në pronësi ose në përdorim objekte sportive, duhet të bëjnë një herë në vit verifikimin paraprak të kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Në rastet kur konstatohet se kushtet dhe kriteret nuk janë plotësuar sipas standardeve të miratuara nga organizatat ndërkombëtare të sporteve përkatëse, organet shtetërore ose organizatat sportive, që kanë në pronësi ose në përdorim objekte sportive, marrin masa për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive sportive deri në përmbushjen e tyre.

Neni 33

Shfrytëzimi i objekteve sportive

1. E drejta e shfrytëzimit të objektit sportiv i takon personit fizik apo juridik, që ka në administrim objektin sportiv apo kujtdo tjetër të cilit ky i fundit i jep të drejtën e shfrytëzimit.

2. E drejta e shfrytëzimit të veprimtarisë sportive, që zhvillohet në objektin sportiv, i përket organizatorit të kësaj veprimtarie.

3. Marrëdhëniet ndërmjet pronarit ose administratorit dhe organizatorëve të veprimtarisë ose shfrytëzuesit të objektit sportiv, për qëllim të veprimtarisë sportive, rregullohen nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore.

4. Zotëruesi i së drejtës së shfrytëzimit të një veprimtarie sportive nuk mund t'u vërë sportistëve, pjesëmarrës në këtë veprimtari sportive, asnjë detyrim që cenon lirinë e tyre, qoftë atë të të shprehurit apo çdo lloj lirie tjetër individuale.

Neni 34

Destinacioni i objekteve sportive

(ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

Destinacioni i objekteve sportive publike nuk mund të ndryshojë, pavarësisht nga subjekti administrues.

KREU VII
E DREJTA E TRANSMETIMIT, REKLAMAT DHE SPONSORIZIMET

Neni 35

Të drejtat e transmetimit

1. Organizatorët e veprimtarive sportive janë pronarë të së drejtës së transmetimit të kësaj veprimtarie. Ata mund ta shesin këtë të drejtë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me konkurrim publik.

2. Marrëdhëniet juridiko-civile me operatorët televizivë përcaktohen në kontratat e veçanta që lidhen ndërmjet palëve, të hartuara në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi që rregullojnë këto çështje.

Neni 36

Transmetimi i veprimtarive sportive

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. E drejta e transmetimit audioviziv të veprimtarive sportive kombëtare dhe ndërkombëtare të ekipeve kombëtare të Republikës së Shqipërisë në rrugë ajrore, tokësore ose me çdo lloj mënyre tjetër transmetimi rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

2. Të ardhurat e përfituara nga e drejta e transmetimit audioviziv u kalojnë organizatorëve të veprimtarisë sportive në masën njëqind për qind.

3. Transmetimi i informacionit nga operatorët e tjerë audiovizivë bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Neni 37

Reklamimi

Organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjediseve sportive, ku ata zhvillojnë veprimtarinë sportive, për qëllime reklamimi ose sponsorizimi me personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese të lidhura me to.

Neni 38

Sponsorizimi

1. Klubet sportive ose sportistët, për sportet individuale, në përputhje edhe me rregulloret e federatave përkatëse të sportit, kanë të drejtë të vendosin në uniformat që përdorin gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive emrin e shoqërisë sponsorizuese, të shoqërisë sportive ose klubit sportiv, gjithmonë në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën e sponsorizimit ndërmjet klubit, federatës së sportit ose sportistëve dhe sponsorizuesit. Kontratat hartohen në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe sipas standardeve dhe rregulloreve ndërkombëtare.

2. Madhësia dhe forma e mbishkrimeve duhet të jenë në përputhje me normat e rregullores së federatës përkatëse sportive dhe me aktet ligjore në fuqi.

KREU VIII
FINANCIMI I SPORTIT

Neni 39

Financimi nga buxheti i shtetit

1. Fondet e Buxhetit të Shtetit për sportin përcaktohen në Buxhetin vjetor të Shtetit.
2. Në financimin e sportit përfshihen edhe burimet financiare nga pushteti vendor, organizatat sportive, federatat ndërkombëtare sportive, bastet sportive, donacionet, sponsorizimet, e drejta televizive, reklama dhe nga ndonjë burim tjetër i ligjshëm.

Neni 40

Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit

Pranë ministrisë përgjegjëse për sportin krijohet Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit nga të ardhurat që sigurohen nga bastet sportive dhe lojërat e fatit, sipas legjislacionit në fuqi për lojërat e fatit. Kriteret për shpërndarjen dhe përdorimin e Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit për organizatat sportive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 41

Organizimi i veprimtarive sportive

1. Organizuesi i veprimtarisë sportive duhet të njoftojë njësitë e qeverisjes vendore dhe organet e rendit në territorin administrativ ku do të zhvillohet veprimtaria.
2. Afati për informimin e njësisë së qeverisjes vendore dhe organeve të rendit është jo më pak se shtatë ditë kalendarike përpara zhvillimit të veprimtarisë.

Neni 42

Organizimi i lojërave olimpike rajonale, garat finale botërore dhe kampionatet europiane e botërore

1. Lojërat olimpike dhe veprimtaritë me karakter olimpik organizohen nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.
2. Garat finale botërore dhe kampionati europian e ai botëror në Republikën e Shqipërisë organizohen nga federatat sportive me mbështetjen e strukturave përgjegjëse të sportit në ministrinë përgjegjëse për sportet.
3. Për organizimin e lojërave olimpike, të garave finale botërore dhe të kampionatit europian e të kampionatit botëror duhet të plotësohen kërkesat e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe të federatave sportive ndërkombëtare.
4. Sportistët dhe ekipet që përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në garat sportive ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e federatave përkatëse sportive, përdorin simbolin kombëtar.

KREU IX
ANTIDOPINGU NË SPORT

Neni 43

Përdorimi i substancave dhe metodave doping

1. Në procesin stërvitor dhe në veprimtaritë sportive është i ndaluar përdorimi i substancave dhe metodave doping.
2. Lista e substancave dhe metodave doping të ndaluara në Republikën e Shqipërisë është e njëjtë me ato të miratuara nga Agjencia Botërore e Antidopingut.
3. Përdorimi i substancave dhe metodave doping, si dhe nxitja për përdorimin e tyre dënohen sipas normave ndërkombëtare, të pranuar nga federatat përkatëse.

Neni 44

Organizata Kombëtare Antidoping

1. Veprimtarinë kundër dopingut në Republikën e Shqipërisë e ushtron Organizata Kombëtare Antidoping. Organizata Kombëtare Antidoping është organizatë jofitimprurëse, e themeluar nga jo më pak se tre federata shqiptare të sporteve olimpike. Organizimi dhe funksionimi i Organizatës Kombëtare Antidoping bëhen sipas statutit të miratuar nga ministri përgjegjës për sportin dhe gjykata kompetente.
2. Ndryshimet statutoire miratohen nga ministri përgjegjës për sportin, brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të dokumentit me ndryshimet përkatëse. Pas kalimit të këtij afati, ndryshimet statutoire konsiderohen të miratuara në heshtje. Pas përfundimit të kësaj procedure, ndryshimet statutoire regjistrohen në gjykatë.
3. Organizata Kombëtare Antidoping mund të financohet me fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit, organizmat ndërkombëtarë në të cilat aderon, federatat shqiptare të sportit, si dhe burime të tjera të ligjshme.
4. Ministria përgjegjëse për sportin njih vetëm një Organizatë Kombëtare Antidoping dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e saj.
5. Organizata Kombëtare Antidoping ndërmerr masat e nevojshme, sipas Konventës Europiane Antidoping, për kontrollin antidoping të sportistëve dhe merr masat e parashikuara ndaj personave që përdorin ose nxisin përdorimin e dopingut.
6. Federatat shqiptare të sportit pranojnë autoritetin e Organizatës Kombëtare Antidoping për kontrollin e sportistëve, anëtarë të tyre, dhe dënimin e përdoruesve të dopingut. Ky detyrim përcaktohet në statutin e federatës.
7. Organizata Kombëtare Antidoping dhe të gjitha organizatat sportive janë të detyruara të respektojnë antidopingun, sipas përcaktimeve të bëra në dispozitat e Konventës Ndërkombëtare Kundër Dopingut në Sport, 2005, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9623, datë 16.10.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër Dopingut në Sport, 2005”, dhe Konventës Europiane Antidoping të vitit 1989, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9242, datë 17.6.2004, “Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989”.

KREU X

KONTROLI MJEKËSOR DHE KËRKIMI SHKENCOR

Neni 45

Kontrolli mjekësor në sport

(ndryshuar pika 3 dhe shtuar pika 5 me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Asnjë sportist nuk mund të anëtarësohet në një federatë dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive të organizuara prej saj pa paraqitur vërtetimin mjekësor që e lejon atë të ushtrojë sportin që ka zgjedhur. Sportistët e anëtarësuar pajisen me kartelë mjekësore vetjake.

2. Kontrolli mjekësor i sportistëve bëhet nga mjekë të licencuar, të paktën një herë në gjashtë muaj, për matjen e parametrave jetësorë. Sporte të veçanta, për natyrën e veçantë të tyre, parashikojnë në rregulloret e funksionimit kontrole mjekësore më të shpeshta.

3. Kontrolli mjekësor për të gjitha kategoritë e ekipeve kombëtare bëhet nga struktura përgjegjëse e kontrollit mjekësor dhe rehabilitimit pranë Agjencisë së Shërbimit të Sporteve.

4. Organizuesit e veprimtarisë sportive mbajnë përgjegjësi administrative për aktivizimin e sportistëve pa kartelë mjekësore në garat sportive.

5. Organizatorët e veprimtarive sportive sigurojnë vendosjen dhe respektimin e protokolleve higjieno-sanitare gjatë zhvillimit të tyre, me qëllim frenimin e përhapjes së sëmundjeve infektive.

Neni 46

Sigurimi shëndetësor i sportistëve

1. Organizatat sportive, anëtare të federatave përkatëse, janë përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve që marrin pjesë në veprimtaritë sportive.

2. Sigurimi shëndetësor i sportistëve përballon të gjitha shpenzimet për mjekimin e dëmtimeve që mund t'u ndodhin sportistëve gjatë veprimtarisë së tyre sportive.

3. Organizata sportive, anëtare e federatave që lejojnë pjesëmarrjen e sportistëve të pasiguruar nga ana shëndetësore, detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e sportistit në rast dëmtimi në veprimtarinë sportive, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

4. Federatat sportive përkatëse janë përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve të ekipeve kombëtare gjatë grumbullimeve stërvitore dhe pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare.

Neni 47

Kërkimi shkencor dhe kualifikimi në sport

Shteti mbështet dhe financon kërkimin shkencor në sport. Kualifikimi dhe kërkimi në sport realizohen nga institucionet shkencore të specializuara.

KREU XI

PARANDALIMI I DHUNËS NË SPORT

Neni 48

Ndalimi i provokimeve dhe i sjelljeve të palejuara

1. Gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen ndalohet provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në

veprimtarinë sportive dhe/ose ndaj spektatorëve.

2. Gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen ndalohen sjelljet e palejuara të mëposhtme:

a) sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qofshin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të veprimtarive sportive apo shikues, ose përlëshja fizike mes pjesëmarrësve dhe tifozëve;

b) gjuajtja e sendeve në terrenin sportiv të lojës ose në tribunat e tifozëve;

c) shfaqja e materialeve propaganduese, me të cilat fyhen ndjenjat kombëtare ose ndjenjat e tjera ose kryejnë provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor;

ç) ndërmarrja e veprimeve që nxisin urrejtje e që mund të sjellin deri në dhunë apo sulme fizike;

d) dëmtimi i mjediseve të sportit, pajisjeve sportive, instalimeve dhe pajisjeve të tjera në mjedisin sportiv;

dh) veprimet me të cilat pengohet hyrja apo dalja e pjesëmarrësve në mjedisin sportiv, pengimi i zhvillimit të veprimtarisë sportive apo shkaktimi i pasigurisë në mjedisin sportiv për pjesëmarrësit apo personat e tjerë;

e) hyrja e paautorizuar në hapësirat e mjedisit sportiv dhe të terrenit sportiv;

ë) hyrja e paautorizuar në hapësirat zyrtare dhe në kalimet zyrtare të mjedisit sportiv ose në pjesën e tribunës që i caktohet tifozëve të ekipit mik;

f) djegia e rekuizitave, shenjave identifikuese të shteteve, klubeve etj. ose e sendeve të tjera në mjedisin sportiv;

g) përdorimi i maskave ose sendeve të tjera, me qëllim fshehjen e identitetit ose fshehjen e fytyrës;

gj) trukimi i rezultateve të veprimtarive sportive.

3. Organizatori i veprimtarisë sportive është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e veprimtarisë sportive dhe, në veçanti, të kujdeset për marrjen e masave parandaluese të shfaqjes së provokimeve e të sjelljeve të tjera të palejuara.

Neni 49

Sendet e palejuara në objektet dhe mjediset sportive

1. Ndalohen mbajtja dhe përdorimi në objektet e mjediset sportive dhe gjatë zhvillimit të veprimtarive i fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike dhe sendeve të tjera të forta, të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve, i armëve të të gjitha llojeve, si edhe përdorimi e tregtimi i pijeve alkoolike.

2. Gjatë veprimtarive sportive, personat, në cilësinë e përfaqësuesit të federatave, gjyqtarëve dhe vëzhguesve, janë të paprekshëm.

Neni 50

Detyrimi për njoftimin e Policisë së Shtetit

(ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Organizatori i një veprimtarie sportive është i detyruar të njoftojë Policinë e Shtetit me shkrim, të paktën shtatë ditë kalendrike përpara zhvillimit të saj, me qëllim planifikimin e të gjitha masave të nevojshme të sigurisë për mbarëvajtjen e saj.

2. Në këtë njoftim, organizatorët duhet të përcaktojnë edhe shërbimin privat të sigurisë fizike (SHPSF) dhe/ose policinë bashkiake, shoqatën e vullnetarëve, agjenci të specializuara të shërbimit, të kontraktuara për marrjen e masave të sigurisë dhe shërbimit në mjediset sportive.

Neni 51

Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike

(ndryshuar pika 2 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike në mjediset sportive është detyrë institucionale e organeve të Policisë së Shtetit.

2. Administratorët e objekteve dhe mjedisve sportive, në bashkëpunim me organizatorët e veprimtarisë, nëpërmjet shoqërive private të sigurisë fizike dhe/ose policinë bashkiake, shoqatën e vullnetareve, agjenci të specializuara të shërbimit duhet të marrin këto masa:

a) të kryejnë kontrollin rigoroz të tifozëve në portat e hyrjeve në mjedisin sportiv;

b) të kryejnë sigurimin e vendkalimeve publike në mjedisin sportiv;

c) të kryejnë drejtimin e spektatorëve tek ulëset në mjedisin sportiv dhe mbajtjen e tyre nën kontroll;

ç) të kryejnë sigurimin dhe mbrojtjen e lojtarëve nga futja e tifozëve në mjedisin sportiv.

3. Administratorët e mjedisve sportive marrin masat për caktimin e një ambienti të përshtatshëm për drejtuesit e njësisë policore për monitorimin e situatës së rendit publik në mjedisin sportiv.

4. Masat e sigurisë , përgjegjësitë dhe mënyra e ruajtjes së sigurisë në veprimtaritë sportive dhe ndeshjeve të futbollit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 52

Roli i oficerit të sigurisë

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Në veprimtaritë ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, organizatorët e veprimtarive sportive dhe ndeshjeve të futbollit marrin masa për sigurinë e ekipeve nëpërmjet kontaktimit të oficerit të sigurisë.

2. Oficeri i sigurisë duhet të ketë qenë në nivelin drejtues në Policinë e Shtetit, të ketë përvojë në organizimin dhe menaxhimin e masave të sigurisë gjatë veprimtarive sportive dhe ndeshjeve të futbollit, si dhe të ketë gatishmërinë për të punuar me autoritetet publike dhe të Policisë së Shtetit.

3. Oficeri i sigurisë mban kontakte me autoritetet policore, shërbimet e urgjencës dhe përfaqësuesit e tifozëve. Ai është përgjegjës për vlerësimin dhe raportimin tek organizatori i veprimtarisë sportive dhe ndeshjeve të futbollit, duke marrë masat që ato të mos ndikojnë në sigurinë e veprimtarisë.

4. Oficeri i sigurisë është përgjegjës për vlerësimin e adresimin e rreziqeve dhe për marrjen e masave në koordinim me policinë, shërbimet e emergjencës, autoritetet publike dhe çdo subjekt tjetër të përfshirë në menaxhimin e ngjarjes.

Neni 53

Ndalimi i hyrjes në mjediset sportive

(shtuar pika 7 me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Ndalohet hyrja deri në një vit në mjediset sportive e personave, ndaj të cilëve janë zbatuar dispozitat e parashikuara në nenin 49, të këtij ligji, më shumë se një herë.

2. Ndalohet hyrja në mjediset sportive deri në dy vjet e personave, ndaj të cilëve janë zbatuar dispozitat e parashikuara në nenin 49, të këtij ligji, më shumë se dy herë.

3. Vendimin për ndalimin e hyrjes në mjediset sportive e jep Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë komisarariatit të Policisë së Shtetit, nën juridiksionin e të cilit zhvillohet veprimtaria sportive ku është konstatuar kundërvajtja.

4. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative përcaktohet me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

5. Komisarjati i policisë njofton me shkrim personin, ndaj të cilit jepet vendimi, federatën shqiptare të sportit përkatës dhe klubin sportiv, tifoz i të cilit është personi.

6. Kundër vendimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjes pranë komisarariatit të policisë, për sanksionet e parashikuara në ligj, bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit, sipas dispozitave të ligjit për kundërvajtjet administrative, në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave. Përbërja, kompetencat dhe procedurat e funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

7. Personave të cilëve u është ndaluar hyrja në objektet dhe mjediset sportive, sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, detyrohen të paraqiten fizikisht pranë komisariateve policore përkatëse në ditën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë sportive, në të cilën u është ndaluar hyrja.

Neni 54

Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës

1. Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës është një organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për sportin. Ky komision harton politika për parandalimin e dhunës gjatë veprimtarive sportive dhe shfaqjeve sportive. Përbërja, funksionimi, kompetencat dhe mënyra e shpërbimit të anëtarëve të këtij komisioni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës në Sport dhe të gjitha organizatat sportive, në veprimtarinë kundër dhunës në Shqipëri, respektojnë dispozitat e Konventës Europiane Kundër Dhunës në Sport, ku aderon Republika e Shqipërisë.

KREU XII

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 55

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020)

1. Shkelja e dispozitave detyruese të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

2. Shkelja e pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga njëqind mijë deri në pesëqind mijë lekë.

3. Shkelja e nenit 49, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga dhjetë mijë deri në pesëdhjetë mijë lekë, e cila vendoset nga Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë komisarariatit të policisë vendore, bazuar në aktkonstatimin e punonjësit të Policisë së Shtetit.

Neni 56

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative

1. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Shuma e arkëtuar nga vjelja e gjobave derdhet njëqind për qind në favor të Buxhetit të Shtetit.

Neni 57

Masat

1. Dënohen me gjobë në shumën nga njëqind mijë deri në pesëqind mijë lekë organizatat sportive, si dhe anëtarët e tyre në rast se:

a) kryejnë veprimtari sportive pa marrë më parë pëlqimin nga federata sportive përkatëse, në të cilën janë të anëtarësuar;

b) organizojnë ose bëjnë propagandë politike e fetare gjatë veprimtarive sportive.

2. Gjobat vendosen nga komisionet e disiplinës të organizatave sportive dhe derdhen njëqind për qind në buxhetin e federatës përkatëse. Dënimi me gjobë mund të shoqërohet edhe me masa të ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë sportive për një periudhë kohore nga gjashtë muaj deri në një vit. Masat shoqëruese jepen nga komisionet disiplinore të federatave përkatëse.

KREU XIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 58

Ndryshimi i statuteve të organizatave sportive

Statutet e organizatave sportive, të cilat vijnë në kundërshtim me përcaktimet e këtij ligji, ndryshohen nga organizatat dhe paraqiten për miratim pranë ministrisë përgjegjëse për sportin brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 59

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 6; 9, pika 2; 27, pika 3; 40 dhe 54, pika 1, të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministrat përgjegjës që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, pika 1, dhe 40, të këtij ligji.

3. Deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, zbatohen aktet nënligjore që janë në fuqi.

Neni 60

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9376, datë 21.4.2005, "Për sportin", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 61

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendime

VENDIM

Nr. 255, datë 9.5.2018

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES STRUKTURE E TË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e përbërjes strukturore të Këshillit të Lartë të Sportit, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për sportin dhe ka në përbërje të tij 12 (dymbëdhjetë) anëtarë dhe 1 (një) sekretar, si më poshtë vijon:

- a) Përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë anëtar;
- b) Përfaqësuesi i Federatës Shqiptare të Futbollit anëtar;
- c) Përfaqësuesi i Federatës Shqiptare të Basketbollit anëtar;
- ç) Përfaqësuesi i Federatës Shqiptare të Volejbollit anëtar;
- d) Përfaqësuesi i Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit anëtar;
- dh) Dy përfaqësues nga biznesi anëtar;
- e) Tri personalitete të sportit anëtarë;
- ë) Një jurist anëtar;
- f) Një gazetar sportiv anëtar;
- g) Një specialist nga MASR-ja sekretar.

2. Përbërja nominative e Këshillit të Lartë të Sportit përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

3. Këshilli i Lartë i Sportit thirret si rregull nga ministri përgjegjës për sportin, jo më pak se 3 (tri) herë në vit.

4. Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë miraton rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit të Lartë të Sportit.

5. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Sportit shpërblehen për pjesëmarrjen në mbledhje, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

6. Vendimi nr. 437, datë 2.7.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërblimit të Këshillit Kombëtar të Sportit”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM
Nr. 305, datë 23.5.2018

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES, FUNKSIONIMIT, KOMPETENCAVE DHE MËNYRËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR KUNDËR DHUNËS NË SPORT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e përbërjes strukturore të Komisionit Kombëtar Kundër Dhunës në Sport, i cili kryesohet nga zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë dhe 1 (një) koordinator/sekretar, si më poshtë vijon:

- a) Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit anëtar;
- b) Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës Shqiptare të Futbollit anëtar;
- c) Një personalitet, përfaqësues i organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e luftës kundër dhunës në sport anëtar;
- ç) Një personalitet, përfaqësues i institucioneve të arsimit të lartë në fushën e sportit anëtar;
- d) Një gazetar sportiv anëtar;
- dh) Një specialist nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë koordinator/sekretar.

2. Përbërja nominale e Komisionit Kombëtar Kundër Dhunës në Sport përcaktohet me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Komisioni Kombëtar kundër Dhunës në Sport thirret nga zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë jo më pak se 3 (tri) herë në vit.

4. Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë miraton rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Komisionit Kombëtar Kundër Dhunës në Sport.

5. Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës në Sport ka këto kompetenca:

- a) Harton politikat për parandalimin e dhunës në veprimtaritë dhe shfaqjet sportive;
- b) Është përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për një qasje të integruar për rendin, sigurinë dhe shërbimet në ndeshjet e futbollit dhe aktivitetet e tjera sportive;
- c) Zhvillon konsultime dhe, sipas rastit, shkëmben informacion me organizatat përkatëse kundër dhunës në sport;
- ç) Rekomandon masa të përshtatshme për ta mbajtur publikun të informuar lidhur me aktivitetet e ndërmarra;
- d) Siguron mbledhjen, analizën dhe shkëmbimin e informacionit, përvojës dhe praktikave të mira;
- dh) Propozon marrjen e masave të bashkërendimit për të identifikuar, analizuar dhe për të vlerësuar rreziqet lidhur me rendin, sigurinë, shërbimet e shkëmbimin e informacionit të përditësuar për vlerësimin e rrezikut;
- e) Bën konsultime me të gjitha agjencitë ligjzbatuese për të siguruar një mjedis të qetë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit e spektatorët;
- ë) Vlerëson efektivitetin e procedurave të licencimit të stadiumeve, masat e certifikimit dhe

rregulloret për rendin në përgjithësi dhe garanton zbatimin, monitorimin dhe ekzekutimin e tyre;

f) Siguron krijimin e një mjedisi përfshirës e mirëpritës për të gjitha moshat e shoqërisë, duke përfshirë fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht, ofron mjedise të përshtatshme sanitare, freskimi dhe kushte të mira shikimi për të gjithë spektatorët;

g) Vlerëson masat operative të stadiumeve për të qenë të plota, siguron ndërlidhjen e efektshme me policinë, shërbimet e emergjencës dhe përfshin politika dhe procedura të qarta për çështjet që mund të ndikojnë në menaxhimin e grumbullimeve dhe rreziqet përkatëse për rendin dhe sigurinë, veçanërisht:

i) përdorimin e piroteknikës;

ii) çdo sjellje të dhunshme ose tjetër të ndaluar;

iii) çdo sjellje raciste ose tjetër diskriminuese.

gj) Bashkëpunon me organizatorët përkatës për garantimin dhe realizimin e ndeshjeve të futbollit ose aktiviteteve të tjera sportive të qeta, të sigurta dhe mirëpritëse.

6. Me qëllim përmbushjen e funksioneve, me nismën e tij, Komisioni mund të zhvillojë takime me grupet e ekspertëve të federatave sportive për të gjitha llojet e aktiviteteve sportive dhe të propozojë masa konkrete në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

7. Anëtarët e Komisionit Kombëtar Kundër Dhunës në Sport shpërblehen për pjesëmarrjen në mbledhje sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

8. Vendimi nr. 401, datë 18.6.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të Komisionit Kombëtar kundër Dhunës në Sport”, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 441, datë 18.7.2018

PËR NDRYSHIMIN E VARËSISË SË KLUBIT SPORTIV SHUMËSPORTËSH “PARTIZANI” DHE KLUBIT SPORTIV “STUDENTI” NGA MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË TE BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të nenit 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e varësisë së klubit sportiv shumësportësh “Partizani” dhe klubit sportiv “Studenti” nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë te Bashkia Tiranë.

2. Buxheti i miratuar për vitin 2018 për klubin sportiv shumësportësh “Partizani” dhe klubin sportiv “Studenti”, bashkë me asetet në përdorim, transferohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe

Rinisë të Bashkia Tiranë. Transferimi i fondeve bëhet në formën e transfertës së kushtëzuar.

3. Numri i punonjësve të klubit shumë-sportësh “Partizani” dhe klubit sportiv “Studenti”, në total 26 veta, transferohet te Bashkia Tiranë.

4. Vendimi nr. 312, datë 15.5.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e varësisë së klubit sportiv shumë-sportësh “Partizani” nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe çdo akt nënligjor i miratuar për këto klube, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkia Tiranë, klubi shumë-sportësh “Partizani” dhe klubi sportiv “Studenti” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 687, datë 14.11.2018

PËR KRITERET, MËNYRËN E SHPËRBLIMIT DHE PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËR PËRGATITJEN SPORTIVE TË SPORTISTËVE, QË PËRFITOJNË STATUSIN E NIVELIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 27, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Sportistët që kanë arritur rezultate të larta në aktivitete kombëtare apo ndërkombëtare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, konsiderohen sportistë të nivelit të lartë dhe gëzojnë status e trajtim të veçantë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

2. Sportistët gëzojnë statusin e sportistit të nivelit të lartë nga momenti i marrjes së rezultatit zyrtar në veprimtaritë ndërkombëtare apo kombëtare, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1.1 dhe 2.1, të kreut II, të këtij vendimi, deri në marrjen zyrtare të të njëjtit rezultat nga një sportist tjetër pasardhës.

3. Sportistët, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive të arritura në veprimtaritë ndër-kombëtare dhe kombëtare.

II. Kriteret e përcaktimit të statusit të sportistit të nivelit të lartë dhe mënyra e shpërblimit

1. Në veprimtaritë ndërkombëtare:

1.1 Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv për të rritur, në sportet individuale në përbërje të ekipit kombëtar, si dhe në ekipet kombëtare të sporteve kolektive, për sportet olimpike të përcaktuara dhe të miratuara nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, të jenë rezultatet e arritura në aktivitetet ndërkombëtare zyrtare, sipas klasifikimeve përfundimtare të përcaktuara në rregulloret ndërkombëtare, si më poshtë vijon:

a) Sportisti, i cili thyen rekord olimpik;

- b) Sportisti, i cili thyen rekord botëror;
- c) Sportisti, i cili thyen rekord evropian;
- ç) Vendi i parë deri në vendin e tetë në Lojërat Olimpike;
- d) Vendi i parë deri në vendin e gjashtë në kampionate botërore;
- dh) Vendi i parë deri në vendin e tretë në kampionate evropiane;
- e) Vendi i parë në Lojërat Mesdhetare.

1.2 Klasifikimi i ekipeve në sportet individuale nuk merret parasysh në kategorizimin e mësipërm.

1.3 Sportistët që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1.1 të këtij kreu, shpërblehen sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, brenda 3 muajve pas shpalljes së rezultateve zyrtare.

1.4 Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv për të rinjtë janë të njëjta me ato sipas pikës 1.1 të këtij kreu. Kategoria e të rinjve shpërblehen në masën 30% të vlerës së përcaktuar për të rriturit, sipas tabelës I që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, brenda 3 muajve pas shpalljes së rezultateve zyrtare.

1.5 Trajnerët e sportistëve të nivelit të lartë shpërblehen në masën 40% të vlerës së përcaktuar për sportistët fitues sipas kategorizimeve në tabelën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, brenda 3 muajve pas shpalljes së rezultateve zyrtare.

1.6 Klasifikimi i ekipeve dhe shuma përfituese për sportet kolektive përcaktohet në tabelën II që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Nga kjo shumë, komitetet drejtuese të federatave sportive përcaktojnë shpërblimin e sportistëve në sportet kolektive, i cili është individual dhe bazohet në kontributin e secilit.

1.7 Sportistët, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1.1 të këtij kreu, marrin trajtim të veçantë, lidhur me:

a) Ndjekjen e studimeve pa procedura konkurrimi në Universitetin e Sporteve, Akademinë e Sigurisë dhe Akademinë e Mbrojtjes;

b) Ndjekjen e studimeve me plane individuale në institucionet e arsimit të lartë;

c) Punësimin në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme.

2. Në veprimtaritë kombëtare:

2.1 Kriteret për përcaktimin e nivelit të lartë sportiv në veprimtaritë kombëtare janë rezultatet e arritura, si më poshtë vijon:

a) Sportisti, i cili thyen rekordin kombëtar;

b) Vendi i parë në kampionatin kombëtar.

2.2 Shpërblimi, sipas masës së përcaktuar në tabelën III që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, mbulohet nga buxhetet e federatave përkatëse sportive.

III. Trajtimi i sportistëve të nivelit të lartë dhe trajnerëve

1. Sportistët pjesëmarrës në veprimtaritë kombëtare të përcaktuara në rregulloret kombëtare dhe në veprimtari ndërkombëtare, për përgatitjen e tyre, përfitojnë trajtim ushqimor në natyrë ose në vlerë, si dhe trajtim mjekësor.

2. Trajtimi ushqimor është 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, për 25 (njëzet e pesë) ditë në muaj. Trajtimi mjekësor dhe riaftësimi i sportistëve është deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj.

3. Trajtimi ushqimor dhe mjekësor mbulohet plotësisht ose pjesërisht nga klubet sportive, me fondet e pushtetit vendor, nga fondi grant ose të ardhura të tjera të ligjshme.

4. Trajnerët e kontraktuar me kohë të pjesshme pranë klubeve sportive/shumësportesh do të paguhet në masën 500 (pesëqind) lekë për orë stërvitore dhe jo më shumë se 1 000 (një mijë) lekë në ditë për 25 (njëzet e pesë) ditë në muaj.

5. Federatat dhe klubet mund të grumbullojnë ekipet e tyre përfaqësuese për veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare. Vlera ditore për akomodimin dhe ushqimin është 7 000 (shtatë mijë) lekë (4 000 lekë ushqimi + 3 000 lekë fjetja) në ditë, sipas nevojave që ato kanë, dhe mbulohet nga buxhetet e federatave apo klubeve, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve.

IV. Dispozita të fundit

1. Efektet financiare për zbatimin e pikave 1.1 deri në 1.5, të kreut II, të këtij vendimi, përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin.

2. Efektet financiare për zbatimin e pikës 1.6, të kreut II, të këtij vendimi, dhe shpërblimet e dhëna nga ministri përgjegjës për sportin, deri në 500 000 (pesëqind mijë lekë), për veprimtari të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, në sporte individuale dhe në përbërje të ekipeve kombëtare, përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin.

3. Vendimi nr. 1720, datë 29.10.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Tabela I

KLASIFIKIMI NË RENDITJE INDIVIDUALE, SPORTET INDIVIDUALE DHE
SHPËRBLIMET

Kampionat evropian	Vendi i parë	4 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i dytë	2 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i tretë	1 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i dytë	6 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tretë	4 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i katërt	2 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i pestë	1 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i gjashtë	800 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i dytë	7 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tretë	5 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i katërt	3 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i pestë	2 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i gjashtë	1 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i shtatë	800 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tetë	500 000 lekë
Rekord olimpik		15 000 000 lekë
Rekord botëror		15 000 000 lekë
Rekord evropian		8 000 000 lekë

Tabela II

KLASIFIKIMI NË RENDITJE EKIPORE DHE SHPËRBLIMI NË VEPRIMTARITË
NDËRKOMBËTARE

Lojëra olimpike	Vendi i parë	20 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i dytë	15 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tretë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë	15 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i dytë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tretë	7 000 000 lekë

Kampionat evropian	Vendi i parë	7 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i dytë	5 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i tretë	4 000 000 lekë

Tabela III

SHPËRBLIMET PËR FITUESIT NË VEPRIMTARITË KOMBËTARE

Rekord kombëtar		30 000 lekë
Ekipi kampion kombëtar në sportet individuale	Vendi i parë	20 000 lekë
Ekipi kampion në lojëra	Vendi i parë	200 000 lekë
	Vendi i dytë	100 000 lekë
	Vendi i tretë	50 000 lekë

VENDIM

Nr. 817, datë 31.12.2018

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I STADIUMIT TË FUTBOLLIT “ZEQIR YMERI”, KUKËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 8, dhe 31, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, nga fondet e buxhetit të shtetit, për projektin “Rikonstruksioni i stadiumit të futbollit ‘Zeqir Ymeri’, Kukës”.
2. Fondi i miratuar, në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë nga fondet e buxhetit të shtetit, transferohet në formë granti nga llogaria ekonomike 604, programi buxhetor 08140 “Zhvillimi i sportit”.
3. Fondi transferohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë te bashkëfinancuesi, Federata Shqiptare e Futbollit, si transfertë, pas miratimit edhe nga Komiteti i Ndihmës Shtetërore, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në llogari të Federatës Shqiptare të Futbollit, në bankë të nivelit të dytë.
4. Fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh për financimin e projektit “Rikonstruksioni i

stadiumit të futbollit “Zeqir Ymeri”, Kukës”, përballohet nga fondet shtesë të miratuara me aktin normativ nr. 2, datë 19.12.2018, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë monitoron mbarëvajtjen e punimeve në këtë objekt, nëpërmjet një grupi ekspertësh, me përfaqësues edhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kukës, Federata Shqiptare e Futbollit dhe kompania projektuese.

6. Përbërja dhe detyrat e grupit të ekspertëve, si dhe procedura për transferimin e fondeve e transferimin kapital nga Federata Shqiptare e Futbollit te pronari i objektit, Bashkia Kukës, pas përfundimit të investimit, përcaktohen me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kukës dhe Federata Shqiptare e Futbollit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 242, datë 14.4.2021

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I STADIUMIT TË FUTBOLLIT ‘ZEQIR YMERI’, KUKËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 8, pika 2, dhe 31, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, në masën 293 000 000 (dyqind e nëntëdhjetë e tre milionë) lekë, nga fondet e buxhetit të shtetit, për përfundimin e projektit “Rikonstruksioni i stadiumit të futbollit ‘Zeqir Ymeri’, Kukës”.

2. Fondi i miratuar, në masën 293 000 000 (dyqind e nëntëdhjetë e tre milionë) lekë nga fondet e buxhetit të shtetit transferohet nga llogaria ekonomike 231, programi buxhetor 08140 “Sporti dhe rinia”.

3. Fondi transferohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë te bashkëfinancuesi i projektit, Federata Shqiptare e Futbollit, në llogari të saj, në një bankë të nivelit të dytë.

4. Fondi prej 293 000 000 (dyqind e nëntëdhjetë e tre milionë) lekësh, për financimin e përfundimit të projektit “Rikonstruksioni i stadiumit të futbollit ‘Zeqir Ymeri’, Kukës”, përballohet nga fondet e miratuara me ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë monitoron mbarëvajtjen e punimeve në këtë objekt, nëpërmjet një grupi pune me ekspertë, përfaqësues nga Bashkia Kukës, Federata Shqiptare e Futbollit dhe kompania projektuese.

6. Përbërja dhe detyrat e grupit të punës, si dhe procedura për transferimin kapital të objektit nga Federata Shqiptare e Futbollit te pronari i objektit, Bashkia Kukës, pas përfundimit të investimit, përcaktohen me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kukës dhe Federata Shqiptare e Futbollit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 450, datë 30.6.2021

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MATERIALEVE DHE TË PAJISJEVE SPORTIVE, QË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR, SI DHE PROCEDURAT E PËRJASHTIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 7, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që jepen si ndihmë apo sponsorizohen nga institucionet ndërkombëtare apo çdo formë tjetër sponsorizimi, në kuadër të bashkëpunimit, nxitjes së sportit dhe rritjes së nivelit të sportit në rang ndërkombëtar, të cilat përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Organizatat sportive shqiptare paraqesin në ministrinë përgjegjëse për sportin kërkesën për përjashtim nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të materialeve dhe të pajisjeve të listuara në shtojcën bashkëlidhur këtij vendimi, përpara importimit të tyre, të shoqëruara me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kopjen e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet organizatës sportive shqiptare dhe institucionit ndërkombëtar dhe kopjen e projektit të bashkëpunimit, nëse ka një të tillë;

b) Aktin zyrtar të institucionit ndërkombëtar për dhënien e ndihmës apo sponsorizimit për materialet dhe pajisjet sportive që përjashtohen, sipas shtojcës, për organizatën sportive shqiptare;

c) Listën e hollësishme të materialeve dhe të pajisjeve sportive, të shoqëruar me vlerën e tyre tregtare apo me faturën tregtare;

ç) Vendimin e organizatës sportive për shpërndarjen e materialeve dhe të pajisjeve sportive, sipas destinacionit e sasive përkatëse.

3. Ministria përgjegjëse për sportin vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin shoqëruar, të

parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi. Kur përmbushen parashikimet sipas këtij vendimi, ministria përgjegjëse për sportin i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, përpara importimit të materialeve dhe të pajisjeve sportive, kërkesën për përjashtim nga detyrimet doganore e tatimi mbi vlerën e shtuar.

4. Organizatat sportive shqiptare, që kanë paraqitur kërkesën për përjashtim nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të materialeve dhe të pajisjeve sportive të listuara në shtojcën bashkëlidhur këtij vendimi, të kryejnë procedurat ligjore për tërheqjen e tyre në doganë dhe transportimin deri në mbërritjen në destinacionin final, sipas dokumentacionit të dorëzuar prej tyre, në ministrinë përgjegjëse për sportin.

5. Në rast të konstatimit të mospërdorimit të materialeve dhe të pajisjeve sportive, sipas qëllimit për të cilin janë importuar nga organizatat sportive shqiptare, ministria përgjegjëse për sportin informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

6. Vendimi nr. 306, datë 24.5.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCË

LISTA E MATERIALEVE DHE E PAJISJEVE SPORTIVE, QË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR

I. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË ATLETIKËS

1. Pengesa për garat 110 m, 400 m dhe 3000 m
2. Disqe për hedhje
3. Gjyle për hedhje në peshat e ndryshme
4. Çekiç për hedhje në pesha të ndryshme
5. Shtiza për hedhje në pesha të ndryshme
6. Pedana kërcimesh së gjati e trehapësh
7. Shtrat kërcimi me shkop
8. Steka kërcimesh së larti dhe me shkop
9. Shkopa kërcimi me shkop
10. Mbajtëse steke për kërcimet
11. Kronometra
12. Shkopa stafete
13. Blloqe starti
14. Pistoletë starti
15. Kapsolla për pistoletë e startit
16. Dyshekë për kërcimin së larti dhe atë me shkop
17. Tapet sintetik tartan pllakë ose lëndë e parë për shtrimin e pistës së atletikës
18. Ngjitës për tapetin sintetik tartanin
19. Bojë për të bërë vizimet e pistës
20. Tuta sporti (pambuku, sintetike dhe fëshfëshe)
21. Materiale uniforma paraqitje; kanotierë, mbathje për femra dhe meshkuj, bluza, çorape, këpucë me thumba, atlete;
22. Vegla force
23. Boshte dhe rrota shtange;
24. Ripa shtange;
25. Kombinat force;
26. Pedanë force;
27. Shtrat force;
28. Fotofinish elektronik;
29. Tabela për dhënie të rezultateve;
30. Kompjuter elektronik për regjistrimin e atleteve në fotofinish;
31. Fasho llastiku;
32. Gjunjza llastiku;
33. Kaviljere llastiku;
34. Telekamerë për të regjistruar garat për efekt shkencor metodik;

35. Aparat fotografik;
36. Pistë vrapimi elektronike;
37. Bëçikletë elektronike për stërvitje;
38. Step elektronik për stërvitje;
39. Kuba për të kryer ushtrime pliometrike;

II. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË ALPINIZMIT

1. Litar alpin;
2. Rrip sigurimi;
3. Çelësa sigurie;
4. Kazma alpine;
5. Kthetra;
6. Çanta shpine;
7. Shalur;
8. Çadra alpine;
9. Pajisje të murit alpin;
10. Dyshek alpin;
11. Mur alpin i montueshëm dhe i çmontueshëm me bazë punime druri dhe plastike;
12. Këpucë alpine;
13. Mushama alpine;
14. Kaska mbrojtëse për kokën;

III. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BOKSIT

1. Ring dhe aksesoret e tij (litarë, tuba metalikë, tapete, shkallë, jastëkë sfungjeri, tuba plastikë);
2. Thasë lëkure për stërvitje boksi të modele dhe përmasave të ndryshme;
3. Dardha boksi prej lëkure për stërvitje vetjake;
4. Llapeta boksi prej lëkure për stërvitje vetjake;
5. Doreza boksi të tipave të ndryshëm për ndeshje dhe stërvitje sipas standardeve për mosha të ndryshme;
6. Kokore mbrojtëse sipas standardeve për ndeshje dhe stërvitje;
7. Mbrojtëse të organeve gjentiale;
8. Gomina për mbrojtjen e dhëmbëve;
9. Komplet për palestër force të standardit tip, si dhe pajisje speciale për boksin;
10. Uniforma sportive (mbathje, kanotierë, tuta etj.);
11. Bandazhe të standardit tip për mbrojtjen e duarve;
12. Dyshekë muri për stërvitje;
13. Kompjuter për të parë pikët;

IV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BASKETBOLLIT

1. Tabela basketbolli;
2. Mbajtëse tabelash basketbolli;
3. Kosha basketbolli;
4. Tabela elektronike basketbolli;
5. Mbajtëse të 24”;
6. Kronometra loje joelektronike;
7. Topa;
8. Bluza;
9. Fasha llastiku;
10. Kaviliere;
11. Kostum sportiv;
12. Mbathje;
13. Çorape;
14. Jelekë;
15. Këpucë sportive;
16. Çanta sportive;
17. Mbajtëse topash;
18. Rrjeta koshash;
19. Telekamerë për regjistrimin e ndeshjeve;
20. Pajisje të lojës 3x3 (fushë, konstruksion, aparaturë);
21. Sistem kamerash IRC;
22. Shkallë lëvizëse (4 shkallë me gjatësi 5 m).

V. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË ÇIKLIZMIT

1. Makinë tip fugon për të shoqëruar ekipin kombëtar;
2. Motoçikletë;
3. Biçikletë profesionale;
4. Pjesë këmbimi për biçikletat;
5. Uniforma sportive të ekipit kombëtar;
6. Foto finish, me të gjitha pajisjet përbërëse;
7. Veshmbathje dhe uniforma sportive (pantallonçina për çiklizëm, këpucë sportive çiklizmi, fanella verore dhe dimërore për çiklizëm, tuta sportive dhe mushama mbrojtëse nga shiu, kaska mbrojtëse për çiklizëm, doreza sportive;
8. Pajisje sportive ndihmëse, stërvitore dhe për gara (kronometër, diktofon, cilindër, kardiofrekuenciometer);
9. Aparatura dhe mjete të përgatitjes speciale fizike (pista ecjeje vrapimi, shtanga, gira, litarë dhe topa të ndryshëm);

VI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË DANCIT SPORTIV

1. Kostume latine për femra dhe meshkuj;

2. Kostume standarde për meshkuj dhe femra;
3. Kostume latine për meshkuj e femra për formacione latine standarde;
4. Këpucë standarde dhe latine për femra dhe meshkuj;
5. Aksesorë të ndryshëm, si çanta sportive, kostume trajnimi, kravata, sipas manualeve të veshjeve të njohura nga IDSF (Federata Ndërkombëtare e Dancit Sportiv);

VII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË FUTBOLLIT

1. Tapet bari natyral
2. Impiante vaditëse
3. Makineri mirëmbajtjeje të fushave me aksesorët
4. Sisteme ndriçimi të stadiumeve
5. Tabelë elektronike
6. Ndenjëse plastike për spektatorët në stadium
7. Tapet bari artificial me aksesorët për instalimin e tij
8. Makineri mirëmbajtjeje për fusha me bar artificial
9. Kostum sportiv
10. Bluza
11. Mbathje
12. Geta
13. Çorape
14. Kapele
15. Kapuç
16. Doreza
17. Jelekë
18. Këpucë sportive
19. Çanta sportive
20. Çanta për mjekët sportivë
21. Topa
22. Materiale didaktike stërvitore
23. Materiale dhe aksesorë të stadiumeve (porta, rrjeta, flamuj, pajisje vizimi etj.)
24. Shina mbrojtëse të lojtarëve dhe aksesorë ndihmës (shirita kapiteni, mbajtëse flokësh, peshqirë);
25. Televizorë dhe pajisje marrëse satelitore;
26. Kamera, pajisje transmetimi satelitor;
27. Sistem komunikimi për arbitrat;
28. Fëshfëshe shiu;
29. Xhupa;
30. Tapet sintetik për fusha dhe aksesorët për instalimin e tij;
31. Parket për fusha dhe aksesorët për instalimin e tij;

32. Makineri mirëmbajtjeje për tapet sintetik futsal;
33. Makineri mirëmbajtjeje për parket futsal;
34. Sistem Audio Stadiumi;
35. Sistem akses kontrolli të stadiumeve;
36. Sistem CCTV (kamera + aksesore);
37. Sistem VAR për stadium (fugon, hardware, server, kompiuter, monitor, sistem intercom audio – mikrofon, kufje, përshtatës, kamera video, pajisje regjistrimi video dhe audio, patchpanel, kabëll me konektorë, rack, software);
38. Sistem VAR për stadium (licenca);
39. Goal line technology (mikro-kamer, fushë magnetike me bazë fibre, software).

VIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË GJIMNASTIKËS

1. Tapet gjimnastikor për gjimnastikën ritmike dhe artistike me bazament druri
2. Dyshek sfungjeri për stërvitje dhe gare
3. Paralele e shkallëzuar
4. Unaza
5. Hekur gjimnastikor
6. Tra ekuilibri
7. Kalë me doreza
8. Pedanë rrafëse
9. Pajisje gare për gjimnastikën ritmike (fjongo, topa, rrathë, birila)
10. Pjesë ndërrimi të veglave gjimnastikore
11. Tapet për vrapimin e gjimnastëve gjatë garës (rrugë vrapimi)
12. Kalë kërcimi për femra e meshkuj;
13. Rrugicë për kërcime, për garë e stërvitje;
14. Trampolinë;
15. Materiale, uniforma paraqitje, kanatjere, pantallona, kostume sintetike, meshkujsh e femrash, dhe mbathje (kostume gare);
16. Aparatura elektronike për vlerësimin e garave;
17. Aksesorë ndihmës për kalë me doreza;
18. Aksesorë ndihmës për kalë kërcimi për femra e meshkuj;
19. Aksesorë ndihmës për pedanë rrafëse;
20. Shpinore;
21. Rrip mesi;

IX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË HENDBOLLIT

1. Topa
2. Shënues pikësh-gjyqtarie
3. Rrjeta
4. Porta

5. Veshje dhe uniforma sportive-tuta komplet
6. Këpucë
7. Orë elektronike
8. Kronometër, bilbila, pompa
9. Kartonë me ngjyrë për gjyqtarinë
10. Çanta sportive;
11. Shtresa plastike tartani ose ger-flowr etj., për shtrim fushe;
12. Matëse presioni për topat;
13. Çanta për mbajtjen e topave;
14. Jelekë;
15. Mbajtëse topash;
16. Rrjeta për beach-hendbollin;
17. Rrjeta për mbrojtjen e shikuesve që vendosen mbrapa portave;
18. Sistem komunikimi për arbitrat;
19. Mbrojtëse të organeve gjentiale;
20. Gomina për mbrojtjen e dhëmbëve;
21. Fasha llastiku;
22. Kavilier;
23. Aparatura dhe mjete të përgatitjes speciale fizike (pista ecjeje vrapimi, shtanga, gira, litarë dhe topa të ndryshëm);
24. Bojë për të bërë vizimet e fushave;
25. Ngjitës për tapetin sintetik tartanin.

X. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË KARATESË

1. Tatami (tapet);
2. Tabela elektronike (matës për mbajtjen e kohës së ndeshjeve, pushimet, pikët etj.);
3. Kimono (uniforma e plotë e garës-xhaketë, pantallona dhe rrip);
4. Doreza për ndeshje;
5. Dhëmbëza (mbrojtëse për dhëmbët);
6. Peshore elektronike;
7. Tuta komplet (bluzë dhe pantallona);
8. Këpucë sportive;
9. Çanta sportive;
10. Kronometra për stërvitje;
11. Thasë lëkure për stërvitje;
12. Llapeta prej lëkure për stërvitje vetjake.
13. Komplet për palestër force të standardit tip (veçla force, boshte dhe rrota shtange, kombinat force, shtrate force, gira etj);
14. Kukulla për stërvitje;

15. Telekamera për regjistrimin e ndeshjeve;
16. Televizorë/ekrane (për shfaqjen e pikëve gjatë garave);
17. Pajisje speciale për artet marciale (vegla për shtimin e fleksibilitetit, pesha që vendosen te duart apo këmbët, etj.);

XI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SPORTEVE ME KUAJ

1. Pengesa për garën me pengesa;
2. Mjete transporti rimorkio për transportimin e kuajve;
3. Ushqime të ndryshme për kuaj;
4. Shala, mbulesa, frerë, kapistra dhe aksesori të ndryshëm për mbathjen e kuajve;
5. Vegla të ndryshme për mbathjen e kuajve, patkonj, graso, krehër, brusha etj;
6. Komplete sportive për kalorësit pjesëmarrës në garë (çizme, kapele, kostum, dorashka, kamxhikë etj.);
7. Kuaj sportivë të racave të ndryshme;

XII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË MUNDJES

1. Tapete mundjeje prej sfungjeri;
2. Orë (shënues pikësh) elektronike;
3. Peshore elektronike;
4. Veshje sportive (kostume mundjeje dhe këpucë sportive mundjeje);
5. Vegla force;
6. Tabela elektronike për mbajtjen e kohës së ndeshjeve;
7. Çanta sportive;
8. Kronometra për stërvitje;
9. Kukulla bullgare;
10. Tapet mundjeje komplet;
11. Vegla force për stërvitje (kompleks).

XIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË NOTIT

1. Aparatura elektronike për matjen e kohës së garave dhe aksesori të tyre;
2. Linjat ndarëse të korsive të pishinës dhe aksesori të saj;
3. Pajisje sportive ndihmëse për stërvitjen e notarëve;
4. Kronometra;
5. Uniforma sportive (uniforma prezantimi, uniforma për garë);

XIV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË QITJES

1. Pushkë sportive – kalibri 5.6 mm;
2. Pushkë sportive me ajër- kalibri 4.5 mm;
3. Pistoleta sportive – kalibri 5.6 mm;
4. Pistoleta sportive me ajër – kalibri 4.5 mm;

5. Fishekë sportive - kalibri 5.6 mm;
6. Saçme sportive – kalibri 4.5 mm;
7. Veshje speciale (xhupa, pantallona e këpucë);
8. Aksesorë dhe pjesë ndërrimi të armëve;
9. Mjete optike (stereogypa) për shkimin e goditjeve;
10. Aparate elektrike për ndërrimin e shenjave të qitjes;
11. Shenja qitjeje prej letre;
12. Pajisje për hedhjen e pjatelave në qitjen me pjatel;
13. Veshje speciale për qitjen me pjatel (jelekë, doreza, këpucë, kapele, pantallona, çanta);
14. Fishekë për qitjen me pjatel;
15. Pjatelat për qitjen me pjatel

XV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË PESHËNGRITJES

1. Kompjuter për pasqyrimin e rezultateve teknike të garave;
2. Tabela elektronike për shfaqjen e rezultateve teknike të garës;
3. Boshtet klasike të peshëngritjes;
4. Disqe klasike të peshëngritjes me madhësi 50, 25, 20, 15, 10, 5, 2.2, 1 dhe 0.5 kg;
5. Pedana (stërvitore dhe të garës);
6. Pajisje të ndryshme sportive për sallat stërvitore (shkallë suedeze, kaluç, kutia, mbajtëse të disqeve të shtangës, litarë të ndryshëm kërcimi);
7. Veshje të ndryshme sportive (kostum sportiv, bluzë dhe pajisje të peshëngritësit, si rrip mes, bandazhe të ndryshme për kyçet e duarve dhe te gjunjët, këpucë);

XVI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË PINGPONGUT

1. Tavolina pingpongu;
2. Raketa;
3. Topa;
4. Shënues pikësh gjyqtarie;
5. Rrjeta;
6. Parapeta;
7. Faqe raketash;
8. Uniforma sportive – tuta komplet;
9. Këpucë pingpongu;
10. Veshje- bluzë, të mbathura;
11. Tavolinë gjyqtarie;
12. Ngjitëse faqesh rakete;
13. Kronometër;
14. Kartonë me ngjyra për gjyqtarët;

XVII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË RADIOAMATORIZMIT

1. Radiostacione 100 W;
2. Ushqyes;
3. Grup antenash;

XVIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË VOLEJBOLLIT

1. Pajisje volejboli (shtylla, rrjeta, antena);
2. Topa volejboli dhe beach-volley;
3. Uniforma sportive-komplete (çanta sportive, tuta sportive këpucë sportive, mbathje, gjunjëza);
4. Shtylla volejboli dhe beach-volley, së bashku me mbrojtëset e tyre;
5. Kullë për gjyqtarët;
6. Rrjeta volejboli dhe beach-volley, së bashku me antena;
7. Shtresë plastike me tartan ose me ger-flowr për fushën e volejbollit;
8. Flamur për gjyqtarët anësorë;
9. Bilbila për gjyqtarët;
10. Matëse presioni për topat;
11. Tabela me numra nga 1-22, për ndërrimin e lojtarëve;
12. Mbajtëse topash (kosha me rrota);
13. Çanta për mbajtjen e topave;
14. Uniforma sportive për gjyqtarët (Bluza, pantallona, atlete, çanta);
15. Uniforma sportive për lojtarët (bluza, mbathje, tuta sportive, xhupa sportive, gjunjëza, këpucë, atlete, çanta sportive);
16. Tabelë elektronike për mbajtjen e pikëve gjatë garave;
17. Sinjalizues për pushimet;
18. Numëror tryeze për mbajtjen e pikëve;
19. Topa snow –volley;
20. Pompa për fryrjen e topave të volejbollit, beach-volley e snow-volley;
21. Manometër elektronik për matjen e presionit të topave;
22. Kronometër për matje kohe;
23. Kartonët profesional të përdorur nga gjyqtarët e volejbollit;
24. Bilbil profesional i përdorur nga gjyqtarët e volejbollit;
25. Matës për lartësinë e rrjetës së volejbollit, beach-volley dhe snow-volley;
26. Tapete profesional për volejbolin;
27. Tapete për minivolley dhe street-volley;
28. Sisteme shtyllash profesionale;
29. Rrjetë profesionale volejboli, beach-volley e snow-volley;
30. Antena profesionale volejboli, beach-volley e snow-volley;
31. Shirita profesionalë për vizimin e fushave të beach-volley dhe snow-volley;
32. Pajisje për komunikimin e gjyqtarëve gjatë ndeshjes;

33. Pajisje e cila lidhet me protokollin elektronik "Litescore";
34. Pajisje për "Livestream" të ndeshjeve;
35. Uniforma complete për ekipet kombëtare të të gjithë moshave.

XIX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SKIVE

1. Komplet skish;
2. Porta;
3. Veshje sportive skish;
4. Lift-stërvitor skish;
5. Makinë për prodhim bore "Snougan" (topa bore);
6. Makinë për shtypjen e borës dhe përgatitjen e pistës (Batipista);
7. Motor bore transporti dhe emergjence, "Snouxhet";
8. Pajisje mekanike e rregullimit, kontrollit dhe kolaudimit të skive;
9. Tapet bari plastik për rrëshqitje në kushte verore;

XX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË TAEKWONDOS

1. TATAM-tapet për ndeshje me përmasa 12x12;
2. Matës elektronik pikëzimi;
3. DOBOKE-xhakete, pantallona dhe rrip;
4. Mjete ndihmëse (stërvitore), si pistë vrapimi, thasë dhe llapeta;
5. Komplete për ndeshje (mbrojtëse trupi, mbrojtëse koke-kokore, mbrojtëse gjentiale për meshkuj dhe femra, mbrojtëse e parakrahëve, mbrojtëse kërciri);

XXI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË XHUDOS

1. Tatam (tapet);
2. Tabelë elektronike (matës për mbajtjen e kohës së ndeshjeve, pushimeve, pikët etj.);
3. Kimono (veshje për ndeshje-xhaketa, pantallona, rrip);
4. Peshore elektronike;
5. Tuta komplet (bluzë dhe pantallona);
6. Këpucë sportive;
7. Çanta sportive;
8. Kronometra për stërvitje;

XXII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË TENISIT

1. Raketa për të rritur;
2. Raketa, për fëmijë, të madhësive të ndryshme;
3. Topa të gjelbër për stërvitje;
4. Topa të gjelbër për gara;

5. Topa të butë për stërvitje;
6. Topa me kërcim mesatar për stërvitje;
7. Fije për lidhjen e raketave;
8. Makina për lidhjen e raketave;
9. Minirrjetë tenisi;
10. Shirita për lidhjen e bishtit të raketës;
11. Çanta tenisi;
12. Veshje sportive (tuta, bluza, t-shirte, mbathje, kapele, shirita koke, atlete, etj);
13. Pajisje elektronike dhe ekrane Led për rezultatet dhe regjistrim dhe ritransmetim e pamjeve të rënies së topit në fushë apo jashtë saj;
14. Pajisje elektronike për të gjithë parametrat e lëvizjes së topit (shpejtësi, forcë etj.);
15. Acrilic resurfacër;
16. Court patch Binder;
17. Plexicushion base coat;
18. Plexicushion;
19. Fortified pave (të gjitha ngjyrat);
20. Line Paint Hi-Hide WHITE (Acrilic i bardhë për vijat e fushës);
21. Silica-sand 84 (rërë silici);
22. Amortizatorë raketash tenisi;
23. Fasheta kyçesh (për duar dhe këmbë) (shirita).

XXIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SHAHUT

1. Pajisje elektronike të fushës së shahut;
2. Kompjuter për mësimin e shahut;
3. Tabela elektronike demonstrative;
4. Ora elektronike tryeze, specifike për shahun;
5. Ora elektronike muri për shahun;
6. Fusha dhe gurë shahu (komplete);
7. Tabela demonstrative muri, të thjeshta.
8. Stema, emblema etj;
9. Mbajtëse çelësash;
10. Veshje zyrtare për ekipet përfaqësuese (Kostume etj);
11. Këmisha.

XXIV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BOWLING

1. Pjesë këmbimi mekanike, elektrike e elektronike;
2. Solucione për pastrimin dhe mirëmbajtjen e pistave të bowling-ut;
3. Topa bowling-u;
4. Këpucë për sportistët (që përdoren gjatë linjës);
5. Birila për lojën e bowlingut;

XXV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BILARDOS

1. Tryeza bilardoje (të tipave dhe të përmasave të ndryshme, Pool Snooker, Carom, Birila);
2. Steka të tipave të ndryshme;
3. Aksesorë për tryezat e bilardos (llambadarë, gurë, bilardo, copë për veshje tryezash bilardoje, mbajtëse stekash, sahatë elektronikë, sahatë mbajtës të gurëve, gropa, xhepa, trekëndësha, stanok, kupa etj.

XXVI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BODYBUILDING

1. Boshte shtange dhe pesha të ndryshme;
2. Gira;
3. Makineri (biçikleta statike, makina vrapimi, makina të ndryshme për stërvitjen e grupmuskujve).

XXVII. KOMITETI OLIMPIK SHQIPTAR

1. Materiale promocionale për ekipin olimpiq shqiptar; (Stema, emblema, mbajtëse çelësash, veshje sportive (bluzë tute, tuta, kapele, këpucë sportive), manuale;
2. Veshje përfaqësimi zyrtar (kostume për femra dhe meshkuj, këmisha, këpucë);
3. Aksesorë të ndryshëm për delegacionet sportive zyrtare (flamuj, postera, videofilma, mbajtëse të flakës olimpike, pishtar).

XXVIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË GOLFIT

1. Çanta golfi;
2. Shkopinj golfi për të gjitha moshat;
3. Topa golfi;
4. Fanella golfi;
5. Pantallona golfi;
6. Xhaketa golfi;
7. Këpucë golfi për të gjitha moshat;
8. Simulator golfi;
9. Sete golfi komplet (çantë, shkopinj, topa, peshqirë, kapele, doreza golfi);
10. Pajisje për mirëmbajtje fushe golfi;

XXIX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË RAFTING

1. Gomone;
2. Kanoë;
3. Kayak;
4. Kataraft;
5. Lopata;

6. Skafandra;
7. Veshje *rafting*;
8. Xhup uji;
9. Çorape;
10. Këpucë *rafting*;
11. Kostum sportiv;
12. Bluzë sportive;
13. Xhup sportiv;
14. Kapele;
15. Atlete;
16. Çanta sportive;
17. Aksesorë (litar, bilbil);
18. Prozhektor;
19. Kamerë filmimi antiujë;
20. Aparat fotografik antiujë;

XXX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË AERONAUTIKËS

1. Parashuta;
2. Instrumente variometër;
3. Instrumente gps;
4. Sedilje parashutë;
5. Parashuta rezervë;
6. Veshje pilotësh;
7. Kaska;
8. Avionë të vegjël *ultralight*;
9. Parashuta për ngritje nga toka me tërheqje;
10. Pajisje *vericel* për ngritje velash nga toka;
11. Pajisje aerodelizmi fluturuese;
12. Paramotorë;
13. Erika paramotorësh;

XXXI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË LUNDRIMIT ME VELA

1. Barka dhe mjete lundrimi me vela;
2. Barka dhe mjete lundrimi me motor;
3. Barka dhe mjete lundrimi me rrema;
4. Kanoë;
5. Kayak;
6. Pajisje për transportimin e barkave në tokë dhe në plazh (karele);
7. Pajisje të bregëzimit të mjeteve dhe barkave;
8. Pajisje të ndriçimit në bord, breg, ujë dhe nën ujë;

9. Veshje sportive;

XXXII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SPORTIT PËR TË GJITHË

1. Veshje sportive
2. Shirita kufizues;
3. Materiale dekorative (fjongo, topa, tullumbace);

XXXIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË BADMINTONIT

1. Raketa badmintoni;
2. Tapete fushe badmintoni;
3. Shuttle (fluturashka), plastike dhe pende;
4. Uniforma sportive bluza, mbathje;
5. Komplete kostumi sportiv;
6. Makinë për thurjen e raketës, elektronike;
7. Makinë për thurjen e raketës, manuale;
8. Tabela pikëzimi elektronike;
9. Tabela pikëzimi manuale;
10. Stativ mbajtjeje rrjete;
11. Rrjeta.

XXXIV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SNOOKER-IT

1. Tryeza snookeri (të tipave dhe të përmasave të ndryshme);
2. Steka të tipave të ndryshme;
3. Aksesorë për tryezat e snookerit (llambadarë, gurë, copë për veshje tryezash snookeri, mbajtëse stekash, sahat elektronik, sahat mbajtës të gurëve, gropa, xhepa, trekëndësha, stanok etj.

XXXV. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SPORTIT SHKOLLOR

1. Topa për disiplina të ndryshme sportive stërvitore;
2. Vegla force për palestra shkolle;
3. Dyshek sfungjeri gjimnastike për stërvitje ne shkolle;
4. Tatami (tapet) për mundje dhe disiplinën judo;
5. Kanoë, Lopata për kanoë;
6. Komplet, veshje sportive për ski për moshën 3-18 vjeç;
7. Tapet bari plastik për rrëshqitje me ski në kushte verore për kurse fëmijë, nxënës;
8. Çadra alpine për ekskursione me nxënësit e shkollave;
9. Tabela basketbolli; Mbajtëse tabelash basketbolli; Kosha basketbolli për shkollat
10. Bluza sportive dhe kapele;
11. Tavolina pingpongu, raketa, topa pingpongu;

12. Shirita kufizues;
13. Materiale dekorative (fjongo, topa, tullumbace);
14. Litar kërcimi;
15. Topa Profesional Futbolli;
16. Topa Profesional Volejbolli;
17. Topa Profesional Handbolli;
18. Topa Profesional Basketbolli;
19. Çanta Sportive;
20. Bilbil profesional;
21. Jelek sportiv;
22. Mbajtëse topash;
23. Cadra alpine për ekskursionë për nxënësit e shkollave;
24. Komplete skish;
25. Kalë kërcimi;
26. Pedanë;
27. Shpinore;
28. Kronometra;
29. Megafon;
30. Peshore;
31. Kostume për judo / mosha 5-18 vjeç;

XXXVI. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË SPORTIT UNIVERSITAR

1. Veshje sportive/ T-Shirt;
2. Tuta Sportive(mbathje);
3. Kostume Sportive (bluze + tuta);
4. Xhupa Sportiv;
5. Shirita kufizues;
6. Topa Profesional Futbolli;
7. Topa Profesional Volejbolli;
8. Topa Profesional Hendbolli;
9. Topa Profesional Basketbolli;
10. Çanta Sportive;
11. Materiale dekorative (fjongo);
12. Materiale dekorative (topa);
13. Materiale dekorative (tullumbace);

XXXVII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË VROJTUESVE TË PLAZHIT DHE SHPËTIMIT NË UJË

1. Kamerdare rreth shpëtimit në ujë;

2. Baywatch;
3. Defibrilator;
4. Manikin për përdorim mësimor;
5. Barelë pluskuese shpëtimi;
6. Tavolinë sërfi shpëtimi;
7. Dylbi;
8. Megafon;
9. Jelek shpëtimi;
10. Litar/Cimë;
11. Rul statik;
12. Uniformë Vrojtuesi Plazhi (bluzë, pantallona, xhup sportiv, kapele);
13. Mjet lundrimi me motor (motor boat);
14. Mjet lundrimi pa motor (boat).

XXXVIII. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË ZHYTJES

1. Kompresor për zhytje nënujore;
2. Bombola për zhytje nënujore;
3. Pajisje për zhytje nënujore;
4. Kostume termike për zhytje të thatë dhe të njomë;
5. Xhupa për zhytje nënujore;
6. Rregullator i mishelës së ajrit për zhytje;
7. Gomone motorike;
8. Maskë oksigjeni për zhytje.

XXXIX. ORGANIZATAT SPORTIVE SHQIPTARE TË TEQBALL

1. Tavolinë Teq One;
2. Tavolinë Teq Smart;
3. Tavolinë Teq Lite;
4. Tapet gome / plastike;
5. Shkallë ulëse portative për evente (maksimumi 100 persona);
6. Barriera kufizuese 2.3 x 1.1 m për veprimtari.

VENDIM

Nr. 789, datë 15.12.2021

PËR KRITERET, MËNYRËN E SHPËRBLIMIT DHE TRAJTIMIN E SPORTISTËVE, QË PËRFITOJNË STATUSIN E NIVELIT TË LARTË, DHE TRAJNERËVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për përfitimin nga sportisti të statusit të nivelit të lartë, sipas rezultateve të arritura në veprimtaritë ndërkombëtare apo kombëtare. Klasifikimi i këtyre rezultateve në

veprimtaritë ndërkombëtare dhe kombëtare jepet sipas tabelave I dhe II, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Sportistët mbajnë statusin e nivelit të lartë nga momenti i marrjes së rezultatit zyrtar në veprimtaritë ndërkombëtare apo kombëtare deri në marrjen zyrtare të rezultatit nga një sportist tjetër pasardhës në atë sport.

3. Sportistët, që gëzojnë statusin e nivelit të lartë, përfitojnë shpërblim dhe trajtim, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

4. Masa e shpërblimit financiar, për çdo rezultat të arritur, jepet sipas tabelave I e II, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, e jepet pas shpalljes së rezultateve përfundimtare zyrtare të veprimtarisë sportive nga federata ndërkombëtare/kombëtare e atij sporti.

5. Integrimi i sportistëve në sistemin arsimor me drejtim sportiv, i sigurisë kombëtare e mbrojtjes dhe punësimi i tyre në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme përfitohet vetëm 1 (një) herë brenda periudhës së përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi.

6. Sportistët e sporteve individuale, të kategorisë “të rinj”, që arrijnë rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës I, shpërblehen në masën 30 (tridhjetë) % të vlerës së përcaktuar për kategorinë “të rritur”.

7. Trajnerët e sportistëve, që kanë përfituar statusin e nivelit të lartë, sipas këtij vendimi, shpërblehen në masën 40 (dyzet) % të vlerës që përfiton sportisti me këtë status.

8. Sportistët e nivelit të lartë dhe trajnerët e tyre, pjesëmarrës në veprimtaritë kombëtare, të përcaktuara në rregulloret e federatave sportive përkatëse dhe në veprimtari ndërkombëtare, për përgatitjen e tyre përfitojnë trajtim ushqimor në natyrë ose në vlerë, si dhe trajtim mjekësor.

9. Trajtimi ushqimor është jo më pak se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, për 25 (njëzet e pesë) ditë në muaj.

10. Shpenzimet për trajtimin mjekësor vlerësohen sipas dokumenteve justifikuese për periudhën e trajtimit.

11. Trajtimi ushqimor e mjekësor për periudhën e grumbullimit dhe të pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare të sportistit, sipas tabelës I, në përbërje të ekipit përfaqësues kombëtar, mbulohet nga federata sportive përkatëse.

12. Efektet financiare për shpërblimin e trajtimin e sportistëve të nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre, në sportet individuale, që arrijnë rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës I, përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin. Masa e shpërblimit për sportistët e nivelit të lartë dhe trajnerët e tyre jepet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

13. Për shpërblimin financiar dhe trajtimin e sportistit të nivelit të lartë, për sportet individuale, që kanë marrë rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës I, federata sportive përkatëse paraqet kërkesën pranë ministrisë përgjegjëse për sportin. Të drejtën për të paraqitur kërkesë e ka edhe sportisti apo trajneri i tij. Kërkesa shoqërohet me rezultatin përfundimtar të analizave *doping*, referuar veprimtarisë ndërkombëtare, në të cilën sportisti ka marrë rezultatin. Ministria përgjegjëse për sportin verifikon përmbushjen e kriterëve pas marrjes së kërkesës. Fondet alokohen për llogari të sportistit dhe të trajnerit të tij.

14. Gjatë vitit kalendarik, përjashtuar periudhën e grumbullimit dhe të pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare të sportistit, sipas tabelës I, sportisti dhe trajneri i tij përfitojnë trajtim ushqimor e mjekësor për përgatitjen sportive dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë kombëtare zyrtare.

15. Efektet financiare për shpërblimin e trajtimin e sportistëve të nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre, që arrijnë rezultate në veprimtaritë kombëtare, sipas tabelës II, përballohen nga fondet e njëjseve

të vetëqeverisjes vendore ose të ardhura të tjera të ligjshme. Masa e shpërblimit për sportistët e nivelit të lartë dhe trajnerët e tyre jepet me urdhër të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

16. Për shpërblimin financiar dhe trajtimin e sportistit të nivelit të lartë, për sportet individuale, apo të ekipit sportiv, për sportet kolektive, që kanë marrë vendin e parë në kampionatin kombëtar, organizata sportive përkatëse, që ushtron veprimtarinë në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, paraqet kërkesën pranë saj. Të drejtën për të paraqitur kërkesë e ka edhe sportisti apo trajneri i tij. Kërkesa shoqërohet me rezultatin përfundimtar të federatës shqiptare të atij sporti, referuar kampionatit kombëtar, në të cilin sportisti apo ekipi sportiv ka marrë vendin e parë. Njësia e vetëqeverisjes vendore verifikon përmbushjen e kriterëve pas marrjes së kërkesës. Fondet alokohen për organizatën sportive të sportistit/ekipit sportiv dhe trajnerit të tij, për llogari të këtyre të fundit.

17. Sportistët, të cilët kanë përfituar statusin e nivelit të lartë, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 105/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017, ‘Për sportin’”, trajtohen sipas parashikimeve të këtij vendimi.

18. Vendimi nr. 687, datë 14.11.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë”, shfuqizohet.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, njësiti e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Tabela I

VEPRIMTARITË NDËRKOMBËTARE ZYRTARE

Veprimtaria	Rezultati	Masa e shpërblimit
	Rekord olimpik	15 000 000 lekë
	Rekord botëror	15 000 000 lekë
	Rekord evropian	6 000 000 lekë
	Rekord mesdhetar	3 000 000 lekë
	Rekord ballkanik	1 500 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i dytë	7 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tretë	5 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i katërt	3 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i pestë	2 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i gjashtë	1 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i shtatë	800 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tetë	500 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i dytë	6 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tretë	4 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i katërt	2 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i pestë	1 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i gjashtë	800 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i shtatë	600 000 lekë

Kampionat botëror	Vendi i tetë	400 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i parë	4 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i dytë	2 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i tretë	1 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i katërt	800 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i pestë	600 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i gjashtë	400 000 lekë
Lojëra Mesdhetare	Vendi i parë	2 000 000 lekë
Lojëra Mesdhetare	Vendi i dytë	1 000 000 lekë
Lojëra Mesdhetare	Vendi i tretë	800 000 lekë
Kampionati Ballkanik	Vendi i parë	1 000 000 lekë

VENDIM

Nr. 870, datë 30.12.2021

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “EKIPET SPORTIVE-2022” NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pikat 1 e 2, dhe 15, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin në masën 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë të projektit “Ekipet sportive 2022”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH).

2. Fondi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), në bankën e nivelit të dytë/”Raiffeisen Bank” sh.a., me numër llogarie 0050249325, dhe përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2021 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, përkatësisht në llogarinë ekonomike 604 “Transferta të brendshme”, në programin buxhetor 08140 “Zhvillimi i sportit”.

3. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), brenda muajit janar 2022, të paraqesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit projektin e detajuar dhe të miratuar nga Asambleja e KOKSH-it, duke identifikuar të gjitha aktivitetet/produktet e projektit, kohëzgjatjen e zbatimit të projektit, federatat dhe organizmat e tjerë përfitues nga projekti. Projekti duhet të jetë i kostuar me të gjithë produktet/zërat analitikë të shpenzimeve, në përputhje me klasifikimin ekonomik buxhetor të tyre.

4. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) raporton, periodikisht, mbi bazë katërmujore pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, mbi ecurinë e aktiviteteve/produkteve dhe realizimin financiar të projektit.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit cakton një grup pune për mbikëqyrjen e realizimit të projektit.

Përbërja dhe detyrat e grupit të punës përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 56, datë 26.1.2022

PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE TË SIGURISË, PËRGJEGJËSIVE DHE MËNYRAVE TË RUAJTJES SË SIGURISË NË VEPRIMTARITË SPORTIVE DHE NDESHJET E FUTBOLLIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 51, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit e të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky vendim përcakton masat e sigurisë, përgjegjësitë dhe mënyrat e ruajtjes së sigurisë në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit, me qëllim sigurimin e një mjedisi të qetë, të sigurt e mirëpritës gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Dhoma e kontrollit”, dhoma e rezervuar për stafin e zyrtarët me përgjegjësi për çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë, që lidhen me veprimtaritë sportive, përkatësisht punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, oficeri i sigurisë i organizatës sportive, organizatore e veprimtarisë sportive, oficeri i sigurisë së mjedisit sportiv dhe stafi i tyre;

b) “Masat e sigurisë”, masat e synuara a të zbatuara me qëllim kryesor parandalimin, uljen e rrezikut dhe reagimin ndaj çdo forme dhune ose aktiviteti tjetër kriminal apo prishjeje të rendit e të sigurisë publike, të kryer në lidhje me një veprimtari sportive, brenda ose jashtë një mjedisi sportiv;

c) “Mjedis sportiv”, një hapësirë e mbuluar ose jo, e rrethuar ose jo, e destinuar për organizimin e veprimtarive sportive, si: lojëra sportive, gara sportive, palestra sportive ose *fitness*-i apo e përdorur përkohësisht për organizimin e veprimtarive sportive promovionale, lojërave zbavitëse dhe

veprimtarive sportive rekreative;

ç) “Oficeri ndërlidhës për tifozët”, personi që vepron si pika kryesore e kontaktit për tifozët e një organizate sportive;

d) “Organizatori i veprimtarisë sportive”, një ose disa organizata sportive ose entitete të tjera, përgjegjëse për organizimin e një veprimtarie sportive;

dh) “Personeli i sigurisë”, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Policisë Bashkiake dhe të sigurisë private, të angazhuar me ruajtjen e rendit e të sigurisë publike në një veprimtari sportive;

e) “Punonjës sigurie”, një individ i trajnuar, i cili ushtron funksionet e përcaktuara të mbrojtjes e të sigurisë në mjedisin sportiv dhe përreth tij;

ë) “Qasje e integruar”, qasja, që, pavarësisht nga qëllimi i tyre kryesor, masat e rendit, sigurisë dhe shërbimit në veprimtaritë sportive janë të ndërlidhura, në kuptimin e ndikimit, dhe të balancuara e nuk mund të projektohen dhe të zbatohen të izoluar;

f) “Sistemi i adresimit të publikut”, një sistem elektronik i altoparlantëve, i aftë për të komunikuar në çast mesazhe të qarta për të gjithë tifozët e pjesëmarrësit;

g) “Sistemi i kamerave me qark të mbyllur”, sistemi me kamera fikse me lëvizje horizontale dhe vertikale për monitorimin e tifozëve, të rrugëve, të hyrjeve dhe të zonave të shikimit brenda mjedisit sportiv.

KREU II

PËRGJEGJËSITË PËR RUAJTJEN E SIGURISË NË VEPRIMTARITË SPORTIVE

Neni 3

Detyrat e federatave shqiptare sportive

1. Federata shqiptare e një sporti të caktuar, për organizimin e veprimtarive zyrtare me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë, merr masa për parandalimin e dhunës, si dhe promovon *fair-play*-n e tolerancën.

2. Federata shqiptare e një sporti të caktuar harton rregulloren me masat e sigurisë, përgjegjësitë dhe mënyrat e ruajtjes së sigurisë në veprimtaritë sportive zyrtare, kombëtare dhe ndërkombëtare, që zhvillohen prej saj apo prej organizatave sportive, anëtare të saj, në përputhje me kategorinë e veprimtarisë sportive.

3. Rregullorja, sipas pikës 2 të këtij neni, miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Federatës, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe është e detyrueshme për zbatim nga organizatat sportive, anëtare të federatës.

4. Federata shqiptare e një sporti të caktuar duhet të njoftojë ministrinë përgjegjëse për sportin, Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga miratimi i rregullores, sipas përcaktimeve të këtij neni.

Neni 4

Kategorizimi i veprimtarive sportive

Referuar rëndësisë dhe nivelit të vështirësisë në organizimin dhe në administrimin e tyre, veprimtaritë sportive kategorizohen, si më poshtë vijon:

a) Kategoria 1, veprimtaria sportive ndërkombëtare, ku parashikohet pjesëmarrje masive e tifozëve dhe e pjesëmarrësve e me ndikim të madh, si dhe çdo veprimtari tjetër sportive, që klasifikohet nga

organizatorët, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, si veprimtari me risk të lartë;

b) Kategoria 2, veprimtaria sportive ndërkombëtare, ku parashikohet pjesëmarrje masive e tifozëve dhe e pjesëmarrësve e me ndikim rajonal apo më gjerë, apo veprimtari sportive kombëtare, ku parashikohet pjesëmarrje masive e tifozëve, e cila, nga organizatorët, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, klasifikohet si veprimtari me risk të mesëm;

c) Kategoria 3, veprimtaria sportive kombëtare me pjesëmarrje të vogël tifozësh, e cila, nga organizatorët, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, klasifikohet si veprimtari me risk të ulët;

ç) Kategoria 4, veprimtaria sportive lokale me pjesëmarrje të sportistëve të moshave të vogla, e cila, nga organizatorët, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, klasifikohet si veprimtari me risk të ulët.

Neni 5

Oficeri i sigurisë

Për veprimtaritë sportive të kategorive 1 dhe 2 merren masat e mëposhtme për ruajtjen e sigurisë:

a) Organizatori i veprimtarisë sportive cakton oficerin e sigurisë, sipas kriterëve të përcaktuar në ligjin nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, i cili është:

- i. oficeri i sigurisë i organizatës sportive, organizatore e veprimtarisë sportive;
- ii. oficeri i sigurisë i mjedisit sportiv.

b) Oficeri i sigurisë:

i. mban kontakte me autoritetet e Policisë së Shtetit, shërbimet mjekësore dhe oficerin ndërlidhës për tifozët;

ii. përgjigjet për vlerësimin dhe raportimin tek organizatori i veprimtarisë sportive, duke marrë masa që ata të mos ndikojnë në sigurinë e veprimtarisë;

iii. përgjigjet për vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve, si dhe për marrjen e masave në koordinim me Policinë e Shtetit, shërbimet e emergjencës, autoritetet publike dhe çdo subjekt tjetër të përfshirë në menaxhimin e ngjarjes;

iv. zhvillon, zbaton e rishikon politikat dhe procedurat e mbrojtjes e të sigurisë, duke përfshirë menaxhimin dhe planifikimin e rreziqeve;

v. menaxhon operacionet e mbrojtjes e të sigurisë në veprimtarinë sportive;

vi. në bashkëpunim me organizatorin e veprimtarisë sportive, siguron që infrastruktura, sistemet dhe pajisjet e mjedisit sportiv të jenë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë sportive.

Neni 6

Bashkëpunimi me autoritetet publike

1. Organizatori i veprimtarisë sportive është përgjegjës për ndërlidhjen me autoritetet publike në territorin, ku organizohet veprimtaria sportive, për të siguruar bashkëpunimin e koordinimin me to në zbatimin e masave.

2. Në bashkëpunim me autoritetet publike, organizatori i veprimtarisë sportive përfshin procedura të qarta për çështje, që ndikojnë në menaxhimin e turmës dhe rreziqet e mbrojtjes e të sigurisë, në veçanti, të përdorimit të lëndëve piroteknike, të sjelljeve të dhunshme, raciste ose diskriminuese, në përputhje me legjislacionin.

3. Administratorët e mjediseve sportive marrin masa për caktimin e një ambienti të përshtatshëm

për drejtuesit e njësisë policore për monitorimin e situatës së rendit e të sigurisë në mjedisin sportiv.

Neni 7

Detyrimi për informim

1. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1, 2 dhe 3 njofton zyrtarisht Policinë e Shtetit për kalendarin e veprimtarive sportive para nisjes së sezonit sportiv, si dhe për çdo ndryshim të bërë gjatë sezonit.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1, 2 dhe 3 është i detyruar të njoftojë me shkrim Policinë e Shtetit dhe njësitë e qeverisjes vendore, të paktën 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara zhvillimit të saj, me qëllim planifikimin e të gjitha masave të nevojshme të sigurisë për mbarëvajtjen e saj për:

a) vendin, datën dhe orën e organizimit të veprimtarisë;

b) numrin e tifozëve, që priten të marrin pjesë;

c) kontaktet e nevojshme të zyrtarëve të veprimtarisë, të oficerit të sigurisë apo informacione të tjera të dobishme;

ç) shërbimin privat të sigurisë fizike (SHPSF), policinë bashkiake apo shoqatën e vullnetarëve, agjenci të specializuara të shërbimit të kontraktuar për marrjen e masave të sigurisë dhe të shërbimit në mjediset sportive, si dhe numrin e punonjësve të saj, që do aktivizohen në rolin e personelit të sigurisë, përpara, gjatë dhe pas veprimtarisë sportive;

d) vendimet e marra nga komisionet përkatëse të federatës, nëse ka të tilla, për shkeljet e konstatuara lidhur me veprimtarinë sportive.

3. Organizatori i veprimtarisë sportive njofton e merr masa për pjesëmarrjen në veprimtari të subjekteve të tjera, si:

a) shërbimi i ndihmës së parë, urgjenca mjekësore dhe Kryqi i Kuq;

b) SHPSF-ja, kontraktuar për mbulimin e shërbimit të sigurisë, apo policia bashkiake;

c) struktura e operatorit publik të energjisë elektrike për masat në sigurimin e rrymës elektrike në mjedisin sportiv.

4. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1 dhe 2, përveç subjekteve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, njofton për pjesëmarrjen në veprimtari edhe Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

5. Policia bashkiake apo SHPSF-ja, e kontraktuar nga organizatori i veprimtarisë sportive për mbulimin e shërbimit të sigurisë, njofton zyrtarisht Policinë e Shtetit:

a) 5 (pesë) ditë para organizimit të veprimtarisë sportive, për:

i. marrjen përsipër të ofrimit të shërbimeve të sigurisë përpara, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes;

ii. kontratën e nënshkruar me organizatorin e veprimtarisë, si dhe numrin e punonjësve, që do të angazhohen me shërbim;

iii. planin e dislokimit të punonjësve të sigurisë, brenda dhe jashtë mjedisit sportiv;

b) për incidentet e ndodhura gjatë kryerjes së shërbimit.

6. Policia e Shtetit informon zyrtarisht organizatorin e veprimtarisë sportive, për:

a) masat e marra për garantimin e sigurisë së veprimtarisë;

b) personat e kontaktit në strukturat qendrore apo vendore të Policisë së Shtetit;

c) problemet e mangësitë e konstatuara;

ç) masat administrative të marra ndaj tifozëve apo grup-tifozëve për shkeljet e ndryshme të

konstatuara.

7. Policia e Shtetit mund të informojë organizatorin e veprimtarisë sportive të një sporti të caktuar mbi bazën e kërkesës me shkrim, për procedimet penale ndaj personave që janë në proces hetimi ose gjykimi apo që janë dënuar për veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal lidhur me veprimtaritë sportive të atij sporti.

Neni 8

Identifikimi i personave përgjegjës dhe inspektimi i mjedisit sportiv

Organizatori i veprimtarisë sportive:

- a) identifikon punonjës të Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, dhe zyrtarin e mbrojtjes e të sigurisë;
- b) identifikon të gjithë individët e tjerë përgjegjës për mbrojtjen dhe sigurinë, shërbimet mjekësore dhe zjarrfikëset;
- c) siguron që mjedisi sportiv i veprimtarisë të inspektohet imtësisht dhe të jetë lëshuar një certifikatë sigurie nga autoriteti përgjegjës. Certifikata e sigurisë të jetë e vlefshme para datës së veprimtarisë sportive dhe vendoset në dispozicion të federatës kombëtare ose ndërkombëtare, sipas kërkesës dhe kategorisë së veprimtarisë sportive.

Neni 9

Koordinimi i personelit të sigurisë

1. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1 dhe 2 dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, bien dakord për strukturën e komandës e të kontrollit për veprimtarinë sportive dhe sigurojnë që ajo të jetë e dokumentuar, duke përfshirë rrethanat, kur kontrolli i mjedisit sportiv transferohet nga organizatori i veprimtarisë sportive te Policia e Shtetit.
2. Organizatori i veprimtarisë sportive siguron që të ketë punonjës sigurie dhe/ose vullnetarë, për të garantuar sigurinë e tifozëve dhe të pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive brenda mjedisit sportiv dhe të publikut në ambientet rrethuese në afërsi.
3. Policia e Shtetit është në dispozicion për të mbështetur punonjësit e sigurisë dhe SHPSF-në, për të përballuar shpërthimin e dhunës ose prishjen e rendit.

Neni 10

Grupi i menaxhimit të sigurisë së veprimtarisë sportive (GMSVS)

1. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1 dhe 2 krijon GMSVS-në, që përfshin:
 - a) një zyrtar të lartë, i cili vepron në emër të organizatorit të veprimtarisë sportive;
 - b) një përfaqësues të lartë nga:
 - i. çdo autoritet publik apo përfaqësues të agjencive, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin;
 - ii. punonjës të sigurisë (SHPSF, polici bashkiake apo vullnetarë);
 - iii. pronari apo administratori i mjedisit sportiv;
 - iv. ekipet pjesëmarrëse në veprimtari.
 - c) oficerin e sigurisë së organizatorit të veprimtarisë sportive apo të mjedisit sportiv;
 - ç) delegatin e organizatës sportive ndërkombëtare të sportit përkatës, nëse ka;

- d) oficerin e sigurisë së organizatës sportive ndërkombëtare të sportit përkatës, nëse ka.
2. Organizatori i veprimtarisë sportive identifikon një vend të përshtatshëm takimi brenda mjedisit sportiv, ku grupi takohet në rast të një incidenti të rëndë apo emergjence.
3. Anëtarët e GMSVS-së thirren për takim, nëpërmjet një shenje apo thirrjeje të shkurtër, të koduar, e cila transmetohet nëpërmjet sistemit të adresimit të publikut.
4. Organizatori i veprimtarisë sportive siguron që anëtarët e GMSVS-së të jenë në gjendje të komunikojnë lirisht me telefon ose radio me dhomën e kontrollit të mjedisit sportiv apo me një vend tjetër, ku zhvillohet takimi i GMSVS-së.

KREU III

MËNYRAT DHE MASAT PËR RUAJTJEN E SIGURISË NË VEPRIMTARITË SPORTIVE

Neni 11

Strategjia dhe planifikimi i ndarjes së tifozëve dhe e shpërndarjes së turmave

1. Në një veprimtari sportive, ku tifozët janë të veçuar, nga organizatori i veprimtarisë sportive, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe/ose oficerin e sigurisë, hartohet një strategji e ndarjes. Nëse është e nevojshme, kjo strategji përfshin, gjithashtu, një strategji parkimi për grupe të ndryshme tifozësh.
2. Strategjia e shpërndarjes së turmës në fund të veprimtarisë diskutohet në takimin organizativ mëngjesin para veprimtarisë.
3. Numri dhe kualifikimet e ofruesve të ndihmës të parë, të caktuar për të ofruar trajtim të ndihmës së parë për tifozët, miratohet nga autoritetet publike përkatëse, të cilat përcaktojnë gjithashtu numrin e ambulancave, që do të jenë në vend gjatë veprimtarisë sportive.
4. Ofruesit e ndihmës së parë duhet të dallohen lehtësisht.
5. Për Policinë e Shtetit, shërbimin mjekësor dhe zjarrfikëset, në përputhje me kërkesat e autoriteteve publike, duhet të ofrohen dhoma dhe ambiente të përshtatshme brenda e përreth mjedisit sportiv.

Neni 12

Informacionet për të gjithë tifozët

Organizatori i veprimtarisë sportive ofron informacionin e mëposhtëm për të gjithë tifozët:

- a) orën e hapjes së mjedisit sportiv, ku zhvillohet veprimtaria;
- b) hartën e mjedisit sportiv, brenda dhe përreth tij, duke përfshirë rrugët e hyrjes, vendparkimet, ndalesat e transportit publik dhe vendndodhjen e sektorëve të shikimit;
- c) rregulloret bazë të mjedisit sportiv, duke përfshirë ndalimin e:
 - i. hyrjes në to nën efektin e alkoolit;
 - ii. zotërimit e të përdorimit të lëndëve piroteknike dhe të mjeteve ofenduese;
 - iii. sendeve dhe të lëndëve të ndaluara brenda mjedisit sportiv;
 - iv. hedhjes së ndonjë sendi;
 - v. hyrjes së paautorizuar në zonën e lojës;
 - vi. përdorimit të gjuhës raciste, homofobike, fyese dhe abuzive;
 - vii. qëndrimit në këmbë në një zonë me ulëse.

Neni 13

Informacionet për tifozët miq për veprimtaritë sportive ndërkombëtare

Për veprimtaritë zyrtare sportive ndërkombëtare në Shqipëri, organizatori i veprimtarisë i ofron, nëpërmjet faqes së tij në internet, klubit mik sa më shumë informacion që është e mundur, për t'ua shpërndarë tifozëve miq, duke përfshirë:

- a) kërkesat për vizë, nëse ka;
- b) kufizimet e importit doganor;
- c) njësitë valutore dhe vlerat ekuivalente në monedhën vendëse;
- ç) distancat nga pikat e ndryshme të mbërritjes (aeroporti, stacioni, porti) deri në qendër të qytetit dhe deri te mjedisi sportiv, ku zhvillohet veprimtaria sportive;
- d) adresën e pikës së kontaktit, në raste emergjence, dhe emrin e kontaktit të organizatorit të veprimtarisë sportive jashtë vendit;
- dh) adresën dhe numrin e telefonit të ambasadës ose të konsullatës lokale;
- e) hartën e mjedisit sportiv, brenda dhe rreth tij, që tregon sektorët e ndryshëm, rrugët e hyrjes nga qyteti dhe vendndodhjen e zonave të caktuara të parkimit;
- ë) hollësitë e shërbimeve të transportit publik nga qendra e qytetit deri te mjedisi sportiv;
- f) dispozitat specifike ligjore lidhur me sjelljen e gabuar në veprimtaritë sportive në shtetin pritës;
- g) sendet e ndaluara brenda mjedisit sportiv;
- gj) treguesit e çmimeve mesatare për ushqimin, tarifat e taksive dhe të transportit publik;
- h) paralajmërimet e autoriteteve lokale për shëndetin, nëse ka.

Neni 14

Ekipi mik dhe tifozët, siguria e ekipit mik

1. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1 dhe 2 bën një vlerësim të rrezikut, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe, sa herë që nuk ofrohet shoqërimi nga Policia e Shtetit për lëvizjen e ekipeve dhe të zyrtarëve, arsyet duhet të regjistrohen në këtë vlerësim të rrezikut.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive kërkon bashkëpunimin e Policisë së Shtetit për të garantuar sigurinë e ekipit mik e të zyrtarëve të tij në hotelin e tyre dhe kur udhëtojnë për në vendin e trajnimit e të ndeshjes.

Neni 15

Udhëtimi i tifozëve miq

1. Organizatori i veprimtarisë sportive të kategorive 1 dhe 2 dhe federatat ose klubet e ekipeve pjesëmarrëse, pas vlerësimit të rrezikut dhe nëse këshillohet, marrin masa për të mos lejuar udhëtimin e tifozëve për ndjekjen e veprimtarisë sportive.

2. Për veprimtaritë sportive të kategorive 1 dhe 2, ku do të marrin pjesë tifozët e një klubi mik, ofrohen punonjës të sigurisë dhe oficerë ndërlidhës për tifozët nga klubi mik, për të shoqëruar e ndihmuar tifozët që udhëtojnë. Oficerët ndërlidhës për tifozët mundësojnë komunikimin për organizatorët e ndeshjes, autoritetet publike dhe tifozët. Punonjësit e sigurisë ndihmojnë tifozët gjatë udhëtimit të tyre nga vendi i nisjes drejt vendit ku do të organizohet veprimtaria sportive dhe anasjelltas. Numri i punonjësve të sigurisë të federatës ose të klubit pritës nuk duhet të ulet, për shkak të pranisë së punonjësve të sigurisë të federatës ose klubit mik.

3. Numri i punonjësve të sigurisë që udhëtojnë duhet të jetë proporcional me numrin e tifozëve që udhëtojnë. Për çdo 500 (pesëqind) deri në 1 000 (një mijë) tifozë ofrohen 2 (dy) punonjës të sigurisë që udhëtojnë. Katër punonjës të tjerë të sigurisë që udhëtojnë ofrohen për çdo 1 000 (një mijë) tifozë shtesë ose më pak që do të udhëtojnë. Oficerët ndërlidhës për tifozët mund të përfshihen në numrin e përgjithshëm të punonjësve të sigurisë që udhëtojnë.

4. Kur federata ose klubi mik nuk i plotëson kërkesat e mësipërme për të ofruar punonjës të sigurisë që udhëtojnë, mund të vendoset si masë disiplinore një ulje e pjesshme, prej 5 (pesë) %, ose totale e numrit të biletave për ndeshjet e ardhshme, që përfshijnë federatën a klubin përkatës.

Neni 16

Bileta dhe të dhënat e mbajtësit të saj

1. Organizatori i veprimtarisë sportive mban të dhëna personale të personave, të cilëve u shiten ose u jepen biletat, ku përfshihen emri, data e lindjes dhe adresa.

2. Të dhënat personale, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për veprimtaritë e kategorive 1 dhe 2, vihen në dispozicion, sipas kërkesës të Policisë së Shtetit, në vendin ku zhvillohet veprimtaria, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Kur biletat u ndahen palëve të treta për shpërndarje, duke përfshirë klubet e tifozëve, organizatori i ndeshjes, federata ose klubi përkatës sigurohen që këto palë të treta të mos u japin bileta marrësve, të cilët nuk kanë paraqitur dokumente identifikimi.

4. Kur pala, sipas përcaktimit të pikës 3 të këtij neni, nuk i plotëson kërkesat në lidhje me regjistrimin e të dhënave të mbajtësit dhe vënien në dispozicion të këtyre të dhënave, mund të vendoset si masë disiplinore një ulje e pjesshme, prej 5 (pesë) % ose totale e numrit të biletave për ndeshjet e ardhshme që përfshijnë këtë palë.

5. Pala, sipas përcaktimit të pikës 3 të këtij neni, ofron të gjitha informacionet e mundshme për numrin e personave që besohet se po udhëtojnë për të ndjekur një ndeshje në vendin pritës, pa bileta. Informacioni ofrohet, gjithashtu, për kërkesën e mundshme për bileta nga tifozët e ekipit mik, që jetojnë në vendin pritës.

Neni 17

Hapja e portave të mjedisit sportiv për tifozët

Organizatori i veprimtarisë sportive, së bashku me punonjësin e Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, dhe oficerin e sigurisë vendosin orën kur hapen dyert e mjedisit sportiv për tifozët, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

a) kapacitetin e hyrjes, i cili përcaktohet nga numri maksimal i tifozëve, që mund të hyjnë në mënyrë të sigurt në mjedisin sportiv në një periudhë njëorëshe, në bazë të normës së hyrjes ose të rrjedhës së kalimit në pajisjen rrotulluese, për mjedisin sportiv në tërësi dhe për secilin sektor të mjedisit sportiv në veçanti;

b) numrin e parashikuar të tifozëve dhe kapacitetin e përgjithshëm maksimal të sigurt të mjedisit sportiv;

c) strategjinë e ndarjes jashtë mjedisit sportiv.

Neni 18

Kontrolli i mjedisit sportiv dhe ndalimi i hyrjes në të

1. Organizatori i veprimtarisë sportive sigurohet, që:

a) mjedisi sportiv të ruhet nga ndërhyrja e paautorizuar për një periudhë të përshtatshme para ditës së veprimtarisë sportive. Kjo periudhë përcaktohet në përputhje me vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut të ndërmarrë për veprimtarinë nga organizatori i saj dhe autoritetet publike;

b) të kryhet një kontroll i hollësishëm i sigurisë në mjedisin sportiv për persona të paautorizuar, sende dhe lëndë të ndaluara, para se të pranohen tifozët.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive bashkëpunon me njësinë e Policisë së Shtetit për t'u siguruar që çdo personi që i ndalohej hyrja në mjedisin sportiv për ndonjë nga arsyt e parashikuara nga ligji, sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë komisarariatit të Policisë së Shtetit, nën juridiksionin e të cilit zhvillohet veprimtaria sportive, ku është konstatuar kundërvajtja, ose që është dëbuar nga mjedisi sportiv, të mos pranohet ose ripranohet dhe që personi të mbahet larg nga mjedisi sportiv gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive.

Neni 19

Tabelat treguese

Kur sistemi i biletave është i koduar me ngjyra, që përputhet me paraqitjen e sektorit, ngjyrat e duhura duhet të shfaqen në të gjitha tabelat treguese që drejtojnë tifozët në sektorë të ndryshëm të mjedisit sportiv.

Neni 20

Ndarja e tifozëve

1. Nëse kërkohet nga rrethanat, ndarja e grupeve të ndryshme të tifozëve fillon sa më larg që të jetë e mundur nga mjedisi sportiv, për t'u mbrojtur nga përzierja e padëshirueshme e tyre në hyrjet e mjedisit sportiv ose në zonat e pajisjeve rrotulluese, për kalimin e vetëm një personi.

2. Për grupet e ndryshme të tifozëve sigurohen vendparkime të ndara për makinat dhe autobusët, mundësisht në anë të ndryshme të mjedisit sportiv dhe sa më afër sektorëve të tyre përkatës të shikimit.

Neni 21

Rrugët e kalimit dhe kufizimi i lëvizjes së tifozëve

1. Organizatori i veprimtarisë sportive merr masa për të siguruar që të gjitha rrugët e kalimit të tifozëve, korridoret, shkallët, dyert, portat dhe rrugët e daljes në raste emergjente të jenë të lira nga çdo pengesë, e cila mund të pengojë kalimin e lirë të tyre.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive merr masa për t'u siguruar që tifozët të mos lëvizin nga njëri sektor në tjetrin.

3. Nëse është e nevojshme prania e më shumë se një grupi tifozësh në një sektor të veçantë, vendoset një ndarje ndërmjet tyre me anë të një barriere të kontrolluar nga personeli i sigurisë ose duke krijuar një "zonë të ndaluar", pa tifozë, ku qëndron vetëm personeli i sigurisë.

Neni 22

Dyert dhe portat e mjediseve sportive të mbyllura

Organizatori i veprimtarisë sportive merr masa për të siguruar që:

a) dyert dhe portat e daljes së mjediseve sportive të mbyllura, si dhe portat që lidhin zonat e tifozëve me zonën e zhvillimit të veprimtarisë sportive të jenë të shkyçura ndërkohë që ata janë në mjedis sportiv;

b) në secilën prej dyerve a portave qëndron në çdo moment një punonjës i sigurisë i caktuar posaçërisht për të siguruar rrugë të menjëhershme evakuimi në raste emergjente;

c) në rastin e dyerve të daljes dhe të portave rrethuese, që kontrollohen e hapen nga distanca me mjete elektronike ose magnetike, kontrolli i funksionimit të këtij mekanizmi duhet të vendoset në dhomën e kontrollit. Sistemi i hapjes në distancë testohet para çdo veprimtarie sportive.

Neni 23

Prania e personelit të sigurisë

1. Personeli i sigurisë, ofruesit e ndihmës së parë, personeli i shërbimit mjekësor dhe personeli i zjarrfikësve, si dhe njoftuesit e adresimeve për publikun janë në pozicionet e tyre të caktuara brenda dhe rreth mjedisit sportiv, përpara se mjedisi sportiv të hapet për tifozët, dhe qëndrojnë në këto pozicione gjatë gjithë kohës që tifozët janë në stadium e derisa turma të jetë shpërndarë, në përputhje me udhëzimet e punonjësit të Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, ose të oficerit të sigurisë.

2. Pajisjet rrotulluese, dyert dhe portat e hyrje-daljes janë operacionale dhe monitorohen nga personeli i sigurisë.

3. Personeli i sigurisë është i disponueshëm në hyrjet e mjedisit sportiv, te pajisjet rrotulluese dhe në brendësinë e mjedisit sportiv, sipas vlerësimit të oficerit të sigurisë.

4. Personeli i sigurisë është në detyrë brenda mjedisit sportiv për t'u siguruar që tifozët të drejtohen në vendet e tyre pa vonesa dhe konfuzion.

5. Personeli i sigurisë njih planimetrinë e mjedisit sportiv dhe procedurat e sigurisë, të emergjencës e të evakuimit.

Neni 24

Kontrolli i tifozëve

1. Tifozët kontrollohen fillimisht nga personeli i sigurisë në gardhin e perimetrit të jashtëm, nëse ka një të tillë ose në kordonin e jashtëm të krijuar nga personeli i sigurisë në rastin e mjediseve, që nuk kanë një gardh të jashtëm rrethues, për t'u siguruar që vetëm mbajtësit e biletave të afrohen te pajisjet rrotulluese dhe për të bërë kontrollet e para për të parandaluar futjen e objekteve apo të lëndëve të ndaluara në mjedisin sportiv.

2. Kontrollet dhe kërkimet përfundimtare kryhen nga personeli i sigurisë jashtë pajisjeve rrotulluese për t'u siguruar, që:

a) tifozët të hyjnë në pjesën e duhur të mjedisit sportiv;

b) tifozët të mos sjellin në mjedisin sportiv pije alkoolike, fishekzjarrë, flakadanë, lëndë piroteknike dhe sende të tjera të forta, të rrezikshme për jetën e shëndetin e pjesëmarrësve, që ka të ngjarë të përdoren në akte dhune;

c) hyrja është e ndaluar për personat e njohur a të mundshëm që cenojnë rendin e sigurinë ose personat që janë nën ndikimin e alkoolit apo të lëndëve narkotike.

3. Çdo tifoz kontrollon nga një anëtar i personelit të sigurisë i së njëjtës gjini.

Neni 25

Mbrojtja e zonës së zhvillimit të veprimtarisë sportive

1. Organizatori i veprimtarisë sportive siguron që sportistët e zyrtarët e veprimtarisë sportive të mbrohen nga ndërhyrja e tifozëve në zonën e zhvillimit të veprimtarisë sportive.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive siguron që zona e zhvillimit të veprimtarisë sportive të mbrohet nga ndërhyrja e tifozëve në të.

Neni 26

Dhoma e kontrollit të mjedisit sportiv

1. Organizatori i veprimtarisë sportive, në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren e federatës ndërkombëtare të sportit përkatës, siguron një qasje të integruar për mbrojtjen, sigurinë dhe shërbimet me anë të dhomës së kontrollit të mjedisit sportiv, sistemit të kamerave me qark të mbyllur dhe sistemeve të monitorimit e të komunikimit.

2. Oficeri i mbrojtjes dhe i sigurisë, punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, dhe përfaqësuesit e shërbimeve të tjera mjekësore vendosen në dhomën e kontrollit për të reaguar ndaj incidenteve në mjedisin sportiv dhe rreth tij.

3. Sistemi i kamerave me qark të mbyllur i mjedisit sportiv përdoret nga punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, dhe oficeri i mbrojtjes dhe sigurisë, për të monitoruar tifozët, rrugët e hyrjet në mjedis sportiv, si dhe zonat e shikimit brenda tyre.

4. Në rastin e mjediseve sportive të kategorive 1 dhe 2, ku nuk ka dhomë kontrolli, planet duhet të jenë në dispozicion në një vend të paracaktuar brenda mjedisit sportiv.

Neni 27

Përsëritjet në ekranet gjigante

Organizatori i veprimtarisë sportive siguron që imazhet, të cilat shfaqen gjatë veprimtarisë në ekranin gjigant të mjedisit sportiv, nuk nxisin ndonjë formë të prishjes së rendit dhe të sigurisë. Imazhet e shfaqura duhet të respektojnë parimet e *fair-play*-t dhe nuk duhet të jenë me zë.

Neni 28

Sistemi i adresimit të publikut

1. Sistemi i adresimit të publikut të mjedisit sportiv duhet të dëgjohet qartë, brenda dhe jashtë mjedisit sportiv, në të gjitha rrethanat, duke marrë parasysh veçanërisht zhurmën e tepërt të turmës.

2. Folësit e trajnuar për të përkthyer në gjuhë të huaj, për tifozët miq të huaj, duhet të jenë të disponueshëm kur kërkohet. Nëse është e mundur, flet një spiker, zëri i të cilit është i njohur për tifozët, që vizitojnë mjedisin sportiv në vendin e tyre.

3. Njoftimet që jepen nëpërmjet sistemit të adresimit të publikut kanë karakter neutral dhe nuk përdoren, për:

- a) përhapjen e mesazheve politike;
- b) mbështetjen e ekipit vendës;

c) diskriminimin ndaj ekipit mik.

Neni 29

Sendet e palejuara në mjediset sportive

1. Ndalohen mbajtja dhe përdorimi në objektet e mjediset sportive dhe gjatë zhvillimit të veprimtarive sportive i fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike dhe sendeve të tjera, të rrezikshme për jetën e shëndetin e pjesëmarrësve, i armëve të të gjitha llojeve, si edhe përdorimi e tregtimi i pijeve alkoolike.

2. Pijet joalkoolike, të cilat shiten apo shpërndahen, të shërbehen në enë letre ose plastike të hapura, që nuk mund të përdoren në mënyrë të rrezikshme.

Neni 30

Veprimet politike

Promovimi a njoftimi, me çdo lloj mjeti, i mesazheve politike ose i ndonjë veprimi tjetër politik, brenda dhe në afërsi të mjedisit sportiv, është i ndaluar para, gjatë dhe pas veprimtarisë sportive.

Neni 31

Veprimet provokuese dhe racizmi

1. Organizatori i veprimtarisë sportive, së bashku me punonjësin e Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive dhe oficerin e mbrojtjes e të sigurisë, parandalon çdo veprim provokues, që ndërmerret nga tifozët brenda ose në afërsi të mjedisit sportiv, sa i përket provokimit verbal nga tifozët ndaj lojtarëve a tifozëve kundërshtarë, në nivele të papranueshme, sjellje raciste dhe përdorimit të mjeteve ofendues.

2. Organizatori i veprimtarisë sportive, punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, dhe oficeri i mbrojtjes e sigurisë ndërhyjnë nëpërmjet sistemit të adresimit të publikut ose drejtpërdrejt, në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 32

Mbajtja e tifozëve në stadium

Punonjësi i Policisë së Shtetit, përgjegjës për veprimtarinë sportive, ose oficeri i mbrojtjes e sigurisë vendos që, për arsye sigurie, një grup tifozësh duhet të mbahet brenda mjedisit sportiv, ndërsa tifozët e tjerë të shpërndahen. Sa herë që është e mundur, ky vendim i komunikohet federatës ose klubit mik paraprakisht, në mënyrë që informacioni të mund të përcillet te tifozët e tyre. Në çdo rast:

a) vendimi për të mbajtur një grup tifozësh duhet të shpallet nëpërmjet sistemit të adresimit të publikut në gjuhën e grupit të tifozëve, të cilit i drejtohet;

b) njoftimi duhet të përsëritet pak para përfundimit të ndeshjes;

c) ata duhet të informohen rregullisht për kohën që mund t'u duhet të presin para se të lejohen të largohen nga mjedisi sportiv.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33
Monitorimi i masave

Ministria përgjegjëse për sportin monitoron realizimin e masave për parandalimin e dhunës në veprimtaritë sportive nga organizatat sportive, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

Neni 34
Organet zbatuese

Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 35
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 330, datë 18.5.2022

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime korrente”, në artikullin 604 “Të tjera transferata korrente të brendshme”, të programit buxhetor “Zhvillimi i sportit”, i shtohet fondi prej 160 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, për financimin e veprimtarisë së federatave sportive dhe shpërblimin e sportistëve elitare.

2. Efekti financiar, prej 160 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 648, datë 5.10.2022

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË ARSIMIT
DHE SPORTIT, PËR UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS, TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, NË ZONËN KADASTRALE 8210, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 117, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për Universitetin e Sporteve të Tiranës, të pasurive të paluajtshme, në zonën kadastrale 8210, Bashkia Tiranë, të përcaktuara në formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pasuritë e paluajtshme, pas kalimit në përgjegjësi administrimi, përdoren në funksion të qëllimit dhe të veprimtarisë së Universitetit të Sporteve të Tiranës.

3. Universitetit të Sporteve të Tiranës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur këtij vendimi, t’i tjetërsojë apo t’ua japë ato në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 832, datë 19.12.2022

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR FINANCIMIN E VLERËS SË TATIMIT
MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH) TË BILETAVE PËR NDESHJEN FINALE TË *UEFA*
CONFERENCE LEAGUE, TË ZHVILLUAR NË ARENËN KOMBËTARE TË
FUTBOLLIT TIRANË, NË DATËN 25 MAJ 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime korrente”, në artikullin 604 “Të tjera transferta korrente të brendshme”, të programit buxhetor “Zhvillimi i sportit”, i shtohet fondi prej 19 710 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dhjetë mijë) lekësh, për financimin e vlerës së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) të biletave për ndeshjen finale të *UEFA Conference League*, të zhvilluar në Arenën Kombëtare të Futbollit Tiranë, në datën 25 maj 2022.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit i transferon Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) në llogarinë e saj në një bankë të nivelit të dytë, fondin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, pas përcjelljes nga ana e FSHF-së së dokumentacionit justifikues, në masën e shumës që transferohet.

3. FSHF-ja në zbatim të kushteve të kontratës së nënshkruar, në datën 21 mars 2021, ndërmjet saj dhe UEFA-s, për financimin e vlerës së tatimit mbi vlerën e shtuar të biletave për ndeshjen finale të *UEFA Conference League*, transferon nga llogaria e saj në një bankë të nivelit të dytë, në llogarinë e UEFA-s, fondin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, pas konfirmimit të dokumentacionit justifikues, në masën e shumës që transferohet.

4. Efekti financiar, prej 19 710 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dhjetë mijë) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2022.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Federata Shqiptare e Futbollit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 833, datë 19.12.2022

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR SHPËRBLIMIN E SPORTISTËVE ELITARË E TË TRAJNERËVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime korrente”, në artikullin 604, “Të tjera transferta korrente të brendshme”, të programit buxhetor “Zhvillimi i sportit”, i shtohet fondi prej 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekësh, për shpërblimin e sportistëve elitare e të trajnerëve të tyre.

2. Efekti financiar, prej 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 893, datë 27.12.2022

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA”, NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të neneve 13 dhe 15, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, në masën 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë, të projektit “Ekipet sportive në shkolla”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH).

2. Fondi i përcaktuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e KOKSH-it, në bankën e nivelit të dytë, “Raiffeisen Bank” sh.a., me numër llogarie 0050249325, dhe përballohet nga buxheti i miratuar, për vitin 2022, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, përkatësisht, në llogarinë ekonomike 604 “Transferta të brendshme”, në programin buxhetor 08140 “Zhvillimi i sportit”.

3. KOKSH-i, brenda muajit janar 2023, të paraqesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit projektin e detajuar dhe të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e tij, duke identifikuar të gjitha aktivitetet/produktet dhe infrastrukturën e parashikuar në projekt, kohëzgjatjen e zbatimit të projektit, federatat dhe organizmat e tjerë përfitues nga projekti. Projekti duhet të jetë i kostuar me të gjithë produktet/zërat analitike të shpenzimeve, në përputhje me klasifikimin ekonomik buxhetor të tyre.

4. KOKSH-i raporton periodikisht mbi bazë katërmujore në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për ecurinë e aktiviteteve/produkteve dhe realizimin financiar të projektit. Brenda muajit janar 2023 të depozitohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit raporti vjetor i veprimtarisë së projektit “Ekipet sportive 2022”, përfshirë raportimin financiar.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit cakton një grup pune për mbikëqyrjen e realizimit të mbështetjes financiare të KOKSH-it. Përbërja dhe detyrat e grupit të punës përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 894, datë 27.12.2022

PËR FINANCIMIN E FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT, PËR MBËSHTETJEN E EKIPIT KOMBËTAR TË FUTBOLLIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, në masën 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë, për financimin e Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), për mbështetjen e ekipit kombëtar të futbollit.

2. Fondi i përcaktuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e FSHF-së, në bankën e nivelit të dytë/ “*Union Bank*” sh.a., me numër llogarie 111141628020115, dhe përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2022, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, përkatësisht, në llogarinë ekonomike 604 “Transferta të brendshme”, në programin buxhetor 08140 “Zhvillimi i sportit”.

3. FSHF-ja, brenda muajit janar 2023, të paraqesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit planin e detajuar dhe të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e FSHF-së të veprimtarisë për të cilën do të përdoret ky fond.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit cakton një grup pune për mbikëqyrjen e realizimit të mbështetjes financiare të ekipit kombëtar të futbollit. Përbërja dhe detyrat e grupit të punës përcaktohen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Federata

Shqiptare e Futbollit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

UDHËZIME

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 4, datë 25.2.2020

PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FONDIT “GRAND/TRANSFERTË KORRENTE E BRENDSHME” PËR FEDERATAT SHQIPTARE SPORTIVE DHE KOMITETIN OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR DHE SISTEMIN E PIKËZIMIT TË KRITEREVE PRIORITARE TË VLERËSIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”; të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë” dhe të vendimit nr. 503, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”,

UDHËZIJMË:

1. Për qëllim të zbatimit të këtij udhëzimi, fonde “Grand/transfertë korrente e brendshme”, janë fondet publike që alokohen nga buxheti i shtetit për federatat shqiptare sportive dhe për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar.

2. Buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin, i detajuar në gr. 11, titulli 08140, artikulli 6040000, “Transferta korrente të brendshme”, detajohet nga ministria përgjegjëse për sportin në llogarinë e përfituesve/federatave shqiptare sportive dhe Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, në respekt të pavarësisë së tyre financiare, sipas kriterëve prioritarë dhe mënyrës së përdorimit të fondeve, të parashikuar në këtë udhëzim.

3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të trajtojë ndarjen e fondeve “Grand” për federatat shqiptare të sportit, mbështetur në renditjen përfundimtare të tyre, sipas pikëve të përfituara në kriteret e përcaktuara në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, si dhe Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar.

4. Zërat e shpenzimeve që lejohen të përballohen nga fondi “Grand/transfertë korrente e brendshme” për federatat shqiptare sportive janë:

a) financimi i kontratave të punësimit, për federatat me aktivitet me shtrirje vjetore, për jo më shumë se dy punonjës, në nivelin e pagës së një institucioni qendror/ministri, në kategorinë III-b dhe IV-a, dhe për federatat me aktivitet me grumbullim, për jo më shumë se një punonjës, në nivelin e pagës së një institucioni qendror/ministri, në kategorinë IV-a, në rast se federata e vlerëson të

nevojshëm punësimin e tyre me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;

b) shpenzimet operative të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare;

c) trajtimi ushqimor, në natyrë ose në vlerë, të sportistëve të nivelit të lartë, si dhe pagesat e kontratave të shërbimit për trajnerët e ekipeve kombëtare, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

d) trajtimi mjekësor dhe shpenzimet e riaftësimit të sportistëve;

e) grumbullimi stërvitor i ekipeve kombëtare;

f) sigurimi shëndetësor për sportistët e ekipeve kombëtare;

g) shpenzimet për pritje/përcjellje delegacionesh, konferenca, çmime etj., në nivelin e lejuar nga legjislacioni në fuqi;

h) shpërblimi për arritjen e rezultateve të larta sportive;

i) blerja e bazës materiale/uniforma sportive etj.;

j) shpenzimet për kërkimin dhe kualifikimin shkencor në sport;

k) shpenzime për analiza të kontrollit *doping* dhe edukimin *antidoping*, në formën e tarifës vjetore, në bazë të marrëveshjes dypalëshe me Organizatën Kombëtare *Antidoping*.

5. Zërat e shpenzimeve që lejohen të përballohen nga fondi “Grand/transfertë korrente e brendshme” për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar janë si më poshtë:

a) financimi i kontratave të punësimit, për jo më shumë se dy punonjës, në nivelin e pagës së një institucioni qendror/ministri, në kategorinë III-b dhe IV-a, në rast se Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar e vlerëson të nevojshëm punësimin e tyre me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;

b) financimi/bashkëfinancimi i shpenzimeve operative, në varësi edhe me të ardhurat nga burime të tjera në dispozicion, për mbështetjen e sportistëve elitare, ekipeve kombëtare për sportet verore dhe dimërore.

6. Përfituesit e fondeve “Grand/transfertë korrente e brendshme” do të paraqesin në ministrinë përgjegjëse për sportin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) brenda datës 15 gusht të vitit korrent, projektprogramin afatmesëm, në përputhje me formatin e aplikimit të miratuar nga ministria përgjegjëse për financat, për buxhetin afatmesëm;

b) nga data 1 dhjetor deri në datën 15 dhjetor të vitit korrent, dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi;

c) brenda 15 ditësh nga njoftimi zyrtar i përfitimit të grandit, planin e detajuar të përdorimit të fondeve në dispozicion të përfituesit për vitin korrent (për fondet publike dhe të ardhurat e tjera nga burime të ligjshme);

d) planin e detajuar të përdorimit të fondeve, i cili duhet të përmbajë detyrimisht objektivat konkretë që do të arrihen/synohen të arrihen, si dhe programet e zhvillimit të disiplinës sportive apo funksionit të organizatës.

e) kopjen e vendimit të komitetit drejtues të përfituesve, për ndarjen dhe përdorimin e fondeve publike. Një kopje të dërgohet, gjithashtu, edhe në ministrinë përgjegjëse për financat për t’u regjistruar në sistemin elektronik të thesarit.

7. Federata plotëson formularin, shoqëruar me dokumentacionin mbështetës, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, dhe e dërgon në rrugë postare në ministrinë përgjegjëse për sportin nga data 1 dhjetor deri në datën 15 dhjetor.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë shqyrton dhe vlerëson aplikimet e federatave, duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara me këtë udhëzim dhe bën renditjen përfundimtare të federatave, sipas pikëve të përfituara.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda datës

30 dhjetor, i paraqet për miratim ministrin renditjen përfundimtare të federatave, sipas sistemit të pikëzimit të përcaktuar në këtë udhëzim, shoqëruar me vlerat financiare buxhetore për secilën federatë përfituese, referuar fondeve të miratuara në ligjin e buxhetit.

10. Drejtoria përgjegjëse për financat, në ministrinë përgjegjëse për sportin, bën kreditimin e fondeve buxhetore, sipas organizatave, referuar ndarjes së tyre nga grupi i posaçëm i punës dhe të miratuara nga ministri përgjegjës për sportin.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ndjek përdorimin e fondeve publike nga përfituesit e grantit/transfertës gjatë vitit ushtrimor.

12. Federatat shqiptare sportive duhet të bëjnë transparente për anëtarët e tyre ndarjen e të gjitha fondeve të përfituara në vitin korrent, si dhe të publikojnë këtë informacion në *ëb-site*-t e çdo organizate. Drejtoria përgjegjëse për programet e zhvillimit të sportit monitoron zbatimin e këtij detyrimi.

13. Ministri përgjegjës për sportin ka të drejtë të urdhërojë pezullimin e dhënies së grantit apo ndryshimin e destinacionit të tij, nëse konstatohet se nuk zbatohen kërkesat e këtij udhëzimi ose për arsye/shkaqe të tjera të motivuara.

14. Pasqyrat financiare të përfituesve të fondeve “Grand/transfertë korrente e brendshme”, depozitohen në ministrinë përgjegjëse për sportin, brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, referuar ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Pasqyrat financiare duhet të jenë hartuar dhe certifikuar konform ligjit dhe të përfshijnë dhe raportojnë të gjitha të ardhurat nga burimet e ligjshme, si dhe të gjitha përdorimet/shpenzimet e kryera gjatë vitit ushtrimor.

15. Në zbatim të këtij udhëzimi, çdo përfitues i fondit “Grand/transfertë korrente e brendshme”, të hartojë rregulloren e brendshme të përdorimit të tij.

16. Federatat shqiptare të sportit mund të aplikojnë me projekte apo të kërkojnë financime për investime/shpenzime kapitale nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për programin “Zhvillimi i sportit”, për objekte në pronësi publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

17. Udhëzimi nr. 4, datë 11.3.2014, “Për mënyrën e përdorimit të fondit “Grand/transfertë korrente e brendshme” për federatat sportive dhe Komitetin Olimpik Shqiptar”, shfuqizohet.

18. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT

MINISTËR I FINANCAVE

DHE RINISË

DHE EKONOMISË

Besa Shahini

Anila Denaj

SHTOJCA NR. 1
KRITERET PËR TRAJTIMIN DHE NDARJEN E FONDEVE “GRAND” PËR FEDERATAT SHQIPTARE TË SPORTIT

1. Masiviteti

- a) Federata vlerësohet deri më 34 pikë, duke marrë për bazë masivitetin në sportin përkatës.
- b) Federata vlerësohet deri më 12 pikë, në varësi nga numri i organizatave sportive, anëtare të saj dhe që janë aktive, sipas tabelës 1, të shtojcës nr. 2.
- c) Federata vlerësohet deri më 22 pikë, në varësi nga numri i sportistëve të regjistruar në organizatat sportive, anëtare të federatës dhe që janë aktive, sipas tabelës 2, të shtojcës nr. 2.

2. Statusi i sportit

Kriteri për përcaktimin e kategorizimit të federatës, sipas statusit të sportit përkatës vlerësohet deri më 24 pikë, nëse federata shqiptare është anëtare e federatës ndërkombëtare, e njohur nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, sipas tabelës 3, të shtojcës nr. 2.

3. Gjithëpërfshirja

- a) Vlerësimi i federatave sipas kriterit gjithëpërfshirës vlerësohet deri më 6 pikë.
- b) Përqindja e femrave sportiste në raport me numrin e përgjithshëm të sportistëve vlerësohet deri më 3 pikë, sipas tabelës 4, të shtojcës nr. 2.
- c) Përqindja e përfshirjes së femrës në vendimmarrje vlerësohet deri më 2 pikë, sipas tabelës 5, të shtojcës nr. 2.

d) Përqindja e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në sport në raport me numrin e përgjithshëm të sportistëve vlerësohet deri më 1 pikë, sipas tabelës 6, të shtojcës nr. 2.

4. Popullariteti i sportit

Vlerësimi i federatës, sipas numrit të federatave kombëtare të anëtarësuara në federatat ndërkombëtare, vlerësohet deri më 4 pikë, sipas tabelës 7, të shtojcës nr. 2.

5. Organizimi i aktiviteteve kombëtare

a) Organizimi i kampionateve kombëtare, brenda vitit kalendarik vlerësohet deri më 6 pikë, sipas tabelës 8, të shtojcës nr. 2.

b) Organizimi i Kupës së Shqipërisë, brenda vitit kalendarik vlerësohet deri më 6 pikë, sipas tabelës 8, të shtojcës nr. 2.

c) Pikët janë të vlefshme vetëm nëse dëshmohet nga federata se në secilin kampionat kombëtar/Kupë e Shqipërisë kanë marrë pjesë jo më pak se 5 organizata, anëtare të federatës, dhe 30 sportistë.

6. Organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare nga federatat shqiptare në Shqipëri

a) Federatat shqiptare, anëtare të federatave ndërkombëtare të njohura nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar do të vlerësohen deri më 10 pikë, nëse gjatë vitit kalendarik kanë organizuar kampionat evropian apo botëror për kategorinë “të rritur/senior”, sipas tabelës 9, të shtojcës nr. 2.

b) Federatat shqiptare, anëtare të federatës ndërkombëtare të njohura nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, do të vlerësohen deri më 5 pikë, nëse gjatë vitit kalendarik kanë organizuar kampionat evropian apo botëror për grup-moshat kadet, junior dhe senior të rinj, sipas tabelës 9, të shtojcës nr. 2.

c) Federatat shqiptare që organizojnë ndonjë aktivitet ndërkombëtar (rajonal, Kampionat Ballkanik apo ndonjë aktivitet ndërkombëtar që është në kalendarin zyrtar të federatës përkatëse evropiane ose botërore) për të gjitha grup-moshat vlerësohen me 1 pikë, sipas tabelës 9, të shtojcës nr. 2.

d) Për të gjitha kriteret e lartpërmendura, vlerësimi vlen vetëm për një nga aktivitetet e organizuara gjatë vitit kalendarik.

e) Kriter minimal për vlerësimin e organizimit të një aktiviteti ndërkombëtar ose Kampionati Ballkanik, Evropian apo Botëror, sipas këtij udhëzimi, është pjesëmarrja e jo më pak se katër shteteve në atë aktivitet.

7. Pjesëmarrja dhe rezultatet e arritura në aktivitetet ndërkombëtare

7.1 Pjesëmarrja dhe rezultatet e arritura në aktivitetet ndërkombëtare për sportet individuale

a) Federatat shqiptare do të vlerësohen deri më 26 pikë për cilësinë e treguar dhe rezultatet e arritura në aktivitetet ndërkombëtare, si vijojnë:

b) Federata vlerësohet deri më 26 pikë, nëse ndonjë sportist ka fituar medalje, në:

i. Lojërat Olimpikë;

ii. Kampionatet Botërore;

iii. Lojërat Evropiane (në lojërat evropiane vetëm atëherë kur janë të barasvlershme me kampionatet evropiane me vendim të federatës përkatëse ndërkombëtare);

iv. Kampionatet Evropiane;

v. Lojërat Mesdhetare;

vi. Kampionatin Mesdhetar;

vii. Kampionatin Ballkanik.

c) Në varësi të rezultateve të arritura nga sportistët në aktivitetet ndërkombëtare, federata vlerësohet sipas tabelës 10, të shtojcës nr. 2.

d) Një federate shqiptare i takojnë 10 pikë, nëse ndonjë nga sportistët e saj merr pjesë në Lojëra Olimpikë me normë olimpikë, ndërsa një federate kombëtare i takojnë 3 pikë, nëse ndonjë nga sportistët e saj merr pjesë në Lojëra Olimpikë me ftesë të komisionit trepalësh të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

e) Vlefshmëria e rezultatit të arritur vlen si më poshtë:

i. Lojërat Olimpikë - rezultati vlen për 4 vjet;

ii. Kampionati Botëror - rezultati vlen për 3 vjet;

iii. Lojërat Evropiane (në Lojërat Evropiane vetëm atëherë kur janë të barasvlershme me Kampionatin Evropian me vendim të federatës përkatëse ndërkombëtare) - rezultati vlen për 4 vjet;

iv. Kampionati Evropian - rezultati vlen për 2 vjet;

v. Lojërat Mesdhetare - rezultati vlen për 4 vjet;

vi. Kampionati Mesdhetar – rezultati vlen për 1 ose 2 vjet, në varësi të kohës së mbajtjes së këtyre aktiviteteve nga federatat përkatëse;

vii. Kampionati Ballkanik - rezultati vlen vetëm për 1 vit.

f) Kriteri minimal i numrit të pjesëmarrjes së shteteve dhe të sportistëve në aktivitetet ndërkombëtare është si më poshtë:

i. Kampionati Botëror - 60 shtete, 24 garues në kategori. Përfshirë nga ky parashikim bëjnë vetëm sportet, sportistët e të cilave i nënshtrohen procesit kualifikues;

ii. Kampionati Evropian dhe Lojërat Evropiane - 24 shtete, 16 garues në kategori. Përfshirë nga ky parashikim bëjnë vetëm sportet, sportistët e të cilave i nënshtrohen procesit kualifikues;

iii. Lojërat Mesdhetare dhe Kampionati Mesdhetar - 12 shtete, 8 garues në kategori;

iv. Kampionati Ballkanik - 8 shtete, 6 garues në kategori;

g) Të gjitha federatave u llogaritet vetëm rezultati më i mirë i arritur nga sportistët, në kategorinë “të rritur/senior”.

7.2 Rezultatet e arritura në aktivitetet ndërkombëtare për sportet ekipore

a) Federatat shqiptare vlerësohen deri më 16 pikë për cilësinë e treguar dhe rezultatet e arritura në aktivitetet ndërkombëtare gjatë vitit kalendarik paraprak.

b) Federata vlerësohet me 16 pikë nëse ekipi kombëtar (kombëtarja) ka fituar medalje në:

i. Lojërat Olimpike;

ii. Kampionatet Botërore;

iii. Lojërat Evropiane (në Lojërat Evropiane vetëm atëherë kur janë të barasvlershme me Kampionatet Evropiane me vendim të federatës përkatëse ndërkombëtare);

iv. Kampionatet Evropiane;

v. Lojërat Mesdhetare.

c) Federata vlerësohet, nëse ekipi kombëtar (kombëtarja) ka arritur rezultate, sipas tabelës 11, të shtojcës nr. 2.

d) Një federate kombëtare i takojnë 5 pikë, nëse ekipi kombëtar (kombëtarja) merr pjesë në Lojëra Olimpike me normë olimpike.

e) Nëse ekipi kombëtar (kombëtarja) ka fituar medalje të artë, të argjendtë apo të bronzte në Lojërat Mesdhetare, federata përkatëse vlerësohet përkatësisht me 6, 5 dhe 4 pikë.

f) Vlefshmëria e rezultatit të arritur vlen si më poshtë:

i. Lojërat Olimpike, Kampionatet Botërore, Lojërat Evropiane (në Lojërat Evropiane vetëm atëherë kur janë të barasvlershme me Kampionatet Evropiane me vendim të federatës përkatëse ndërkombëtare), Kampionate Evropiane, Lojëra Mesdhetare - rezultati për të gjitha këto gara vlen për 4 vjet;

ii. Kalimi i ndonjë grupi të kualifikimit, apo kualifikimi në Kampionat Evropian, Botëror apo Lojëra Olimpike - rezultati vlen vetëm për 1 vit;

g) Për të gjitha sportet vlen vetëm rezultati më i mirë i arritur nga ekipi kombëtar (kombëtarja), në kategorinë e të rriturve.

8. Pjesëmarrja në aktivitete të tjera sportive kombëtare dhe ndërkombëtare

a) Pjesëmarrja e federatave shqiptare në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare (kampionat, liga, kupa, turne, kampionat ballkanik, evropian, botëror, kupa botërore, premier ligë, grand sllem, grand prix, liga të kampionëve, liga të Evropës, kampionate mesdhetare, festival për të rinj, Lojëra Mesdhetare, Lojëra Evropiane, Lojëra Olimpike etj.) vlerësohet deri më 3 pikë, sipas tabelës 12, të shtojcës nr. 2.

b) Pjesëmarrja në të gjitha aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të faktohet me dëshmitë përkatëse.

9. Kohështrirja e aktiviteteve

Federatat që organizojnë aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare në Shqipëri apo që marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare, në varësi të kohështrirjes së aktivitetit gjatë vitit kalendarik vlerësohen deri më 6 pikë, sipas tabelës 13, të shtojcës nr. 2.

10. Ngritja e kapaciteteve

a) Federatat shqiptare që gjatë vitit punojnë në ngritjen e kapaciteteve të tyre, si dhe kanë hartuar plan strategjik për funksionimin e federatës vlerësohen deri më 4 pikë, si më poshtë:

i. Federata shqiptare që ka miratuar planin strategjik për menaxhimin e federatës vlerësohet me 2 pikë;

ii. Federata shqiptare që ka licencuar trajnerë brenda vitit, vlerësohet me 1 pikë;

iii. Federata shqiptare që ka organizuar trajnim apo seminar për gjyqtarë brenda vitit, vlerësohet me 0.5 pikë;

iv. Federata shqiptare që ka organizuar kurs apo trajnim, për administratorët e sportit, apo *antidoping*-ut brenda vitit, vlerësohet me 0.5 pikë.

b) Pikët janë të vlefshme vetëm atëherë kur faktohen me dëshmi përkatëse.

11. Vlerësimi i federatave sportive me specifika të tjera

11.1 Federata Shqiptare e Sportit Shkollor (FSHSSH)

a) Të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, që marrin pjesë në garat e organizuara nga FSHSSH-ja, do të pranohen si të barasvlershme me organizatat sportive, anëtare të federatave të tjera.

b) Të gjithë fëmijët, nxënës të sistemit arsimor parauniversitar, që marrin pjesë përmes shkollave të tyre në garat e organizuara nga FSHSSH-ja, do të konsiderohen si sportistë aktivë dhe do të vlerësohen me 50% të pikëve, sipas tabelës 2, të shtojcës nr. 2.

c) Pikët janë të vlefshme vetëm atëherë kur faktohen me dëshmi përkatëse.

11.2 Federata Shqiptare e Sportit Universitar (FSHSU)

a) Të gjitha institucionet e arsimit të lartë, publike dhe private, që janë të regjistruara në FSHSU si anëtare dhe që marrin pjesë në garat e organizuara nga FSHSU-ja, do të pranohen si të barasvlershme me organizatat sportive, anëtare të federatave të tjera.

b) Të gjithë studentët e institucioneve të arsimit të lartë, publike dhe private, që marrin pjesë në garat e organizuara nga FSHSU-ja, do të konsiderohen si sportistë aktivë të kësaj federate.

c) Pikët janë të vlefshme vetëm atëherë kur faktohen me dëshmi përkatëse.

12. Të ardhura të tjera të federatës

Të ardhura nga donacionet, regjistrimi i organizatave sportive dhe sportistëve apo çdo burim tjetër i ligjshëm, si dhe kontribute të përfituara nga organizata/federata ndërkombëtare, gjatë vitit kalendarik, vlerësohet deri më 3 pikë, sipas tabelës 14, të shtojcës nr. 2.

13. Të ardhura nga të drejtat televizive

Të ardhura nga të drejtat televizive vlerësohet deri më 2 pikë, sipas tabelës 15 të shtojcës nr. 2.

SHTOJCA NR. 2

SISTEMI I PIKËZIMIT TË VLERËSIMIT TË KRITEREVE PRIORITARE

Tabela 1

Numri i organizatave sportive, anëtare të federatës	Vlerësimi me pikë
Mbi 60	12
50–59	8–11,99
40–49	6–7,99
30–39	3–5,99
20–29	2–2,99
5–19	1–1,99

Tabela 2

Numri i sportistëve të regjistruar në organizatat sportive, anëtare të federatës	Vlerësimi me pikë
Mbi 2000	22
1500–1999	20–21,99
1000–1499	16–19,99
600–999	12–15,99
500–599	8–11,99

400–499	6–7,99
300–499	4–5,99
200–299	3–3,99
100–199	2–2,99
50–99	1–1,99

Tabela 3

Statusi i sportit		Vlerësimi me pikë
I njohur nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar	Sport olimpik	24
	Sport joolimpik	12

Tabela 4

Raporti i numrit të përgjithshëm të femrave sportiste me numrin e meshkujve sportistë	Vlerësimi me pikë
Mbi 30%	3
20–29,9%	2
10–19,9%	1
0–9,9%	0–0,99

Tabela 5

Raporti i numrit të përgjithshëm të femrave në vendimmarrje, ku përfshihen anëtarët e bordit dhe sekretari i përgjithshëm, me numrin e meshkujve	Vlerësimi me pikë
Mbi 30%	2
20–29,9%	1
10–19,9%	0,5
0–9,9%	0–0,49

Tabela 6

Raporti i numrit të personave sportistë me aftësi të veçanta me numrin e sportistëve	Vlerësimi me pikë
Mbi 10%	1
5–9,9%	0,5
0–4,9%	0–0,49

Tabela 7

(Popullariteti i sportit) Numri i federatave kombëtare të anëtarësuar në federatat ndërkombëtare	Vlerësimi me pikë
Mbi 200	4
151–200	3
76–150	2
1–75	1

Tabela 8

Organizimi i aktiviteteve kombëtare		Vlerësimi me pikë
Kampionati Kombëtar	U14, U16, U18, U21 dhe të rritur	6
	U16, U18, U21 dhe të rritur	5
Kupa e Shqipërisë	U18, U21 dhe të rritur	4
	U21 dhe të rritur	3
	Të rritur	2

Tabela 9

Federata Shqiptare, anëtare e federatave ndërkombëtare, të njohura nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, kanë organizuar gjatë vitit kalendarik			Vlerësimi me pikë
Kampionat Evropian	të rritur/senior	Sport olimpik	10
		Sport joolimpik	8
Kampionat Botëror	Kadet Junior Senior të rinj	Sport olimpik	5
		Sport joolimpik	3
Ndonjë aktivitet ndërkombëtar (Rajonal, Kampionat Ballkanik apo ndonjë aktivitet ndërkombëtar që është në kalendarin zyrtar të Federatës përkatëse Evropiane ose Botërore)	Të gjitha grupmoshat		1

Tabela 10

Rezultati në aktivitetet ndërkombëtare, sportet individuale		Vlerësimi me pikë
Lojëra Olimpike Kampionat Botëror	Vendi i parë	26
	Vendi i dytë	24
	Vendi i tretë	22
	Vendi i katërt	20
	Vendi i pestë	19
	Vendi i gjashtë	18
	Vendi i shtatë	17
	Vendi i tetë	16
Lojëra Evropiane (në Lojërat Evropiane vetëm atëherë kur janë të barasvlershme me Kampionatet Evropiane, me vendim të federatës përkatëse ndërkombëtare)	Vendi i parë	23
	Vendi i dytë	21
	Vendi i tretë	19
	Vendi i katërt	18
	Vendi i pestë	17
Kampionat Evropian	Vendi i gjashtë	16
Lojëra Mesdhetare	Medalje e artë	13
	Medalje e argjendtë	11

	Medalje e bronzë	9
Kampionat Mesdhetar	Medalje e artë	9
	Medalje e argjendtë	7
	Medalje e bronzë	5
Kampionat Ballkanik	Medalje e artë	5
	Medalje e argjendtë	3
	Medalje e bronzë	1

Tabela 11

Rezultati në aktivitetet ndërkombëtare, sportet ekipore		Vlerësimi me pikë
Lojërat Olimpike;	Vendi i katërt	10
	Vendi i pestë	9
Kampionatet Botërore;	Vendi i gjashtë	8
	Vendi i shtatë	7
	Vendi i tetë	6
Lojërat Evropiane (në Lojërat Evropiane vetëm atëherë kur janë të barasvlershme me Kampionatet Evropiane, me vendim të federatës përkatëse ndërkombëtare)	Vendi i katërt	8
	Vendi i pestë	7
	Vendi i gjashtë	6
Kampionatet Evropiane	Medalje e artë	6
	Medalje e argjendtë	5
	Medalje e bronzë	4
Lojërat Mesdhetare		
Ekipi kombëtar (kombëtarja) kalon grupin parakualifikues		3
Ekipi kombëtar (kombëtarja) kualifikohet në Kampionat Evropian apo Botëror		5

Tabela 12

Numri i aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare ku merr pjesë federata brenda vitit	Vlerësimi me pikë
>= 40	3
30–39	2
15–29	1

Tabela 13

Kohështrirja e aktivitetit		Vlerësimi me pikë
Kampionat Kombëtar Kupa e Shqipërisë	Sistem vajtje-ardhje	8
	Sistem grumbullimi	3
Aktivitet Ndërkombëtar në Shqipëri	Sistem vajtje-ardhje	3
	Sistem grumbullimi	1

Aktivitete Ndërkombëtare jashtë Shqipërisë	Sistem vajtje-ardhje	3
	Sistem grumbullimi	1

Tabela 14

Të ardhura të tjera të federatës	Vlerësimi me pikë
Mbi 5 milionë	3
3-5 milionë	2
1-3 milionë	1

Tabela 15

Të ardhura nga të drejtat televizive	Vlerësimi me pikë
Mbi 1 milion	2
0,5 - 1 milion	1
0 - 0,5 milion	0,5

SHTOJCA 3

LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE TË APLIKIMIT

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Çfarë duhet të përmbajë dokumenti	Referenca në udhëzim (kriteri)
1	Lista emërore e organizatave sportive aktive, anëtare të federatës	Emri i organizatës dhe lloji i saj, vendi i ushtrimit të aktivitetit dhe përfaqësuesi ligjor	1.b
2	Lista emërore e sportistëve të regjistruar në organizatat sportive, anëtare të federatës	Emri, mbiemri, datëlindja e sportistit, organizata sportive dhe statusi i tij (amator/ profesionist)	1.c
3	Njohja e federatës nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar	Kopje e dokumentit të njohjes zyrtare të federatës nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar	2
4	Lista emërore e anëtarëve të bordit drejtues dhe sekretarit të përgjithshëm	Emri, mbiemri, organizata sportive që përfaqëson	3.c
5	Numri i federatave kombëtare të anëtarësuar në federatën ndërkombëtare të sportit përkatës	Kopje e dokumentit të konfirmimit të numrit të federatave kombëtare të anëtarësuar në federatën ndërkombëtare të sportit përkatës	4

6	Lista e organizatave sportive, anëtare të federatës, pjesëmarrëse në kampionatin kombëtar	Lista e organizatave sportive anëtare pjesëmarrëse	5.c
	Lista e sportistëve pjesëmarrës në kampionatin kombëtar	Emri, mbiemri, organizata sportive ku merr pjesë	5.c
7	Lista e organizatave sportive, anëtare të federatës, pjesëmarrëse në Kupën e Shqipërisë	Emri i organizatave sportive pjesëmarrëse	5.c
	Lista e sportistëve pjesëmarrës në Kupën e Shqipërisë	Emri, mbiemri i sportistëve pjesëmarrës, sipas organizatave sportive	5.c
8	Lista e ekipeve/shteteve pjesëmarrëse në aktivitetet ndërkombëtare të organizuara nga federatat shqiptare në Shqipëri	Lista e ekipeve/shteteve pjesëmarrëse, e konfirmuar	6.e
9	Lista e ekipeve/shteteve pjesëmarrëse, në kategorinë “të rritur/senior”, në aktivitetet ndërkombëtare jashtë Shqipërisë	Lista e ekipeve/shteteve pjesëmarrëse, në kategorinë “të rritur/senior”, e konfirmuar	7.1.k 7.1.1 7.2.b
10	Diploma, certifikata të marra në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe renditja përfundimtare në sportin përkatës	Emri, mbiemri i sportistit/ekipit, aktiviteti ku ka marrë pjesë, rezultati i arritur dhe renditja përfundimtare në sportin përkatës	3.7.1.b 3.7.2.c 3.8.b
11	Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare	Kopje e konfirmimit zyrtar për pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare (me normë/me ftesë)	7.1.d 7.2.d
12	Plani strategjik për menaxhimin e federatës, miratuar nga Komiteti Drejtues	Kopje e planit strategjik për menaxhimin e federatës, miratuar nga Komiteti Drejtues i konfirmuar	10.a.i
13	Lista e trajnerëve të licencuar nga federata brenda vitit	Emri, mbiemri i trajnerëve të licencuar, sipas organizatave sportive	10.a.ii
14	Organizimi i trajnimit/seminarit për gjyqtarë gjatë vitit	Emri, mbiemri i gjyqtarëve pjesëmarrës në trajnim/seminar dhe i trajnuesit	10.a.iii
15	Organizimi i kursit/trajnimit për administratorët e sportit apo të <i>antidoping</i> -ut brenda vitit	Emri, mbiemri i administratorëve të sportit apo të <i>antidoping</i> -ut, pjesëmarrës në kurs/trajnim dhe i trajnuesit	10.a.iv
16	Të ardhurat nga donacionet, regjistrimi i organizatave sportive dhe sportistëve apo çdo burim tjetër i ligjshëm, si dhe kontribute të përfituara nga organizata/federata	Të dhëna mbi të ardhurat nga donacionet, regjistrimi i organizatave sportive dhe i sportistëve apo çdo burim tjetër i ligjshëm, si dhe kontribute të	12

	ndërkombëtare, gjatë vitit kalendarik	përfituara nga organizata/ federata ndërkombëtare, gjatë vitit kalendarik, të konfirmuara	
17	Të ardhurat nga të drejtat televizive, gjatë vitit kalendarik	Të dhëna mbi të ardhurat nga të drejtat televizive, gjatë vitit kalendarik, të konfirmuara	13

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 4, datë 25.2.2022

PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FONDIT “GRANT/TRANSFERTË KORRENTE E BRENDSHME” PËR FEDERATAT SPORTIVE OLIMPIKE, KOMITETIN OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR DHE ORGANIZATËN KOMBËTARE ANTIDOPING

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të vendimit nr. 523, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”; dhe të vendimit nr. 503, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”,

UDHËZOJMË:

1. Për qëllim të zbatimit të këtij udhëzimi, fonde “Grant/transfertë korrente e brendshme”, janë fondet publike që alokohen nga buxheti i shtetit për federatat sportive, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatën Kombëtare Antidoping.

2. Buxheti vjetor i miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin, i detajuar në gr. 11, titull 08140, artikull 604 “Transferta korrente e brendshme”, detajohet nga ministria përgjegjëse për sportin në llogarinë e përfituesve/federatave shqiptare sportive, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatës Kombëtare Antidoping, sipas kritereve dhe mënyrës së përdorimit të fondeve, të parashikuara në këtë udhëzim.

3. Shpërndarja e fondeve për çdo federatë sportive olimpike bazohet në vlerësimin e tyre, sipas një sistemi pikëzimi, në përputhje me kriteret e përcaktuara në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi dhe metodikës së përcaktuar në këtë udhëzim.

4. Fondit total të miratuar në buxhetin vjetor në programin e sportit, për financimin e federatave olimpike dhe joolimpike (për aktivitetet ndërkombëtare dhe aktivitetet kombëtare e ndërkombëtare të zhvilluara për të gjithë disiplinat sportive), do t’i zbritet shuma në masën deri në 30%, për t’u përdorur për financimin e organizatave në funksion të sportit, të parashikuara në ligjin nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar (Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizata Kombëtare Antidoping), si dhe për financimin e projektpropozimeve të paraqitura nga federatat sportive joolimpike.

5. Financimi i organizatave në funksion të sportit (KOKSH dhe Organizata Kombëtare Antidoping), si dhe i federatave sportive joolimpike, do të jetë në kufijtë e mëposhtëm, në varësi me buxhetin vjetor në dispozicion:

- a) Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar do të financohet në masën deri në 7% të fondit total;
- b) Organizata Kombëtare Antidoping, në masën deri në 3% të fondit total;
- c) Federatat joolimpike, për projektpropozimet e paraqitura, financimi total vjetor do të jetë deri në 20% e fondit total. Në rast se aplikimet e projektpropozimeve të federatave joolimpike nuk

ezaurojnë fondin vjetor në dispozicion të tyre, fondi i mbetur i papërdorur do të alokohet për të shtuar financimin e federatave sportive olimpike dhe organizatave në funksion të sportit (KOKSH dhe Organizata Kombëtare Antidoping).

6. “Shuma e financimit” për federatat sportive olimpike përlogaritet si prodhim i “shumës totale të fondit në dispozicion” me “koeficientin e financimit” të përlogaritur për çdo federatë olimpike, ku:

- “Shuma vjetore e fondit në dispozicion” është shuma e grandit/transfertës, që mbetet pas zbritjeve të parashikuara në pikën 5 të këtij udhëzimi, e cila do të shpërndahet për federatat sportive olimpike, në përputhje me koeficientin e saj të financimit.

- “Koeficienti i financimit” për çdo federatë sportive olimpike përlogaritet si raport i shumës së pikëve, që siguron çdo federatë olimpike ndaj shumës totale të pikëve të të gjitha federatave olimpike, që kanë aplikuar për financim gjatë vitit, sipas metodikës dhe kriterëve të përcaktuar në shtojcën 1.

7. Kriteret për përfitimin e fondeve dhe pikëzimin e federatave olimpike do të aplikohen, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

8. Federatat sportive olimpike, për të provuar përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në shtojcën 1 bashkëlidhur, duhet të paraqesin edhe dokumentacionin vërtetues/shoqërues, si më poshtë:

a) lista emërore e organizatave sportive aktive, anëtare të federatës, të shoqëruar me dokumentacion ligjor;

b) numri i sportistëve të licencuar të organizatës sportive, anëtare të federatës, sipas gjinisë dhe kategorive të moshave;

c) numri i sportistëve të nivelit të lartë, në aktivitetet ndërkombëtare të organizatës sportive, anëtarë të federatës, sipas rregulloreve të federatave ndërkombëtare;

d) numri i aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare;

e) rezultatet e arritura nga ekipi apo individët në arenën ndërkombëtare;

f) numri i medaljeve në aktivitete ndërkombëtare, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore;

g) numri i sportistëve me aftësi ndryshe;

h) raporti vjetor mbi zbatimin e objektivave të përcaktuar në asambljetë vjetore të federatës përkatëse, përfshirjen në sportin shkollor, përfshirjen e personave me aftësi ndryshe dhe zbatimin e rregullave antidoping, sipas përcaktimeve të bëra në dispozitat e Konventës Ndërkombëtare Kundër Dopingut në Sport, 2005, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, me ligjin nr. 9623, datë 16.10.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër Dopingut në Sport, 2005”, dhe Konventës Evropiane Antidoping të vitit 1989, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, me ligjin nr. 9242, datë 17.6.2004, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane Antidoping, 1989”;

i) hartimi i programeve strategjike 4-vjeçare për zhvillimin e disiplinave sportive.

9. Zërat e shpenzimeve që lejohet të përballohen nga fondi buxhetor “grant/transfertë korrente e brendshme”, për federatat sportive olimpike, janë:

a) shpenzimet operative të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare;

b) trajtimi ushqimor, në natyrë ose në vlerë, të sportistëve të nivelit të lartë, si dhe pagesat e kontratave të shërbimit për trajnerët e ekipeve kombëtare, sipas rëndësisë së aktivitetit ndërkombëtar, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

c) shpenzime për grumbullimin stërvitor të ekipeve kombëtare;

d) sigurimin shëndetësor për sportistët e ekipeve kombëtare;

e) trajtimin mjekësor dhe shpenzimet e riaftësisimit të sportistëve, sipas përcaktimeve në ligjin për sportin;

f) shpenzimet për pritje-përcjellje delegacionesh, konferenca, çmime etj., në nivelin e lejuar nga legjislacioni në fuqi;

g) shpërblimin për arritjen e rezultateve të larta sportive, sipas akteve ligjore dhe nënligjore;

h) blerjen e bazës materiale/uniforma sportive;

i) shpenzimet për seminare, trajnime, kualifikime dhe licencimin të trajnerëve, gjyqtarëve, mjekëve, fizioterapistëve, si dhe mbështetjen e kërkimit shkencor në sport;

j) shpenzimet për analiza të kontrollit doping;

k) shpenzimet e personelit për jo më shumë se dy punonjës, në shumën totale deri në 20% të financimit vjetor nga buxheti i shtetit, dhe në masën jo më pak se niveli i pagës minimale, sipas legjislacionit në fuqi në RSH.

10. Zërat e shpenzimeve që lejohet të përballohen nga fondi “grant/transfertë korrente e brendshme”, për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatën Kombëtare Antidoping, janë:

a) financimi i shpenzimeve të personelit, sipas strukturës organizative të miratuar nga Asambleja e KOKSH-it, në masën jo më pak se niveli i pagës minimale, sipas legjislacionit në fuqi në RSH dhe fondeve në dispozicion;

b) financimi i shpenzimeve të personelit për Organizatën Kombëtare Antidoping, për jo më shumë se dy punonjës, në nivelin e pagës jo më pak se paga minimale e miratuar, sipas legjislacionit në fuqi në RSH;

c) Financimin/bashkëfinancimin e shpenzimeve operative të KOKSH-it dhe të Organizatës Kombëtare Antidoping, sipas veprimtarive të tyre respektive, për mbështetjen e sportistëve elitare, ekipeve kombëtare olimpike për sportet verore, dimërore dhe zbatimin e rregullave antidoping, kryerjen e testeve dhe kontrollit doping, për sportistët që marrin pjesë në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe kryerjen e veprimtarive të edukimit antidoping dhe parandalimit të tij. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizata Kombëtare Antidoping nuk i nënshtrohen sistemit të pikëzimit, pasi nuk janë federata sportive.

11. Përfituesit e fondeve “grant/transfertë korrente e brendshme” do të paraqesin në ministrinë përgjegjëse për sportin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) projektprogramin afatmesëm, në përputhje me formatin e aplikimit të miratuar nga ministria përgjegjëse për financat, për buxhetin afatmesëm, brenda datës 15 gusht të vitit korrent;

b) kërkesën për mbështetje financiare, sipas përcaktimeve të pikës 3 dhe pikës 8 të këtij udhëzimi, brenda datës 15 nëntor të vitit korrent. Përgjithësisht për vitin 2022, kërkesa do të paraqitet brenda 10 ditëve, nga botimi i këtij udhëzimi në Fletoren Zyrtare;

c) planin e detajuar të përdorimit të fondeve në dispozicion të përfituesit për vitin korrent, brenda 15 ditëve nga njoftimi zyrtar i përfitimit të transfertës (për fondet publike dhe të ardhurat e tjera nga burime të ligjshme);

d) planin e detajuar të aktiviteteve sportive dhe objektivat konkretë që do të arrihen/synohen të arrihen, si dhe programet e zhvillimit të disiplinës sportive apo funksionit të organizatës;

e) kopjen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të përfituesve, për ndarjen dhe përdorimin e fondeve publike.

12. Struktura përgjegjëse për Sportin dhe ajo për Buxhetin në MAS shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët dhe kryen vlerësimin me pikë për çdonjërin nga federatat sportive olimpike, referuar kriteret të parashikuara në shtojcën 1 të këtij udhëzimi dhe i paraqet ministrit përgjegjës për sportin propozimin për ndarjen e fondeve publike, në përputhje me formulën e financimit të parashikuar në këtë udhëzim, për çdo organizatë sportive aplikuese.

13. Detajimi i fondeve buxhetore në sistemin informatik të thesarit (SIFQ), për çdo organizatë sportive kryhet nga struktura përgjegjëse për buxhetin në MAS, e cila njofton organizatat sportive për fondet e përfituara, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Struktura përgjegjëse për sportin dhe ajo për buxhetin, monitoron përdorimin e fondeve publike nga përfituesit e grantit/transfertës.

14. Federatat sportive olimpike, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizata Kombëtare Antidoping duhet të bëjnë transparente për anëtarët e tyre, ndarjen e fondeve të përfituara në vitin korrent, si dhe të publikojnë këtë informacion në faqen zyrtare të çdo organizate. Struktura përgjegjëse për sportin monitoron zbatimin e këtij detyrimi.

15. Pasqyrat financiare të përfituesve të fondeve “grant/transfertë korrente e brendshme” depozitohen në ministrinë përgjegjëse për sportin, brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, referuar legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Në pasqyrat financiare të paraqitura pranë MAS-it dhe organeve tatimore, duhet të përfshihen dhe të raportohen

të gjitha burimet e financimit dhe të gjitha të ardhurat e përfituara nga burimet e ligjshme, si dhe të gjithë përdorimet/shpenzimet e kryera gjatë vitit ushtrimor.

16. Në zbatim të këtij udhëzimi, çdo përfitues i fondit “grant/transfertë korrente e brendshme” harton rregulloren e brendshme të përdorimit të fondeve të tij.

17. Udhëzimi i përbashkët nr. 4, datë 25.2.2020, “Për mënyrën e përdorimit të fondit ‘grant/transfertë korrente e brendshme’, për federatat sportive dhe Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe sistemin e pikëzimit të kriterëve prioritarë të vlerësimit”, shfuqizohet.

18. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Organizata Kombëtare Antidoping dhe federatat sportive olimpike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis KUSHI

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

SHTOJCA I
KRITERET E VLERËSIMIT ME PIKË PËR FEDERATAT SPORTIVE OLIMPIKE

Tabela 1

Aktivitete ndërkombëtare të organizuara gjatë vitit kalendarik për federatat e sporteve kolektive dhe individuale			Vlerësimi me pikë
Kampionat Botëror	Të rritur/të rinj	Sport olimpik	10
	Kadet	Sport olimpik	5
Kampionat Evropian	Junior		
	Senior të rinj		
Kampionat Ballkanik	Të gjitha grupmoshat		1

Tabela 2

Rezultati në aktivitetet ndërkombëtare, sportet individuale	Vlerësimi me pikë	
Lojëra Olimpike	Medalje ari, argjendi, e bronzte	24
	Vendi i katërt	20
Kampionat Botëror	Vendi i pestë	19
	Vendi i gjashtë	18
	Vendi i shtatë	17
	Vendi i tetë	16
Pjesëmarrje në Lojëra Olimpike e sportistëve të federatave sportive kombëtare	Me normë	8
	Me ftesë	3
Kampionat Evropian Lojëra Evropiane (të barasvlershme me kampionatet evropiane, me vendim të federatës përkatëse ndërkombëtare)	Vendi i parë	23
	Vendi i dytë	21
	Vendi i tretë	19
	Vendi i katërt	18
	Vendi i pestë	17
	Vendi i gjashtë	16
Lojëra Mesdhetare	Medalje e artë	13

	Medalje e argjendte	11
	Medalje e bronzte	9
Kampionat Mesdhetar	Medalje e artë	9
	Medalje e argjendte	7
	Medalje e bronzte	5
Kampionat Ballkanik	Medalje e artë	5
	Medalje e argjendte	3
	Medalje e bronzte	1

Tabela 3

Rezultati në aktivitetet ndërkombëtare, sportet kolektive		Vlerësimi me pikë
Lojëra Olimpike	Medalje ari, argjendi, E bronzte	24
	Vendi i katërt	20
Kampionat Botëror	Vendi i pestë	19
	Vendi i gjashtë	18
	Vendi i shtatë	17
	Vendi i tetë	16
Pjesëmarrje e ekipit kombëtar të një federate në Lojëra Olimpike		8
Kualifikimi i ekipi kombëtar i sportit përkatës për në Kampionatin Botëror apo Evropian		4
Kampionat Evropian Lojëra Evropiane (e barasvlershme me kampionatet evropiane, me vendim të federatës përkatëse ndërkombëtare)	Vendi i parë	23
	Vendi i dytë	21
	Vendi i tretë	19
	Vendi i katërt	18
	Vendi i pestë	17
	Vendi i gjashtë	16
Lojëra Mesdhetare	Medalje e artë	13
	Medalje e argjendte	11
	Medalje e bronzte	9
Kampionat Mesdhetar	Medalje e artë	9
	Medalje e argjendte	7
	Medalje e bronzte	5
Kampionat Ballkanik	Medalje e artë	5
	Medalje e argjendte	3
	Medalje e bronzte	1

Tabela 4

Kriteri i masivitetit për federatat sportive individuale dhe kolektive në nivel kombëtar		Vlerësimi me pikë
Numri i organizatave sportive, anëtare të federatës		
	Mbi 60	9
	50–59	7–8,99
	40–49	4–6,99
	30–39	3–4,99
	20–29	2–2,99
	5–19	1–1,99

Tabela 5

Numri i sportistëve të regjistruar në organizatat sportive, anëtare të federatës për sportet individuale	Vlerësimi me pikë
Mbi 250	12
200–249	8–11,99
150–199	6–7,99
100–149	4–5,99
50–99	2–3,99
Deri në 50	1–1,99

Tabela 6

Numri i sportistëve të regjistruar në organizatat sportive, anëtare të federatës për sportet kolektive	Vlerësimi me pikë
Mbi 1,500	21
900–1,499	20–20,99
600–899	15–19,99
300–599	10–14,99
deri në 300	5–9,99

Tabela 7

Raporti i numrit të përgjithshëm të femrave në vendimmarrje, ku përfshihen anëtarët e bordit dhe sekretari i përgjithshëm, me numrin e meshkujve	Vlerësimi me pikë
Mbi 30%	2
20–29,9%	1
10–19,9%	0,5
0–9,9%	0–0,49

Tabela 8

Raporti i numrit të sportistëve me aftësi ndryshe me numrin e sportistëve	Vlerësimi me pikë
Mbi 10%	1
5–9,9%	0,5
0–4,9%	0–0,49

Tabela 9

Kriteri i masivitetit për federatat sportive individuale dhe kolektive në nivel ndërkombëtar	Vlerësimi me pikë
Mbi 200	4
151–200	3
76–150	2
1–75	1

Tabela 10

Vlerësimi i sporteve, sipas traditës dhe jetëgjatësisë së themelimit të federatave kombëtare	Vlerësimi me pikë
Federata e themeluar deri në vitin 1970	2
Federata e themeluar prej vitit 1971–1990	1,5
Federata e themeluar prej vitit 1991–2000	1

Federata e themeluar prej vitit 2001	0.5
--------------------------------------	-----

Tabela 11

Aktivitete kombëtare për federatat e sporteve kolektive dhe individuale		Vlerësimi me pikë
Kampionati Kombëtar	U14, U16, U18, U21, të rritur	5
	U16, U18, U21 dhe të rritur	4
Kupa e Shqipërisë	U18, U21 dhe të rritur	3
	U21 dhe të rritur	2

Tabela 12

Numri i aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare, ku merr pjesë federata brenda vitit	Vlerësimi me pikë
>= 40	3
30-39	2
15-29	1

Tabela 13

Kriteret e ngritjes së kapaciteteve	Vlerësimi me pikë
Federata kombëtare që kanë hartuar planin strategjik për zhvillimin e sportit përkatës	2
Federata kombëtare që kanë organizuar trajnim për trajnerët brenda vitit	1
Federata kombëtare që kanë organizuar trajnim për arbitrat brenda vitit	0,5
Federata kombëtare që kanë organizuar trajnim për administratorët e sportit brenda vitit	0.5

Tabela 14

Kohështrirja e aktivitetit		Vlerësimi me pikë
Kampionat Kombëtar	Sistem vajtje-ardhje	5
Kupa e Shqipërisë	Sistem grumbullimi	3
Aktivitet ndërkombëtar në Shqipëri	Sistem vajtje-ardhje	3
	Sistem grumbullimi	1
Aktivitet ndërkombëtar jashtë Shqipërisë	Sistem vajtje-ardhje	3
	Sistem grumbullimi	1

Shembull ilustrues për formulën e financimit

Në rast se fondi total për vitin XX për financimin e federatave olimpike dhe joolimpike për pjesëmarrje në aktivitetet ndërkombëtare dhe kombëtare të zhvilluara për të gjithë disiplinat, është në shumën totale 100 milionë lekë:

“Shuma vjetore e fondit në dispozicion” përlllogaritet si diferenca e fondit total minus fondin për projektet e federatave joolimpike dhe organizatave në funksion të sportit, referuar përcaktimeve të pikës 5, germa “a”, “b” dhe “c” të këtij udhëzimi, në intervalin deri në 30% të fondit vjetor ose (100.000.000 lekë – 30.000.000 lekë) = 70.000.000 lekë është shuma vjetore e fondit në dispozicion për të financuar federatat olimpike.

Në rast se pikëzimi i federatave, sipas kriteve të përcaktuara në shtojcën 1 të këtij udhëzimi, është si më poshtë:

- Federata X 90 pikë

- Federata Y	85 pikë
- Federata Z	80 pikë
Totali	255 pikë

Koeficienti i financimit për çdo federatë olimpike është:

- Federata X	90 pikë	- koeficienti i financimit	_35,2%
- Federata Y	85 pikë	- koeficienti i financimit	_33,3%
- Federata Z	80 pikë	- koeficienti i financimit	_31.5%
Totali	255 pikë		100%

Masa e financimit e përlogaritur për çdo federatë olimpike është:

- Federata X	- 70.000.000 lekë	* 35,2%	= 26,640,000 lekë
- Federata Y	- 70.000.000 lekë	* 33.3%	= 23,310,000 lekë
- Federata Z	- 70.000.000 lekë	* 31.5%	= 22,050,000 lekë
Totali			70.000.000 lekë

URDHËR

NR. 396, DATË 8. 7. 2022

PËR

PËRCAKTIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË SPORTIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9 të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar dhe të pikës 2, të vendimit nr. 255, datë 09.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”,

URDHËROJ:

1. Këshilli i Lartë i Sportit, përbëhet nga 12 (dymbëdhjetë) anëtarë dhe 1 (një) sekretar, si më poshtë:
 - a) Znj. Evis Kushi Kryetar, Ministër i Arsimit dhe Sportit.
 - b) Z. Endrit Hoxha Zv/ Kryetar, Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.
 - c) Z. Armando Duka Anëtar, President i Federatës Shqiptare të Futbollit.
 - d) Z. Avni Ponari Anëtar, President i Federatës Shqiptare të Basketbollit.
 - e) Z. Erli Pëllumbi Anëtar, President i Federatës Shqiptare të Volejbollit.
 - f) Z. Agron Kasa Anëtar, Rektor i Universitetit të Sportit të Tiranës.
 - g) Z. Fidel Ylli Anëtar, Ish Mundës i shquar/ President i KOKSH.
 - h) Z. Hysen Domi Anëtar, Ish Volejbollist i shquar.
 - i) Z. Lorik Cana Anëtar, Ish Futbollist i shquar.
 - j) Z. Nikolin Jaka Anëtar, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.
 - k) Z. Klodian Allajbeu Anëtar, Drejtor i Spitalit Amerikan në Shqipëri dhe Kosovë.
 - l) Z. Erzen Tola Anëtar, Jurist.
 - m) Z. Dëfrim Methasani Anëtar, Gazetar Sportiv.
 - n) Znj. Elvira Baze Sekretar, Ministria e Arsimit dhe Sportit.
2. Këshilli i Lartë i Sportit, të marrë masa për hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin si dhe organizimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave dhe detyrave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Urdhri nr. 337, datë 20.6.2018 i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, anëtarët dhe sekretari i Këshillit të Lartë të Sportit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

URDHËR NR. 397, DATË 8.7.2022,

PËR

PËRCAKTIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË SPORTIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9 të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar dhe të pikës 2, të vendimit nr. 255, datë 09.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”,

URDHËROJ:

1. Këshilli i Lartë i Sportit, përbëhet nga 12 (dymbëdhjetë) anëtarë dhe 1 (një) sekretar, si më poshtë:
 - a) Znj. Evis Kushi Kryetar, Ministër i Arsimit dhe Sportit.
 - b) Z. Endrit Hoxha Zv/ Kryetar, Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.
 - c) Z. Armando Duka Anëtar, President i Federatës Shqiptare të Futbollit.
 - d) Z. Avni Ponari Anëtar, President i Federatës Shqiptare të Basketbollit.
 - e) Z. Erli Pëllumbi Anëtar, President i Federatës Shqiptare të Volejbollit.
 - f) Z. Agron Kasa Anëtar, Rektor i Universitetit të Sportit të Tiranës.
 - g) Z. Fidel Ylli Anëtar, Ish Mundës i shquar/ President i KOKSH.
 - h) Z. Hysen Domi Anëtar, Ish Volejbollist i shquar.
 - i) Z. Lorik Cana Anëtar, Ish Futbollist i shquar.
 - j) Z. Nikolin Jaka Anëtar, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.
 - k) Z. Klodian Allajbeu Anëtar, Drejtor i Spitalit Amerikan në Shqipëri dhe Kosovë.
 - l) Z. Erzen Tola Anëtar, Jurist.
 - m) Z. *Dëfrim Methasani* Anëtar, Gazetar Sportiv.
 - n) Znj. Elvira Baze Sekretar, Ministria e Arsimit dhe Sportit.

2. Këshillit i Lartë i Sportit, të marrë masa për hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin si dhe organizimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave dhe detyrave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Urdhri nr. 337, datë 20.6.2018 i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, anëtarët dhe sekretari i Këshillit të Lartë të Sportit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

URDHËR NR. 397, DATË 8.7.2022

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË
KËSHILLIT TË LARTË TË SPORTIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 9 të ligjit nr. 79/2017 ”Për Sportin” i ndryshuar dhe pikës 4 të vendimit nr. 255, datë 9.5.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërblimit të Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Lartë të Sportit, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Politikave të Sportit dhe Këshilli i Lartë i Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Evis KUSHI

RREGULLORE E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË SPORTIT

Neni 1 Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për ushtrimin e veprimtarisë dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Sportit (në vijim Këshilli).

Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në nenin 9, të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar dhe në vendimin nr. 255, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”.

Neni 3 Përbërja e Këshillit

1. Këshilli kryesohet nga ministri përgjegjës për sportin (në vijim ministri) dhe ka në përbërje të tij 12 (dymbëdhjetë) anëtarë dhe 1 (një) sekretar.
2. Përbërja nominative e Këshillit përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.
3. Anëtari i Këshillit largohet nga detyra, në rastet si vijon:
 - a) kur jep dorëheqjen si anëtar i Këshillit;
 - b) në rast vdekjeje të tij;
 - c) kur ndërpret marrëdhëniet e punës me institucionin që përfaqëson;
 - d) kur dënohet me vendim penal të formës së prerë;
 - e) kur bëhet i paaftë mendërisht ose fizikisht për të ushtruar detyrën;
 - f) kur nuk merr pjesë në mbledhjet e Këshillit, më shumë se 3 herë radhazi.
 - g) Kur zëvendësohet sipas diskrecionit të ministrit përgjegjës për sportin.
4. Drejtoria e Politikave të Sportit në MAS mbështet anëtarët dhe sekretarin e Këshillit në ushtrimin e veprimtarisë së tij.
5. Anëtarët e Këshillit shpërblehen për pjesëmarrjen në mbledhje, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 4 Detyrat e Këshillit të Lartë të Sportit

Këshilli i Lartë i Sportit është organ këshillimor, pranë ministrit përgjegjës për sportin dhe ka këto detyra:

1. Merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin.
2. Nxjerr vendime me karakter këshillimor për ministrinë përgjegjëse për sportin, brenda fushës së tij të kompetencave.
3. Zbaton përcaktimet në këtë rregullore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Neni 5

Sekretari i Këshillit

1. Sekretari i Këshillit është përfaqësues i MAS, i caktuar nga ministri përgjegjës për sportin.
2. Sekretari i Këshillit ka këto detyra:
 - a) i paraqet me shkrim ministrit propozimet e parashtruara në mbledhjet e Këshillit;
 - b) përpunon propozimet në mbledhjen e Këshillit në formën për ekzekutim dhe ia paraqet ministrit;
 - c) mban procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit, përgatit materialet që do t'u shpërndahen anëtarëve të Këshillit, mban korrespondencën dhe kryen shërbime të tjera të kësaj natyre.
 - d) në fund të çdo viti kalendarik, depoziton në arkivin e MAS-it dosjen me dokumentacionin që dokumenton veprimtarinë e Këshillit.

Neni 6

Organizimi i mbledhjeve të Këshillit

1. Këshilli mblidhet mbi bazën e një kalendari, sipas datave të caktuara nga ministri, jo më pak se 3 (tre) herë në vit.
2. Një mbledhje e Këshillit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të tij.
3. Mbledhja e Këshillit drejtohet nga kryetari dhe në rast mungese të tij, nga zëvendëskryetari i Këshillit.
4. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Në rastet kur nga votimi nuk arrihet shumica, vendimmarrja përcaktohet nga vota e kryetarit.
5. Mbledhja e Këshillit dhe rendi i ditës u njoftohen anëtarëve të Këshillit prej sekretarit të paktën 10 (dhjetë) ditë para datës së mbledhjes. Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë datën, orën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, rendin e ditës dhe materialet mbështetëse, të cilat u dërgohen anëtarëve të Këshillit në formë të shkruar apo elektronike.
6. Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren me kërkesën e ministrit ose me kërkesën me shkrim të së paktës 1/3 e anëtarëve të Këshillit. Nëse mbledhja e jashtëzakonshme thirret, duke mosrespektuar përcaktimet e pikës 5 të këtij neni, por anëtarët janë të pranishëm dhe bien dakord ta pranojnë thirrjen e mbledhjes të vlefshme, atëherë ajo mund të vazhdojë rregullisht.

Neni 7

Rendi i ditës i mbledhjeve të Këshillit

1. Rendi i ditës i një mbledhjeje të Këshillit përcaktohet nga ministri me nismën e tij.
2. Në rendin e ditës së një mbledhjeje të Këshillit përfshihet një çështje që propozohet nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit.
3. Në fillim të një mbledhjeje të Këshillit, mund të shtohet një çështje në rendin e ditës:
 - a) me kërkesë të ministrit;
 - b) me propozim të një ose disa anëtarëve të Këshillit, kur miratohet nga shumica e anëtarëve të Këshillit të pranishëm në mbledhje.
 - c) Kur trajtimi i një çështjeje shtesë kërkon parapërgatitje, mbledhja shtyhet me 24 orë.

Neni 8

Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje të Këshillit mbahet procesverbali që pasqyron të gjitha diskutimet gjatë mbledhjes.
2. Procesverbali i mbledhjes përfshin:
 - a) orën, datën, vendin e mbledhjes;
 - b) verifikimin e prezencës së pjesëmarrësve;
 - c) çështjet e diskutuara nga anëtarët e Këshillit;
 - d) formën dhe rezultatin e votimeve;
 - e) çdo informacion apo dokument, objekt diskutimi;
 - f) vendimin e Këshillit.
3. Anëtari i Këshillit ka të drejtë që të kërkojë që procesverbalit t'i bashkëngjitet një deklaram me shkrim për mendimet që ka dhënë gjatë mbledhjes dhe t'i plotësohet kjo kërkesë.
4. Anëtari i Këshillit ka të drejtë të kërkojë që të lexojë procesverbalin e mbledhjes ose të mbledhjeve paraardhëse dhe t'i plotësohet kjo kërkesë.
5. Procesverbali i paraqitet për miratim dhe nënshkrim të gjithë anëtarëve të Këshillit, në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët dhe sekretari.

Neni 9 **Dispozita të fundit**

Funksionimi i Këshillit i nënshtrohet rregullave të parashikuara në legjislacionin për organet kolegjiale të administratës shtetërore, për çështjet që nuk janë të rregulluara posaçërisht në këtë rregullore.

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.